

Parathenia

Njeriu me dobesite e tija eshte krijesa me e ulet ndersa me anet pozitive behet krijesa me e larte. Cdo botekuptim edukativ qe nuk e vlereson dhe analizon ate me dobesite dhe anen pozitive eshte I manget dhe gjysem.

Islami e shqyrton njeriun si nje teresi. Afrohet me nje metode kritikuese dhe te frikshme ndaj dobesive te tij dhe nxitese dhe inkurajuese ndaj aneve pozitive. Per kete arsye per Kuranin fisnik dhe hadithin e larte frika dhe shpresa ,parajsa dhe ferri ,meshira dhe denimi trajtohen pas njera tjetres ne nje ekuilibër. Tipi I njeriut te marre fund e te mbaruar nga frika dhe ai I perkedhelur nga shpresa duke arritur ne nje vetekenaqesi te tepruar nuk jane tipi I njeriut qe kerkon islami.

Vazhdueshmeria dhe sigurimi I jetes fetare arrihet vetem nga realizimi I kushteve te nevojshme. Njeriu nga njera ane duhet te mbeshtete vazhdimisht ne jeten shpirtore per te mos kaluar ne zbrazetire metafizike ,nga ana tjetër eshte e nevojshme te mbahet nen kontroll per te ruajtur drejtimin e levizjes permes normave te ndryshme juridiko ligjore ,per ta mbrojtur nga pengimet ,rrezimet dhe mbetja e rruges. Ne pamjen e jashtme keto denime mund te duken jo te nevojshme dhe te dhimbshme ,por ne fund po te mendohet se cfare mund te perfitohet prej tyre do shihet se keto norma jane ne interesin e njeriut po aq sa normat stimuluese dhe nxitese,dhe pas pamjes nga jasht te shemtuar mbart nje bukuri hyjnore.

Te gjitha sistemet qe e kane vleresuar njeriun vetem nga nje ane e tij kane falimentuar dhe ato qe akoma mbahen ne kembe po shkojne me shpejtesi drejt atij drejtimi. Pasi keto sisteme jane te privuara nga realiteti dhe harmonia e jetes. Si rezultat I ketyre gjerave nga te cilat sistemet jane shume larg vjen rezultati I padiskutueshem qe eshte mbarimi dhe falimentimi total.

Nga ky kendveshtrim ne duhet te vleresojme normat e islamit ne baze te principeve morale te vete islamit,pasi ai moral eshte morali I Kuranit. Synimi kryesor I yni duhet te jete qe tu tregojme njerzve rruga e edukimit ne moralin me te larte me te cilin eshte edukuar Zoteria I Zoterinjve(s.a.s). a nuk eshte edhe qellimi I te qenit njeri arritja e ketij morali te larte?

Parimet islame ne fillim te punes mund ti grupojme ne dy grupe kryesore. Ne nje menyre te thjeshte dhe te shkurter mund ti quajme subjektive dhe objektive. Te parat perfshijne strukturen kryesore dhe boten

e brendshme te individit dhe nete dytat behet fjale per gjerat qe duhen bere me boten e jashme.

Para se gjithash njeriu duhet te kaloje nje jete shpirtore ne drejtimin e duhur,pasi treguesit e besimit mund ti fitojne njeriut kete cilesi.

Njeriu qe beson Allahun,engjejt,librat,profetet,ditet e gjykimit dhe fatin ne nje fare mase kane nje drejtim te caktuar. Por ky drejtim duhet forcuar me pune e veprime te mira duke I bere pjese te natyres se tij shpirtore. Duke falur namazin ,agjeruar,dhene zekatin duke kryer peligrinazhin si dhe duke kryer adhurimet shtese (nafile)njeriu zhvillon jeten shpirtore dhe zbukuroin boten e brendshme duke realizuar disa nga detyrimet ne planin personal. Dihet qe detyrimet lidhen me gjera qe duhen por edhe me ato qe nuk duhen kryer. Ne nje skaj te ketyre detyrimeve eshte parajsa dhe ne nje skaj eshte ferri,ose e thene ndryshe ne nje skaj pritet shperblimi dhe ne tjetrin pritet denimi,duke synuar nje ekuilibër te pranueshem.

Ne nje aspekt kjo ceshtje duhet shqyrtuar dhe ne planin e realizimit njerzor. Zoti na krijoj ne si njerez,si nje kompleks I dobësive dhe I vlerave te larta morale gje qe nuk ekziston ne krijesat e tjera. Kafshet nuk mund te dalin jashte kufizimeve qe u caktohen. Pasi ata skane vetedije dhe per rrjedhoje skane as pergjegjesi. Xhindet nga vete krijimi I tyre jane shume pas njerzve. Duke qene se struktura e djajve eshte bere njesh me te keqen ata jane vetem krijesa qe bejne gjera te keqija. Dhe engjejt kane kapacitet te kufizuar. Termi I kufizuar eshte per te treguar qe si dhe njerzit kane nje evolim te percaktuar. Djalli eshte privuar nga bindja ndersa engjejt nuk dine te kundërshtojne. Ndersa njeriu eshte krijuar I hapur ne te njejten mase si ndaj te keqes dhe te gabuares ashtu edhe ndaj te mires dhe te drejtes. Sikurse mund te fitoje vendin me te larte nder krijesat ashtu edhe mund te bjere nder me te ulet e me te ulteve.

Detyrimet qe ve islami jane efikase per zhdukjen e se keqes. Tharja e kenetes eshte rruge me e mire me efikase per tu mbrojtur nga mushkonjat. Pasi ta rritesh gjarprin dhe ta besh ate kober ska vlere te ankoresh ndaj saj dhe eshte mese e qarte pamundesia dhe vendi jo I duhur per ta zhdukur ate. Keto detyrime duhen shqyrtuar nga ky aspekt duke patur besimin se ne kete menyre kuptohet me qarte.

Urdherimi I te mires dhe parandalimi I se keqes ,shperblimi ,komplimentat dhe perkedheljet ndaj veprimeve te bukura,perdorimi imasave shternguese dhe denuese ndaj se keqes dhe faktoreve qe te cojne ne te keqe,domethene tharja e mocalit dhe shkullja nga rrenjet e se keqes

jane metodat dhe teknikat kryesore per te arritur qellimet dhe objektivat brenda detyrimeve te islamit.

Ne librin qe ju ndodhet ne duart tuaja do te mundoheni te paraqesim dhe te shqyrtojme ne aspekte te ndryshme ceshtjen e te urdheruarit ne rruge te drejte dhe ndalimit te se keqes. Duhet te kemi parasysh qe pikenisja eshte nje nga detyrimet ne islam dhe duhet te perpiqemi qe vleresimin ta bejme rreth kesaj te vertete. Shpresojme qe nje vleresim i tille ti hape horizonte te reja botekuptimit tone “rregulat e thirrjes ne islam”.

Prezantimi

Ajeti Kuranor “le te gjendet mes jush nje bashkesi qe ju therret per miresi,urdheron te miren dhe ndalon te gabuaren. Ata do te jene te shpetuarit”(Ali Iman,3,104) u ve nje pergjegjesi dhe nje detyre atyre qe besojne. Kjo pergjegjesi qe u eshte ngarkuar atyre eshte caktuar nga vete Zoti percjellur permes profeteve nga transmetimi hyjnor i dhene tyre dhe vlerat e mira ose te keqija te disa njerzve qe kane arritur disa cilesi duke perfutur nga keto burime,duhet tju tregohen patjeer njerzve. Kjo eshte detyra me e nderuar dhe me e vlefshme ne siperfaqene tokes. Nese do te okishte ndonje deyre me te rendesishme dhe me me vlere Allahu do ti ngarkonte me te njerzit me te zgjedhur te tij Profetet.

Komentuesit ne pergjithesi kur e vleresojne kete ajet ne aspektin juridik ndalen me insistim ne faktin seajo eshte nje norme kushtezuese. Termi”minkum” i perdorur ne kete ajet duhet te beje cdo besimtar te mendohet mire. Sot ne ditet tona eshte nje e vertete e hidhur e pranuar nga te gjithë qe ka shume pak persona qe jane te vetedijshem,te pregjegjshem ne lidhje me kete detyre. Sipas disa komentuesve te tjere shtohet fakti qe neqofte se nuk ekziston nje bashkesi qe te urdheroje ne te mire dhe te ndaloje te keqen kjo detyre behet nje detyre personale duke u futur ne pergjegjesite personale si te falurit,te agjeruarit,dhenja e zekatit etj.

Feja eshte nje diapazon vlerash qe percakton te mirat dhe te keqijat te percaktuara ne ajetin e mesiperm. Ne kete kontekst urdherimi i te mirave dhe ndalimi i te gabuarave mund te komentohet si tregimi i besimit. Keto gjykime si normat kushtezuese te pregjithshme dhe pergjegjesite individuale mund te thuhën si thirrje dhe udhezim ne rruge te drejte. Nje pjese e vleresojne thirrjen si nje vleresim ndaj atyre qe nuk e besojne Zotin dhe urdherimit ne te drejte per ata qe besojne por qe se jetojne ate ne masen e duhur ose se jetojne fare. Keto jane kuptimet me te cilat shpjegohen keto

fjale ne fjalor dhe paraqesin te drejten. Megjthate ne nuk do te zbresim ne detaje qe lidhen me keto dy fjale por do te ndalemi ne kuptimin e pergjithem te tyre. Ne kuptimin e pergjithem te dy fjaleve nenkuptojme tregimin efese ne pregjithesi. Per ta vene ne jete kete detyre sikurse cdo gje tjeter duhet te kemi parasysh parimet themelore qe ndahen ke kater grupe,te veretetat qe do te tregohen,presoni qe do ti tregoje,personit qe do ti tregohen dhe metodat e tregimit,si dhe parimet ndihmese qe lidhen me themeloret. Shkurtimisht thirrja si qellimi kryesor I jetes ,lidhja mes thirrjes dhe individit dhe shoqerise,thirrja dhe profetet,preokupimi,vuajtjet,shperblimi dhe lutja dhe lidhja me thirrjen si dhe ruajtja e nje ekuilibri mes deshirave dhe mundesive luajne rol te rendesishem ne suksesin e thirjes dhe ndikimit ose jo te saj.

Ne fakt ceshtjeve qe mund te lidhen me thirrjen mund ti shqyrtojme nga kendveshtrime te tjera. Thirrja eshe nje ndermjetes I rendesishem qe siguron te qenurit rob I Zotit si duhet,ruajtjen e raportit me Zotin ne vazhdimesi dhe siguron arritjen e shkalleve me te larta te islamit. Cdo gje qe lidhet me besimtarin adurimin meshirimin ndaj ligjeve hyjnore mund te vleresohen brenda kornizes se ajetit”Njerzit dhe xhindet si krijova per gje tjeter vecse te me adhurojne mua”.(Zarijat,51/65) ku thirrja eshte pika me e rendesihme e te vertetes. Kjo eshte edhe arsyeja qe me lart e cilesuam se thirrja eshte dhe arsyeja e jetes sone.

Ne kete pike duhet patur parasysh dhe ana sociale e thirrjes ,pasi njeriu eshte nje qenie sociale e programuar per ta kaluar jeten ne mes te njerzve. Nje jete e perbashket per te gjithë njerzit nga njera ane ka nevojë per ndjenjat njerzore qe nuk njohin kufi,kufizim,distance,mendimet,ambicjen,deshirat,veprimet dhe ndjenjat nga ana tjeter duke qene se kjo bote eshte nje fushe prove qe ka nevojë per rregulla dhe ligje. Shume terma te hedhura ne fusha te ndryshme si politike ekonomike,drejtësi dhe kulture,si terma te tille si bashkesi ligjore,bashkesi perparimi,supermacia e ligjit,drejtësia sociale,dhe shume doktrina te tjera ekonomike,politike e kulturore kane dale si produkt te kesaj nevojë. Vecanarisht ne shekujt e fundit eshte nje e vertete e padiskutueshme qe njerezit jane mjaft te paperqendruar dhe te pavetedijshem gje qe eshte percaktuar mjaft qarte ne fete qiellore. Eshte mese e qarte qe te gjithë besimet etjera pervec islamit po shkojne drejte deformimit dhe shkaterrimit total duke dale qarte se burimi I vetem eshte feja islame. Epokat pas te

Derguarit te Allahut)eshte nje tregues I qarte I triumfit kur kjo fe eshte vene ne jete ne menyren e duhur.

Po te merrnim dhe te shqyrtonim gjendjen e thirrjes se myslimaneve vecanarisht dy shekujt e fundit do te nenvizonim dy aspekte te rendesishme. I pari lidhet me renien e mendimeve,ekonomise,politikes dhe madje kulturore e morale si nje vazhdueshmeri e natyrshme e humbjes se pozites dhe pozicionit te filluar ne fazen e ndalimit dhe renies se perandorise Osmane dhe te renies se kapitalizmit para fuqive te medha. Madje myslimanet u ndikuan aq shume saqe ata humben vlerat e cmuara te qenies se tyre duke arritur ne ate pike sa te kihet dyshime dhe medyshje per ate qe eshte duke u bere dhe shkak I largimit te nje pjese. Sigurisht qe kemi edhe shume njerez qe nuk u ndikuan nga kjo atmosfere e pergjithshme. Por perpjekjet e tyre per te shpjeguar dhe perhapur islamin nuk gjeten pranimin ne nje mase te konsiderueshme. Ne kete aspekt kane patur nje ndikim shume shkaqe te ndryshme ,ku mund te permendim numrin e pakte te atyre qe e dine fene drejt,mos qenja e favorshme e mjedisit,pasionet e brendshme dhe te jashtme dhe mbi te gjitha perdorimi me insistim I metodave te vjetra pa u pershtarur mete rejat dhe gjerat e evoluara te shekullit. Personalisht mendoj se mosecja me ritmin e kohes eshte shkak kryesor I renjes ne kete gjendje te botes islame. Nese do te arrihej vizioni I shprehur nga nje fraze e Mehmet Akifit”ta shpjegojme islamin sipas botekuptimit te kohes”besoj se situata ku do te ishim do te ishte ndryshe nga ajo qe jemi. Ne qofte se do te arrihej institucionalizimi duke patur parasush individet ,vendin dhe kohen e punesse thirrjes se edukimit me normat fetare ,po te arrinim te organizoheshin ne cdo sferë te jetes besniket e thirrjes me qellimin e vetem prezantimin e fese ,nese do tesynohej te perfitohejnga komentimet dhe transmetimet e historise islame duke humultuar deri ne burimin e mirefillte duke sjelle gjykime te reja dhe duke I vene ne jete ato ,padyshim qe rezultati do te ishte shume me ndryshe nga ai qe ne kemi arritur.

Aspekti I dyte qe dua te theksoj eshte mos venia ne jete e te vertetave qe tregohen nga te perkushtuarit ne thirrje. Gjykimi Kuranor ne kete ceshtje eshte mjaft I qarte dhe I hapur”Perse flisni per gjera qe smund ti beni? Mekati me i madh para Zotit eshte thenja e gjerave qe vete nuk i beni.(Saf,61,2-3).

Pavarsisht nga ky gjykim veprimi ne te kundert sipas dhe percaktimit te Profesorit(Hoxha efendi) eshte shkak i nderprerjes se begatise se

transmetimit. Ne kete pike mendimet behen te paqendrueshme,gjykimet te pamjaftueshme,fjalet boshe dhe te thata dhe personi qe zoteron kete cilesi seshte i mundur te pranohet as ne nivelin individual as edhe ne ate social. Pasi kjo eshte ne kundërshtim me ligjet e Zotit.

Ceshtja qe sapo permendem seshte e drejte te kufizohet vetem ne fushen e marrdhenieve nje me nje. Kjo gje eshte e vlefshme edhe ne planin shoqëror. Ne te verete per shekuj me rradhe nuk mund te flitet as per bashkesi ,as per ndonje shtet qe te kete perfaqesuar si duhet islamin duke qene ne nivelin e “Epokes se Lumtur” ose ne qofte edhe me poshte. Kjo per arsye se personat qe jane ne kontakt me thirrjen tone qofte qofte ne planin personal dhe qofte ne ate shoqëror duke qene ne nivel me te larte jetese se vete myslimanet largohen nga islami. Mund te themi se sikur gjithë ceshtja te ishte te mosjetuarit e islamit ne fushat dhe masen qe pretendohet. Por permes komentimeve dhe zbatimeve jo te duhura islami eshte paraqitur si personifikim i te prapambetures dhe te gabuares duke i dhene nje goditje te fuqishme denigruese imazhit te islamit. Dhe ky eshte ne faktor pengues qe thirrja te arrije nivelin e duhur.

Libri qe keni ne dore brenda disa paragrafeve e shqyrton nga tre pika te ndryshme ceshtjen e thirrjes dhe udhezimit ne te drejte ,dhe ne keto fusha duke treguar boten e islamit hap horizonte te reja per te ardhmen. Duke paraqitur komentimet ne lidhje me hadithin ,ajetet dhe dijetaret e pranuar nga te gjithë njerezit libri “Boshti i Shpetimit” (irshad akseni) eshte nje faktor tjeter qe shton vlerat ne kete fushe.

Ky liber ne fakt eshte hedhja ne leter dhe permbledhja e serise se fjalimeve me titull “Metoda e thirrjes ne islam” te mbajtura nga Profesori M.Fethullah Gulen para viteve 1980. Sikurse eshte vepruar edhe me librat e tjere brenda mundesive kasetat e incizuar me fjalimet jane hedhur ne shkrim dhe me gjithë ngarkesen e Profesorit jane kontrolluar edhe nje here duke ju dhene formen perfundimtare per botim.

Libri i eshte ndare ne ter grupe kryesore Analiza e thirrjes,Parimet dhe metodat ne thirrje dhe Portretizimi shpirteror i njeriut te thirrjes. Cdo grup ne vetvete eshte i ndare ne ceshtje dhe nenceshtje. Duke mbartur shqetesimin qe mund te mos pasqyrohet ne masen e duhur mesazhi qe deshirohet te percillet nuk eshte nderhyre shume duke i bere qe te ndihet fryma e fjalimit(vazit). Pavarsisht se ky liber eshte realizuar si perbledhje e fjalimeve te ndryshme besoj se ky fakt nuk perben ndonje problem.

Ne fund ne lidhje me vecorite dhe rendesine e pergjthshme te ketij libri kisha deshire qe mendimet e mija ti paraqisja dhe ti ndaja me juve duke i perbledhur ne 20 pika kryesore. Pastaj hoqa dore se pashe se nuk ishin te ndryshme nga 25 pikat qe Profesori kishte permbledhur ne pjesen e mbylljes. Duke qene se sdo mbarte ndonje kuptim tjeter do te ishte vecse nje humbje e kohes tuaj te cmuar.

Libri "Boshti i Shpetimit" eshte ngritur mbi percaktimin e domosdoshmerise se trajtimit te ceshtjes se udhezimit te te mirave dhe ndalimit te keqijave brenda normave te islamit, i zbukuruar dhe shoqeruar me shmbuj nga epoka e lumtur me analize dhe komentim origjinal ,plot njohuri teknike dhe vlera te cmuara per brezin e ri te thirresave ne rruge te drejte,shume larg cd opolitizimi me nje diapazon te gjere qe te perfshije te gjithë njerezimin ,duke theksuar se udhezimi i njerzve ne rruge te drejte ne ditet e sotme eshte detyra me e rendesishme se cdo detyre e detyrim tjeter duke treguar te vertetat e shekullit. Sipas dhe vete shprehjes se Profesorit te Nderuar ky liber duhet te jete nje liber i vogel xhepi qe te mbartet me vete nga cdo person qe nis nje rruge te tille.

Duke ju lene juve vetem per vetem me librin do deshiroja te falenderoja Profesorin e Nderuar qe gjeti kohe per ta perbledhur kete liber qofte edhe i vogel me gjithë kohen ne ngarkuar qe patem theksuar me larte,paraqes kerkesen tone qe permes librave te tille te na zgjeroje horizontin dhe te na drejtoje ne rruge te drejte duke deshירuar nga Zoti qe ti jape shendet,force e jete te gjate.

Vecanarisht dua te falenderoje cdo njeri qe ka ndihmuar ne faqosjen,redaktimin,shtypjen dhe shperndarjen e ketij liber.

Ahmed Kuruxhan
istanbull,21/11/1997

ANALIZA E THIRRJES NE FE

Kapitulli i parë

1.Qëllimi i ekzistencës është Thirrja ne fe!

Urdhërimi i gjërave te mira dhe ndalimi i gjërave të gabuara është një nga rrugët që con në shkakun e krijimit të gjithësisë. Zoti(xh xh) ka ndërtuar këtë univers për një mision të shenjtë duke caktuar dhe njeriun si mëkëmbësin e tij për realizimin e këtij misioni.

Edhe poezia profetike është kompozuar për të njëjtën arsye. Hz.Adem(a.s) ishte njeriu dhe profeti i parë në tokë. Fëmijët e tij sapo hapën sytë dhe filluan të kuptojnë u gjenden para të atit të tyre dhe para një profeti që i urdhëronte në të mira dhe i largonte nga të këqijat. Zanafilla e njerëzimit fillonte me këtë panoramë profetike. Si rezultat kjo pemë profetike do te jepte fryt profetik i cili ishte edhe bërthama e kësaj peme. Qëllimi i dërgimit të zotërisë së dy botërave për të cilin është krijuar ky univers është thirrja ne Fe. Esenca e kësaj thirrjeje është urdhërimi i gjërave të mira dhe ndalimi i gjërave të gabuara. Do të thotë që gjithësia është krijuar për këtë arsye dhe padyshim që duke qënë se kjo punë është edhe shkak i krijimit të gjithësisë do të jetë edhe më e rëndësishmja mes të gjitha punëve.

Në këtë mënyrë sapo hapën sytë fëmijët e parë të Hz.Ademit (a.s) në qiellin e botës që jetonin suditën si yll polar “Babain Profet” me shikim të ngulitur në botën e përjetme, duke u dridhur dhe duke jetuar gjithnjë si në një ankth shqetësimi të botes se ptejme, i përthyer në dysh nën peshën e rëndë të urdhërave të marra nga kjo botë. Hz.Adem(a.s) ishte i pari që edhe si njeri edhe si profet “urdhëronte në gjërat e mira dhe ndalonte nga gjërat e gabuara”. Dhe kjo s’ishte një rrugë që hapej e pastaj mbyllej për një herë të vetme. Atë do ta ndiqnin dhe mjaft profetë të shquar pasi njerëzimi kishte mjaft nevojë për ta. Kjo sepse ndonëse tek njeriu gjenden shumë cilësi të larta koha dhe ngjarjet çojnë në shuarjen një nga një të këtyre cilësive.

Për këtë arsye Kur’ani i Madhërueshëm tregon se periodat kohore që kalojnë pa ripërtëritje çojnë në ngrysje shpirtërore dhe ne kohët e këtyre ngrysjeve shpirtërore njerëzve u vënë perde sytë dhe u turbullohet shikimi. Si rrjedhojë u rrëshqasin këmbët dhe humbasin drejtimin. Zoti i madhërueshëm duke i ditur të gjitha me anë të dijes së Tij dhe si rrjedhojë e dashurisë dhe mëshirës së tij të pafundme ka dërguar një mori profetësh

dhe çdo profet sipas kushteve të epokës që ka jetuar ka urdhëruar gjëra të mira dhe ka ndaluar gjëra të gabuara.

Hz.Adem(a.s) të gjithë jetën e tij e harxhoi për këtë qëllim dhe femijët e tij gjithmonë i këshillonte për punë të mira dhe të largoheshin nga punët e këqija ose të gabuara.

Jehona dhe oshëtimat e zërit të tij u dëgjua edhe për një kohë të gjatë pas vdekjes, dhe kur jehona e zërit të tij filloi të venitej Zoti ngarkoi me detyrën e Profetit më të zgjedhurin ndër fëmijët e tij. Ata me rradhë e realizuan si duhet këtë detyrë që u ishte ngarkuar dhe njerëzimi gjithmonë jetonte një errësirë të plotë mes perëndimit të një profeti dhe lindjes si një diell të një profeti tjetër. Në të vërtetë ata që largoheshin e mbushnin me yje zymtesinë e errësirës por rrezatimi i tyre ishte i pamjaftueshëm në krahasim me ndriçimin e diellit që pritej.

Deri në kohën e Hz Nuhut(a.s) bota rrotullohej në këtë mënyrë. Një ditë njerëzimi dëgjoi zërin këmbues dhe qortues që i shkonte për shtat një profeti që sipas thënies së Kur'anit të Madhërueshëm thoshte: "ju njoftoj ato që Zoti im më ka transmetuar, ju këshilloj dhe nga Zoti di ato që ju nuk i dini" (araf 7/62). Domethënë ai që më dëgjon, që më bindet dhe që hypën në varkën time është i shpëtuar.

Ky shpëtim do të ishte edhe shpirtëror edhe fizik. Varka mbi uje do të shpëtoje trupin tuaj, ndërsa nese me jepen pas meje me zemer dhe ju vini veshin atyre që them do të gjeni shpëtimin nga te mbyturit ne mes te dallgeve te frikshme te jetes se kesaj bote dhe asaj tjetres. Ne te kundert do temerrni fund si moralisht dhe materialisht.

Hz Nuh(a.s) vazhdoi të këshillonte kështu me shume se 1000 vjet. Pas tij dhe Hz Hud(a.s) thoshte net e njejtën menyre:

"Une jam per ju nje keshillues i sigurve(Araf 7/68),duke i ftuar njerzit te vepronin ne pershtatje me shkakun e krijimit te tyre.

Pasi njeriu eshte krijuar per ta njohur dhe ditur fatin e madherueshem dhe per ti ndjere ne shpirt ate qe din.Prandaj per tia krijuar atij kete detyre dhe per ta perfeksionuar ate ne kete detyrejane derguar profete pa reshtur,dhe te gjithë qe ndoqen Hz hud vazhduan ne tw njwjtin drejtim.

Atehere kur ndikimi i zerit te Profetit paraardhes venitej nga kujtesa padyshim qe njerzimi merrte tateposhte dhe tronditjet e medhaja ne jeten e tij shpirtërore pasonin njera tjetren.Jeta shpirtërore shnderrohej ne nje djerrine, flladet e brendshme ndaleshin dhe njerzit beheshin per tu qare

hallit. E njejtatmosfare ne boten njerzore perjetohej kur u dergua babai I profetit Hz Ibrahim(a.s).

Me frymen ringjallese per te urdheruar ne gjerat e mira dhe per te ndaluar gjerat e keqija ai hyri mes njerzve aty ku gjente nga dy tre persona duke iu shkuar prane dhe duke ju folur per te verteten. Ata qe I vinin veshin dhe e degjonin ngjiteshin ne majat e botes njerzore duke zene vendin e tyre mes te nderuarve dhe te zgjedhurve. Pas Hz Ibrahim njerzimi filloi te zbriste nga lartesia qe kishte arritur serish ne krahet e injorances. U be dominuese mendesia qe perpiquej te kerkonte dhe gjente gjithshka ne materie. Besoj se ne sot e kuptojme me mire sa te frikshme jane permasat e kessaj fatkeqesie nje krah I se ciles zgjatet deri ne shek.20.

Hz Musa(a.s) u shfaq ne nje kohe kur nje sinteze e tille jetohej ne luginen e Nilit. Dhe ai si profet paraardhes ishte nepunes “per te urdheruar gjerat e mira dhe per te ndaluar ato te keqija I ngarkuar per tu perballuar me nje fis kryenec e inatcor. E pranoi kete detyre te shenjte dhe I hyri mundimit per ti larteluar ato duke I kapur per dore. Ndonese nje popull I veshtire per te ardhur ne rruge te drejte, Hz Musa(a.s) perms perpjekjeve dhe insistimit dite nate dhe si rrjedhoje e te urdheruarit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te gabuara arriti qe ti realizonte disa gjera dhe gjate jetes se tij.

Padyshim qe nuk eshte e thjeshte qe ti udheheqesh dhe ti drejtosh njerzit per tu shendrruar ne njerez te devotshem dhe te perkushtuar, dhe si rrjedhoje dheshume profete u desh ta paguaje kete perpjekje dhe me jeten e tyre. Hz Zekeria (a.s) ne kete perpjekje u nda ne dysh nga koka te kembet me sopate hekuri, dhe Hz Jahja(a.s) ra deshmor si dhe kurthi I ngritur per Hz Isa(a.s) sqe per ndonje qellim tjeter.

Veshtiresite qe duhej te perballonte I derguari I Allahut (s.a.s) i kalonte te gjitha. Ne kete rruge ai do te kalonte mundime dhe vuajtje te paimagjinueshme aq sa nje here do ti drejtohej Hz Aishes(r.anha)” o Aishe, kam vuajtur shume nga fisi im” Ndihet nje vuajtje shpirterore ne kete fjale te profetit. Po ta ndiqnin ne menyre imagjinare deri tek Hz Ademi(a.s) do ti mbledhte femijet e tij dhe do tu thoshte “vuajta shume nga ju” dhe Hz Nuh(a.s), Hz Hud(a.s) e gjithe te tjeret do te ankoheshin permeste njejtas fjale.

Dhe ne fjalet e gjithe atyre qe e vazhduan kete detyre pas profetit tone do te gjenin te njejten dhimbje. Shprehja”Per afro 80 vjete ne jeten time sdi ndonje gezim te kesaj bote”.

Gjithe jeten e kalova ne fushat e betejes ,burgjet e roberise apo burgjet e vendit dhe ne sallat e gjyqeve. ska vuajtje e mundim qe skam perjetuar. Ne gjyqe me trajtuan si kriminel dhe si vakabond, me internuan nga nje vend ne tjetrin. Ne burgje mu ndalua gjithshka dhe madje disa here me helmuan, duke perjetuar fyerje nga me te ndryshmet.ndonjehere preferova mijra here te vdes sesa te jetoj. Nqs te vraret e vetes sdo me ndalohej nga feja ndoshta sot Saidi do te ishte kalbur nen dhe me kohe. "A nuk eshte shprehje e nje renkimi te brendshem ?" Ne fakt ky ishte fati I pandashem I atyre qe "urdhonin ne te mira dhe ndalonin te keqiat."

Per te terhequr vemendjen ne nderin e te marrit pjese ne kete detyre te larte doja qe te beja nje permbledhje nga Hz Adem(a.s) deri tek profeti yne (s.a.s).

Emocionet burojne nga pasqyrimi I madheshtise te kesaj ceshtjeje.Me duket sikur degjoj thirrjet e ushtareve te se vertete ne imagjinen time.

Cdo hap I hedhur ne rrugen e te "urdheruarit ne gjera te mira dhe te ndaluarit te gjerave te gabuara"ben q e ai qe e hedhket hap te fitoje shperblim sa ai I prfeteve ,pasi kjo detyre eshte detyre themelore e profeteve.

Cdo njeri qe hedh nje hap te tille ka marre persiper nje detyre te tille ose kjo detyre I eshte dhene atij si nje dhurate hyjnore. Prandaj nje njeri qe hedh nje hap te tille merr shperblim sipas shkalles dhe qellimit qe ka.

Do ishte me vend te theksonim se mqs kjo eshte nje detyre e shenjte profetike dhe profetet ne teresi te tyre jane ne drejtimin e duhur ateher dhe ata qe ndjekin parimet e "te urdheruarit te gjerave temira dhe ndalimit te atyre te keqia" ne fund te fundit llogariten se jane ne drejtimin e duhur.,per rrjedhoje te veprimeve te tyre.

Per rrjedhoje, garancia e te mbeturit besimtardhe I tepranuarit I tillepara Zotit per personin qe beson ne Zot lidhet ngushte me realizimin si duhet te detyres te thirrjes ne rruge te drejte. Personat dhe bashkesite qe besojne mund te vazhdojne ekzistencen vetem nepermjet realizimit te kesaj detyre. Kushti I te mbeturitbesimtar dhe sekreti I ekzistences varet nga percjellja e te vertetave dhe tedrejtave ,mosheshtja perballe padrejtesive,mos llogaritja e jetes dhe vdekjes ,te qenurit ne botekuptimin e shokeve te profetit(sahabet) dhe pranimi I kesaj detyre si shkak kryesor I jetes. Turp per ditet qe I kalojme pa I perjetuar keto gjera ?...Ne fakt cdo besimtar duhet te mbeshtetet tek Zoti per te jetuar ne nje shoqeri ku nuk praktikohet kjo detyre e shenjte.

Individi gjate realizimit te kesaj detyre gjen edhe menyren e venjes ne jete te mendimeve qe ai beson dheë I eshte perkushtuar si dhe besimi qe ai ka mbetet ne ajer. Pasi islami eshte nej e vertete qe jetohet, duke mos u jetuar cdo dite ai ska si kuptohet. Njeriu qe ka si prioritet besimin dhe thirrjen e nderton gjithë aktivitetin jetesoj rreth ketij boshti. Per nje besimtar I pari qe duhet ruajtur ne pese parimet e tij eshte feja. Ai duhet tembrije fene sikurse mbron nderin, personalitetin, pasurine dhe shpirtin dhe kjo tregon rendesine qe ai I kushton fese. Aspekti me dallues qe tregon shkallen e lidhjes qe ka individi me Zotin, eshte perpjekja qe ai ben per ta mbrojtur fene dhe besimin e tij. Sduhet harruar fakti qe ai qe nuk mbron besimin nuk mund tembroje dhe parimet e tjera. Ky eshte mesimi me I goditur dhe mbreslenes qe historian a server neve.

Zoti(xh.xh) na krijoi me qellim per ta kuptuar dhe shpjeguar Ate. Ky eshte qellimi Hyjnor I krijimit tone. Si ne kete bote dhe ne ate te pertejmen eshte e domosdoshme te jetojme ne perputhje te plote me kete qellim hyjnor. Ne te kundert do te humbasim qellimin e ekzistences tone si ne kete bote ashtu edhe ne jeten e pertejme, Zoti na ruajt si popull dhe si bashkesi do te biem ne rrjedhen e percarjes dhe ndarjes. Profeti yne (s.a.s) eshte munduar te jape nje ekspoze te pasojave te pashmangshme me tecilat do te perballet ai popull ne gjirin e te cilit nuk zbatohet kjo detyre e rendesishme (detyre e thirrjes). Nje dite shoket e profetit (Sahabet) ishin mbledhur rreth tij dhe po e degjonin me vemendje. Ate dite ne mes te fjaleve te embla e magjike kishte dhe shprehje qe u kallnin daten dhe I frikesonin pa mase. Sipas transmetimit te Ebu Jala dhe ibni Ebid Dynja(r.anhuma) I derguari I Allahut(s.a.s) pyeste:

“Si do te ndjeheni ju kur grate do te ngrene krye, do te vershojne rrugeve te shqyera e te hapura e mjaft te shthurura, kur e keqja do te perhapet gjithandej dhe kur e verteta do te braktiset?”

Shoket e profetit u shokuan nga kuptimi I ketyre fjaleve pasi mendja e tyre se pranonte nje fakt te tille. Ata besonin se edhe atehere kur ne nje bashkesi te mbetej qofte edhe nje besimtar nuk do te perhapeshin keto semundje shoqerore. Ndikimi I ketyre fjaleve kishte sjelle nje atmosfere habie e cila do ti shtynte ata te pyesnin:

“Vertete do te ndodhin keto gjera O I Derguar I Allahut?”

pyesnin nga habia dhe nga ajo qe smund te besonin se gjera te tilla mund te ndodhnin.

“Betohem ne Zotin ne doren e fuqise te se cilit ndodhet jeta ime se do te ndodhin gjera edhe me te tmerrshme”, do tu pergjigjej i Derguari i Allahut. Perreth do te binte nje atmosfere e cuditshme dhe shikimet do te mjegulloheshin. Te tmerruar do mund te pyesnin:

“Cfare eshte me e tmerrshme se kaq o i Derguar i Allahut?”

Tablloja e mburrjes njerzore do te shtonte pas kesaj:

“Ta dini se ne cgjendje do te jeni ate dite kur te gjithe te keqijat te shihen si te mira dhe te mirat si te keqija!” Do te shkepusem dhe dicka nga ky hadith mqs ai tregon dhe gjendjen morale e jetesore te shoqerise ne ditet e sotme.

Ky hadithi-Sherif tregon se nje dite cdo gje do te kthehet ne te kundert dhe vlerat do te permbysen, e mira do te duket e keqe dhe e keqja do te shihet si dicka e mire, tradhetia dhe marrdheniet jashte martese do te stimulohen, terrori dhe kaosi do sundojne, besimi dhe Kurani do te merren neper kembe dhe besimtarete do te percahen e do te shihen si te rendomte, mjaft te keqija do te ligjrohen nga vete shtetet dhe te vertetat e besimit do te vlersohen si te prapambetura e jashte mode. Keto jane shenjat e permbykses se vlerave. Njeriu i kohes perjeton shumefishat e kesaj dhe besoj se do ti jetoje edhe per shume kohe. Aty ku njerzit nuk thirren ne te drejte, ne vendin e nderit, prestigjitet respektit pasojat qe vijne si rezultat i kesaj shkeljeje. kjo gjithmone keshtu ka ndodhur dhe sbesoj se do kete nje fat me ndryshe ata jane te paditur dhe te papergjegjshem. Per kete arsye shokete Profetit (sahabet) duke mos i pranuar ne shpirt keto gjera do te pyesnin:

“Edhe kjo do ndodhe o i Derguar i Allahut? pra do te ndalohet e mira dhe do te urdherohen te keqijat?”

-Po ka edhe me keq!

-E ceshte me e keqe se kjo O i Derguar i Allahut?

-Mjer ju ate dite kur do te heshtni para te keqijave dhe madje do ti stimuloni keto te keqija!

Pra ate dite kur do ti lini femijet dhe njerzit tuaj qe ti marre rryma e kohes dhe madje ne gjendjen tuaj, ne gjuhen dhe veprimet tuaja do ti nxisni ata edhe per me keq atehere kur brezi juaj do te harroje Zotin dhe do ta fshije Profetin nga shpirtat e tyre, ju do te jeni bere per tu qare hallin. Kur habia kishte arritur kulmin, fuqia po u shteronte, gjokset u ishin ngushtuar

dhe po merrnin fryme me veshtiresi me nje ze te vishkur, te humbur e pa force shoket e profetit do pyesnin:

-Edhe kjo ka per te ndodhur O i Derguar i Allahut?

-Po, dhe kjo sdo te jete fundi i te keqijave.

Ne kete moment i derguari i Allahut duke u betuar ne Zot transmetoi kete fjale te Zotit:

"Betohem ne madheshtine time se ne gjirin e nje bashkesie qe ka arritur ne nje suate te tille do te fus ndarjen dhe grindjen pa fund..."(hajseni,7/280,281).

Permes nje gjuhe mrekullore i derguari i Allahut tregon se cdo ti ndodhi ne te ardhmen asaj bashkesie ku nuk zbatohet ky obligim i rendesishem. Dhe ne jemi nen nje pergjegjesi te tille. Ne thellesite e zemres ndihet nje dhimbje dhe brengje qe vazhdon qe prej mese tre shekujsh. Padyshim qe ilac i kesaj dhimbjeje dhe brengje eshte kryerja dhe praktikimi si nje popull i kesaj detyre te larte profetike.

(kjo suate sic mund ti ndodhe nje xhemati ashtu mund ti ndodhe nje grupimi ashtu mund ti ndodhe nje familje ashtu mund ti ndodhe nje personi) lexuesi

2.Nevoja qe ndihet per thirrje dhe cfare perfitimi kemi nga ajo.

Njeriu i kohes tone ka nevojje me shume se ne vdo epoke tjeter per urdherimin e gjerave te mira dhe ndalimin e gjerave te gabuar.Pastaj dhe ardhja e profeteve merr fund me \Vulen e Profeteve(s.a.s) duke e mbyllur nje here e pergjithmone ate porte shpetimi.Ne te kundert ne ditet e sotme jetohet ne njemodsbesim dhe revolte te barabarte me ate te gjithë shekujve te shkuar,per rrjedhoje dhe ata qe i vene supet kesaj pergjegjesie do te perballen me vuajtje dhe mundime edhe me te medha se cdo njeri i epokave te shkuara.Per kete arsye shpresojme qe besimtaret dhe pasuesit e diteve te sotme do ti kalojne shume para paraardhesit e tyre dhe do te fitojne vend pas shokeve te profetit(sahabeve).Kjo detyre duhet te jete mbi detyrat njerzore tenjerzve e mbi gjithshka tjeter.Miresia e Zotit te Madherueshem do te jete sipas gjendjes se nevojave te njerzve.Meshira e Allahut kur ndahet ne mes te njerzve ne shumicen e rasteve ka nje raport negativ ne lidhje me pushtetin e personit.Sa me i dobet dhe i pafuqishem te jete nje person aq

me shume do te fitoje dhe do te kete prioritet ne meshiren e Zotit te Madherueshem.

Te pare ne prespektiva te ndryshme mekatet qe kane pushtuar zemren permes asaj qe degjojme dhe shohim na kane sjelle ne nje gjendje te mjeruar saqe netet i ka marre malli per emocionet dhe sexhadet per lotet e derdhura mbi to.Me kete gjendje qe i ngjan nje kufome te privuar nga dashuria dhe perkujdesja nuk e di se cfare fatkeqesish te tjera mund te presim.me tutje Zoti na ruajte mos e pesojme si djalli.Ne si njerez te shekullit te xx jemi bere si mishi me thoin me mekatin.nese do na hiqej perdja dhe te shihnim gjendjen tone shpirtore padyshim do te benim cmos te shpetonim sa me shpejt nga kjo gjendje.

Megjithse te dermmuar ,te shperndare dhe te shkaterruar Zoti na urdheron qe „te urdherojme gjerat e mira dhe te ndalojme gjerat e gabuara“nga nevoja qe kemi per meshiren e tij.... e gjendjes tone te vobekte dhe te dobet Allahu i madherueshem eshte i larte dhe meshirues,ndaj dhe ne per shkak te meshires dhe keqardhjes se tij te pafundme ne duhet ta falenderojme mijra here duke e permendur dhe kujtuar permes gjuhes tone dhe serish sdo ishte e mjaftueshme.

Shek.XX eshte shekulli i shembjes dhe permbyshjes se gjithshkaje ne emer te se vertetave shpirtore dhe kuptimore,aq sa shikimi eshte mjegulluar dhe trupat jane perthyer ne dysh.Perkundrejte kesaj klime mjaft te disfavorshme megjithse ne formen e nje peshperime akoma degjohet zeri i KryeZoterise(s.a.s) dhe jehona e atyre qe ai ka thene duke kaluar dimensionin e kohes dhe hapsires arrijme deri tek ne dhe a eshte kjo nje shprehje e meshires se pafundme e Zotit tone ndaj nesh.Ndaj dhe neve na takon te shprehim mirenjohjen tone ndaj kesaj miresie,duke mbushur thellesite e shpirtit tone me kete fryme jetedhenese,duke e pershtatur edhe frymemarrjen me kete ritem.Ata qe shprehin mirenjohjen ne kete shkalle jane edhe ata qe do te shpetohen.

Sadi Shirazi duke iu drejtuar profetit tone do ti thote:

“Lum ai popull ne anijen e te cilit je ti kapiten,je ti mbeshtetesi dhe perkrahesi!”Ne jemi brenda nje varke shpetimi ,kapiteni i se ciles eshte Zoteria i Universit(s.a.s).Tashme dhe kapiteni yne na therret dhe kerkon te mblidhen marinaret,”dhe vetem ata qe do marrin kete anije do te shpetojne ...”Se di nese se bashku do ta degjojme kete ze dhe do ti shkojme pas?

.....

le te mundohemi te tregojme permes ajeteve Kuranore shperblimet qe do tye fitohen ne kete bote dhe tjetren nga myslimanet qe do te zbatojne si duhet kete detyre me te cilen jane ngarkuar per te thirrur njerzit ne rrugen e shpetimit.Allahu i madherishem ne nje Ajet thote:

“Le te jete nga ju nje bashkesi qe fton me drejte,qe urdheron te mirat dhe ndalon te gabuarat.Vetem ata jane qe do te arrijne suksesin dhe shpetimin.”

(Al-i imran 3/104).

Gjithmone duhet te gjendet nje bashkesi ne mesin tuaj qe te “urdheroje gjerat e mira dhe te ngaloje ato te gabuarat” ,te ftoje ne te mbare dhe ti largoje njerzit nga e keqja,do tiu tregojte njerzve te drejten dhe do te jene aq te drejte sa do te largohen nga e keqja dhe mekatet sikurse ikin nga gjarperinjte e rrezikshem.Me nje shprehje tjeter ata do te jene si nje yll polar ne shoqerine qe do te jetojne.Anijet e kesaj shoqerie qe lundrojne ne oqeanin e kesaj jete te brendshme shoqerore duhet te ndjekin anijet e kesaj bashkesie,te pershtasin kursin e lundrimit me ta me qellim qe te kete shmangie dhe humbje sa me te vogla.Kjo bashkesi duhete te jete aq e motivuar sa qe ata do ti shohin te mahniten dhe ti vleresoje ata si nje permendore e mesimit te gjalle te urdherimit ne rruge te drejte dhe ruajtjen nga ajo e gabuar,qe te jene te besueshem.

Nese ne nje shoqeri skanje bashkesi qe te sillet dhe te jete gjithmone e tille ajo shoqeri ka marre fund,dhe deri sa te shfaqet ne saj nje bashkesi e tille ajo shoqeri ska mundesi te gjeje rrugen e drejte.Dua te ndalem edhe pak ne nje aspekt qe mendoj se eshte i rendesishem .Nese ne nje vend ska nje bashkesi qe urdheron ne te mira dhe ndalon te gabuarat,Allahu(xh,xh)garanton se populli i atij vendi do te jete i mbrojtur nga te gjitha fatkeqesite tokesore dhe qiellore.Nje garanci te tille ska se kush ta jape tjeter.Ja lajmi i Kuranit me kete ceshtje.

“Per sa kohe populli korrigjon vetveten,Zoti yt nuk e shkaterron vendin e tyre me te padrejte(Hud,11/117).Dhe une pas ketyre fjaleve te Kuranit duke u nisur dhe nga theniet e profeteve dhe te derguarve them se ne ate vend ku urdherohen gjera e mira dhe ndalohen gjerat e gabuara Zoti i Madherishem nuk leshohen fatkeqesi dhe probleme.Nese shoqeria meriton nje denim te madh per hater te asaj bashkesie fatkeqesia dhe problemet hiqen,pasi ajo bashkesi eshte ne nje lidhje komunikimi te vazhdueshem me Zotin e Madherishem,cdo cast dhe minute te jetes se tyre e kalojne duke

urdheruar ne te drejte dhe ndaluar te gabuarat.Jane te shqetesuar dhe te trazuar ne tegjithe qenien e tyre dhe perpeliten te perthyer duke e bere si konstant mendimin”Kujt ,ku dhe si tju shpjegoj”.

Kur hane ,kur pine ,kur flene a zgjohen jane te pushtuar vetem nga ky mendim.

Sikur ekzistenca e tyre merr formen e ketij mendimi.Per sa kohe qe roberit e kesaj te vertete shetisin ne rradhet e shoqerise kjo e fundit eshte e mbajtur ngate gjitha fatkeqesite dhe problemet tokesore e qiellore.Nqs duam tejme te sigurte duhet ti kthehemi menjehere detyres qe eshte edhe shkaku i krijimit tone.Duhet te dime pa medyshjen me te vogel qe cdo fatkeqesi vjen si rezultat i braktisjes se urdherimit per ne rruge te drejte dhe ndalimit ne ate te gabuar,dhe vetem atehere kur ti kthehemi realizimit te kesaj te fundit do te shpetojme nga cdo fatkeqesi.Asnje force tjeter adhurimi ska kete force magjike.Allahu i madherueshem mund te fundose ne thellesite e tokes nje person apo bashkesi qe ndoshta dhe fal namazin,viziton Qaben apo lexon lutje ndersa nje vend ku mund te jene shfaqur dhe dhjete persona te brengosur,te shqetesuar dhe qe kryejne detyrat e tyre eshte i siguruar dhe i mbrojtur nga Zoti i Madherueshem.

Per kete arsye disa burime izraelite transmetojne nje aspekt te tille:

“Kur u denua fisi i Hz Lut(a.s)ne mes tyre kishte mjaft njerez te shquar qe e kalonin naten duke u falur dhe ditën duke agjeruar,por asnjëri prej tyre nuk e kryente detyren per te urdheruar gjerat e mira dhe per te ndaluar ato e keqija.Edhe kur fisi i Hz Shuaib(a.s) do te zhdukej kushedi sesa vete atje falnin namazin dhe agjeronin.

Nuk ka popull apo fis te jete shkaterruar apo zhdukur kur kjo detyre eshte kryer si duhet,dhe historia nuk jep ndonje shembull.Ne te ardhmen shpresoj qe ta zgjeroj edhe pak kete teme nen driten largpamese te ajeteve e haditheve.E verteta e thirrjes ne siperfaqen e tokes dhe nevoja qe ekziston per te ,mund te analizohet edhe nga nje prizem tjeter. Urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi i atyre te keqija eshte dhe nje tregues qe njeriu eshte mekembesi i Allahut ne toke ,aq sa njeriu ka force te hyje ne materie duke u pajisur me karakter dhe nga vete karakteri i Allahut(xh xh).“Egoja“dhe“Uni“ jane vetem tek njeriu.Ai nepermjet shqisave perceptuese qe zoteron mundet ta njohe cilesite dhe madheshtine e Zotit permes fenomeneve te ndryshme duke gjetur dhe identitetin e tij te vertete.Identiteti qe i eshte dhene njeriut ,ajo qe zoteron edhe ndjenja e lirise qe buron prej saj eshte vetem nje njesi

matese.Njeriu ne baze te ketyre permes linjave imagjinare do te njohe krijuesin ,Zotin dhe forcen qe ai ka per cdo gje dhe do te bindet.

Njeriu duke qene i pajisur me keto veti dalluese do te thote qe njeriu eshte mekembes.pastaj Allahu(xh xh)do tu drejtohej engjejve“une do te krijoj mekembes mbi toke“,dhe do te krijonte Hz Adem(a.s) si babain e te gjithë njerzimit.Duke i dhen te drejten e shfrytezimit te te mirave mbi toke do te caktonte mekembesin e tij ne nje fare menyre.I zgjedhuri smundet dhe sduhet te dale jashte kufijve qe i ka catuar zgjedhesi.pastaj ajo qe duhet te cdo njeri eshte caktur dhe sanksionuar permes urdherave hyjnor te transmetuar nga profetet.Per sa kohe qe njeriu vepron ne perputhje me urdherat dhe ligjet e caktuara ai ka realizuar si duhet dhene menyre te persosur misionin e dhene.

Hasan Basri Hazretleri permes nje hadithi te transmetuar hedh drite mbi kete ceshteje.ne hadith thuhet:

„Kush urdheron ne gjerat e mira dhe ndalon te keqijat eshte vasal(mekembes)i Allahut,i te derguarit te Allahut dhe i Kuranit te shenjte“.Eshte detyre e cdo njerit te kuptoje dhe te tregoje Allahun e Madherueshem,ta njohe dhe te beje ta njohin te tjeret dhe me sjelljen e tij te tregoje se i perket atij,gjithashtu dhe i kuptimit dhe i shpjegimit te derguarit te Allahut dhe i Kuranit.ne prizmin e detyres futet edhe venia ne jete e parimeve te percjella nga Allahu dhe i derguari i tij dhe perjetimi i tyre.Madje do thonim se ne te njeten kohe keto detyra jane edhe shkaku i krijimit te njeriut.Domethene njeriu permes urdherimit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te keqija realizon dhe detyren e tij ne te njejen mase.Te gjitha keto jane dhe ndermjetesues te rendesishem qe do te sigurojne fitimin e pelqimit te Allahut nga njeriu hap pas hapi.

Dyrre Bint-i Ebi Leheb(r.anha) tregon:“nje dite i derguari i Allahut po mbante fillimin e rradhes kur nje njeri hyn ne xhami dhe i drejtohet atij duke e pyetur:“Kush eshte me i miri nder njerzit?“I derguari i Allahut i pergjigjet kesaj pyetje ne kete menyre:“me i miri nder njerzit eshte ai qe urdheron gjerat e mira dhe ndalon ato te keqijat,ai qe lexon shume dhe ai qe ka frike nga Allahu“.

Vertete me i miri nder njerzit eshte ai qe ndalon gjerat e keqija dhe urdheron vetem per te mirat duke e bere kete te fundit nje preokupim te vazhdueshem,ai qe nate dite jeton me mundim per te ndaluar te keqen duke mos u dhene as mundesine me te vogel qe keto te keqija te shfaqen,ai qe orienton boten shpirterore ne kete drejtim duke u frikesuar shume nga Zoti

,ai qe jeton jeten e tij si nje meshirim i shpalljes Kuranore ,ai qe bashkon vendet ku lartehet e verteta Kuranore duke vleresuar cdo mall dhe ngjarje nga ky prizem,ai qe interesohet dhe eshte i dashur me njerzit.Sipas mendimit tone kjo eshte detyra me e rendesishme.

Nese ndejme ndonje interesim apo perkujdesje per njerzit tane duke treguar se jemi te dhimbshem ndaj tyre ,gjeja me e bukur per ta demonstruar kete eshte qe te realizojme detyrimet qe kemi ndaj tyre.Gjeja me jetesore qe na del neve ne kete aspekt eshte ti urdherojme ne gjerat e mira dhe te ndalojme gjerat e gabuara.Atehere le te jepemi me mish e me shpirte qe ta realizojme kete kundrejte te gjithe njerzimit.

Pastaj kushdo qe merr persiper nje detyre te tille do te jete i shperblyer dhe i vleresuar nga Allahu i Madherueshem.Per kete Kurani Kerim thote keshtu:

„Nuk jane njelloj te gjithe njerzit qe besojne ne liber.Ka prej atyre qe kalojne naten mbi sexhde duke lexuar ajetet e Allahut ,keta besojne ne jeten e pertejme,ndalojne te keqen dhe nxitojne ne te miren.Ja ata jane nga te shpetuarit.“

(Ali imran 3/113,114).

Kuptohet qe kushdo qofshin ata qe e kryejne kete detyre ,qe besojne ne jeten e pertejme dhe ne vete Allahun do perfitoje nga shpallja Kuranore.A nuk jane ajetet e ngjashme me kete qe na udhezojne plote shpresa ne kete rruge?Njeriu i sotem ne vend te zemerimit,dhunes,shtypjes,rrahjes dhe vrasjes ka nevojte per zerin e ngrohte e keshillues,per dashuri,dhembshuri,kujdesje e fjale te embla.Nga ne sot pritet qe tu afrohem njerzve me dashamiresi,te degjojme rekimet e brendshme shpirterore te njerzve dhe te ndajme shqetesimet e tyre si te ishin tonat.Nese realizohet kjo eshte arritur realizimi i nje aspirate te shume pritur nga mbare njerzimi.

Ajo qe mahnit qofte ne lindje apo perendim eshte afrimi,kuptimi dhe perafrimi i fese islame.Si brenda dhe jashte ne nje mase relativisht te konsiderueshme shihet kthimi i njerzve ne fe.Sexhadet dhe shamite e harruara deri me dje sot ndajne me njerzit e bere njesh me to trishtimin e se djeshmesh,dhe kjo duke kaluar ne nje mase te gjere do te mund te hapet me shpejtesi gjithandej.Te gjitha keto duke qene padyshim shembuj konkret bejne qe zemrat te mbushen me dashuri e gezim.Sjelljet e papelqyeshme

dhe te neveritshme sikurse skane patur ndikim dje sdo kee as sot dhe as n eser.

Une kam degjuar se kane shpetuar shume duke gjetur rrugen e drejte ne fene islame te cilet sdo te perfitonin nga te mirat qe jep besimi nese do te vriteshin dje dhe do te shpreheshin“Shyqyr Zotit qe nuk vdiqem ne anen tjeter ne kohen e kaosit,se do te humbisnim jeten ne kete bote dhe ne tjetern.“

Eshte mjaft domethenese pergjigjia qe nje nga shokete profetit i jep nje tjetri ne lidhe me vrasjen e njerit nga shoket e profetit ne kohen e injorances te kryer nga ky i fundit.“Ti me qorton mua per ate veprim kur nepermjet dores time Allahu e coi ne parajse sepse ai ra Shehid.Po siku te vdisja une si do te vente halli im?Pasi une do te isha mosbesimtar ate dite dhe do te perfundoja ne ferr perjetesisht...”

Ne fakt nese do te bisedonit me dike qe ka fituar besimin pas nje periudhe erresire mosbesimi do te degjonit te njejtin ze.Cfare mendojne ata njerez tek sa vene koken ne sexhde e qajne me denese kur kujtojne veprimet e tyre te gabuara ne te shkuaren?Te them te drejten jam shume kureshtar ta mesoj. Ne lidhje me kete ceshtje do mundohem te sjell nje shembull nga“shekulli i lumturise”.

Amr b. As(r.a)eshte nje nga shoket e profetit qe ka patur nje jete te gjate e te frytshme.Ne shtratin e vdekjes ishte aq i shqetesuar saqe spo gjente prehje.Abdulla b. Amr b. As(r.a) nje nga dijetaret e shquar dhe i biri i ketij gjeniu te politikës dhe nje ushtaraku te vjeter i drejtohet te jatit:“Baba!Ti zemeroheshe shume dhe ste pelqenin njerzit qe trembeshin nga vdekja gjate jetes.Tani shoh se edhe ti po perjeton te njejtin shqetesim.“Amr b.As(r.a)qe po jetonte castet e fundit ne shtratin e vdekjes i pergjigjet:

„Ne jete kam kaluar tre faza te rendesishme qe me shtyne te perjetoj emocione te ndryshme.Fazen e pare e kalova ne mosbesim dhe slashe te keqe pa bere kunder te derguarit te Allahut(s.a.s)dhe atyre qe besonin.Ne cdo vend u dilja perpara ,madje i ndoqa dhe si lashe te qete dhe kur u larguan ne Abisini.Ne cdo beteje u rreshtova perballe myslymaneve dhe shume nga ta qe ishin me mua vdiqen ne mosbesm.Zoti me ruati dhe me tregoi rrugen e drejte.Ngaqe nuk vdiqa ne ate kohe e kam falenderuar e lavderuar Zotin nate e dite.

Ne fazen e dyte kam qene gjithmone te te Derguarit e Allahut dhe sjam ndare nga ai ne asnje moment.Ne kete faze kam jetuar nje jete te ndershme

e te drejte dhe shume nga Sahabet e tyre vdiqen ne kete kohe .Me vjen keq,dhe mendimi:“sikur te kisha vdekur ne ate kohe“me ka munduar gjate.

Ne fazen e trete Profet(s.a.s) nuk ishte ne mesin tone pasi kishte shtegetuar ne vendin e me te larteve,dhe mundoheshim te zgjidhnim vete problemet qe dilnin ne ate kohe.Per shume gjera nuk jame i qete shpirterisht dhe vdekja me erdhi ne kete faze.Ja per kete sjam i qete.

Ne sot jemi deshmitare me shume se ne cdo epoke tjeter te njerzve qe i drejtohen me lutje falenderimi e perulen me nderim para Allahut te madherueshem qe nuk vdiqen ne ate faze te erret qe Amr b.As(r.a) falenderonte Allahun qe nuk kishte vdekur.Nes atyre njerzve do te mund tju pergatisnim nje jete te sigurve ne fazen e dyte e te trete do te mund tju mundesonim qe edhe momentet e fundit ti kalni ne te njeten ndjenje falenderimi dhe lavderimi.

Ne kete sherbim nuk ka kufi. Per ata qe synojne te jene besniket e dashamiresise ...Besnik dashamiresie eshte ai qe hero qe ja perkushton jeten misionit te afrimit te njerzve me Zotin. Preokupimi i tij kryesor eshte ti beje njerzit te duan Zotin dhe tu hape atyre rrugen per ne perjetesi. Ne ditet e sotme eshte bere mjaft e rendesishme detyra qe i bie ketij heroi. Pavarsisht se ne shume vende shihet nje kthim dhe drrejtin drejt fese dhe kjo neve na jep shprese,njerzit jetojne shume larg Zotit. Detyra per ti shpetuar ata nga ky kurth eshte mjaft e veshtire por dhe mjaft e dobishme. Sikurse seshte e lehte ti thuash dikujt ne nje ambjent mbytes e vrases “rri se je mire “eshte edhe me e veshtire te ruash brezat qe po rreshqasin drejt ketij kurthi,ti besh ata te mbajn r te forte lidhjen me Zotin dhe te paprekshme pasurine e tyre shpirterore. Eshtedeyrim moral perne per it kaluar keto veshtiresi. Dashuria,mirekuptimi dhe toleranca jane mjaft te rende3sishme per te kaluar veshtiresite. Perballe nesh kemi shume njerez qe jane ne mes te fitimit ose humbjes se jetes se perjetshme,dhe ne duam qe ata te fitojne ate ,pavarsisht se se kane kuptuar ende rrezikun qe ju kanoset. Madje shpesh here na kundervihen,zemerohen me ne,dhe na paragjykojne ne perpjekjet dhe synimet tona. Nese u pergjigjemi me te njejten monedhe ata do te humbasin jeten e perjetshme. Per ta kuptuar se ndodhen ne nje pike aq kritike do ta kuptonin perpjekjen tone e do te vraponin drejt nesh duke na mbushur zemrat me gezim dhe megjithse me paragjykimet dhe kunderveniet e tyre ne duhet te kembengulim ne perpjekjet tona. Dhe profetet ,te derguarit dhe njerzit qe i kane perkushtuar jeten kesaj rruge ,qe jane si diell e hene ne qiell e hene ne qiellin njerzor kane vepruar ne kete

menyre. Ashtu tronditja dhe renkimi i heshtu i Hz Nuh(a.s) kur dallga i rrembeu te birin qe duke mos kuptuar rrezikun e mbytjes kembengulte pre te mos hypur ne anije dhe sot perballe mijera ngjarjeve qe po ndodhin sot duhet te ndjehemi njelloj. Patjeter qe duhet te jete domethenese per besniket e dashamiresise shqetesimi dhe preokupimi i HZ Ibrahim(a.s) perkundrejte te jatit qe adhuronte idhuj dhe perpjekja e tij qe ne cdo menyre ti tregoje atij te verteten .Madje nuk duhet te na hiqet nga syte gjedja e Profetit teksai shqetesuar do ti luftoje xhaxhait te tij Ebu Talibit i cili e kishte mbrojtur dhe strehuar per mese 40 vjet “Xhaxha i dashur qofte dhe nje hereme prano mua (si profet) qe ditet e gjykimit te mund te ndermjetsoj per ty” .Dhe serisht ai i cili perkundrejt fisit te tij qe e kishte perndjekur dhe debuar do tju pergjigjem me dashuri dhe perkujdesje duke u bere serisht ai fitues sepse rruga e shpetimit dhe e fitimit te jetes se perjatshme te miliona njerese do te kalonte nga kjo ure durimi.Po kjo detyre e shenjte eshte nje detyre per besniket e dashamiresise.Eshte detyre e figurave te shquara qe si meshirues te dashurise dhe perkujdesjes nuk do te gjenin as ne parajse prehje nese sdo mund tju tregonin rrugen e shpetimit individeve te shoqerise ku jetonin ,eshte detyre e atyre qe braktisin deshiren per te jetuar qe te ndihmojne te tjeret te jetojne.....eshte detyre e atyre vullnetareve te dashamiresise qe thone “Nese shoh shpetimin e besimit te popullit tim do te pranoja te digjem ne plaget e ferrit .Sepse ndersa trupi do digjej shpirti do te behej mal nga gezimi.Nese nuk shoh shpetimin e besimit te popullit tim nuk e dua as parajsen se edhe ajo per mua do te ishte si burg...”dhe detyre e te perkushtuarve ne rrugen e ZOTIT qe shprehen “O ZOT ma zmadho aq shume trupin sa te nxe gjith ferrin e te mos hyje aty krijese tjeter “.

Nese praktikisht realizmi i ketyre fjaleve eshte i pamundur dhe te jete qofte dhe nje shfaqe momentale e gjendjes shpirterore ,eshte mjaft e rendesishme pasi shpreh dashurine e pakufishme te ketyre njerese per popullin e njerezit e tyre .

Trasmetohet se kur i Derguari i Allahut (s.a.s) ka degjuar se nje pjese e popullit te tij do hyje ne ferr ka rene ne sexhde dhe ka thirrur “Populli im!Populli im!”

Cfare dhembshurie eshte kjo qe e ben te haroje parajsen,hyjnite e shume gjerate bukura te asaj bote dhe ne ate moment te filloje te qaje pareshtur. Dhe derisa te thuhet”Tashme ngrije koken! Ndermjeteso dhe ndermjetesimi do te pranohet!” Ai sdo te ngreje koken nga toka dhe do te qaje me denese duke thirrur “Populli im!Populli im!” Kjo ishte shprehja e

meshires dhe dhembshurise se ketij njeriu te larte ndaj popullit te tij. Kjo e ben ate besnikun e dhembshurise me te madhin. Asgje smund te behet nga keta nes nuk kalohet mire me njerzit, nuk gjendet rruge per tu marre me problemet personale, me lumturi familjare dhe preokupimi jetesor duke qare dhe hallet me njerzit. Pa qene nje besnik dhembshurie eshte e pamundur te behet sic duhet detyra per te urdheruar ne te mire dhe per te ndaluar gjerat e gabuara.

3.Thirrja (Tebliğ) eshte dhurata me me vlere.

Po ta vleresonim thirrjen nga prizmi i te qenit nje dhurate do te mund te thonim keto gjera: Te aferme tuaj ne raste te vecanta si festa ,gezime e dasma u jepni dhurata. Para se te zgjidhni nje dhurate do te tregoheni te kujdesshem qe te conit nje dhurate te goditur duke u menduar shume per ta gjetur ate dhurate. Ky eshte nje veprim normal dhe mjaft i goditur sepse jo vetem do te jepnit nje dhurate por do te plotesonit nje nevojë te personit nepermjet asaj dhurate. Ne jeten e perditshme kur planifikoni te bisedoni me njerzit e se njejetes rruge duhet te tregoheni po aq te kujdesshem sa ne perzgjedhes te nje dhurate qe mund tju parashtoni ato gjera per te cilat kane me shume nevojë. Pa harruar se njeriu i sotem ka nevojë per me shume per ne j fjalet te mire e keshille. Dhe dhurata me e vlefshme eshte urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi i atyre te gabuara. Per kete qellim per realizimin sa me te mire te kesaj detyre te larte personat te percaktojne si duhet nevoja e tyre. Ne te kundert dhe gjerat e mira do ti duken si me te keqijet duke patur nje ndikim negativ. Ska vlere te flasesh per gjera te medha nje personi pa i qartësuar mendimet nese ai eshte dhene pas mendimeve e fiksimeve te ndryshme ideologjike

Si tedeptojme lirisht drita e yjeve te botes shpirtore ne nje zemer qe i ka mbyllur portat. Per tju afruar nje njeriu duhet te dime mire se per cfare ka nevojë, me qellim qe fjalet qe do ti thuhet ta beje te mendohet, ta trondisin dhe ta sjellin ne vete. Ndonjehere thirrjet shpirtore plot shqetesim mund te sjellin ne vete dhe e nxisin tekuptoje boshllekun qe ka. E cdhurate mund te kete me teper vlere se ato fjale te bukura dhe ajo thirrje shpirtore plot shqetesim qe mund ta sjellin ne vete ate njeri. Jane ato fjale qe do ti thone ndal nje drejtimi te gabuar duke e drejtuar ne rruge e duhur. Udhezimi ne te drejte eshte dhurata me e rendesishme ne gjithë dhuratat duke qene

dhe vete sinteza kuptimplote e “te urdhetuaritte gjerave te mira dhe ndalimit te te gabuarave.”

Buhari dhe muslim se bashku transmetojne kete ngjarje:

“ Beteja e Hajberit vazhdonte per dite me rradhe duke mos patur asnje rezultat pozitiv pasi cifutet e Hajberit rezistonin me gjithë forcen. Nje dite i Derguari i Allahut(s.a.s) tha:” Neser do ta mbaje flamurin ai qe e do Allahun dhe te Derguarin por edhe qe Allahu dhe i Derguari e duan ate”. Kjo per nje Sahabi ishte surpriza me e madhe dhe cdo njeri e deshironte me te madhe qe ky nder ti perkiste atij. Ata do te vendosnin vellane besimtar para vetes se tyre ne cdo ceshtje,p.sh ai qe kishte me shume nevojë per nje pike uje ne castet e funditdo te kerkonte qe ajo pike uji ti jepej vellait aty prane qe renkonte “Uje”. Do ti jepnin vellait besimtar me gjithë zemer,pasurine,pronën e cdo gje por fjala qe thuhet sot ishte sihariqi i garantueshmerise te te qenit i dashur per Allahun dhe te Derguarin(s.a.s). asnjëri sdeshte qe ta humbiste kete shanc dhe smund te vinte vellane para ne kete ceshtje uke aspiruar qete ishte vete ai qe do ti takonte ku nder i madh. Madje dhe Hz Omer(r.a)njeriu me karakter stoik ne lidhje me kete do te thoshte:

“Asgje per tu dukur sma deshte shpirti dhe as qe me shkoi ne mendje qe te me dorezohej mua flamuri pasi pas sja ishte garancia e te qenit i dashur nga Allahu dhe i Derguari(s.a.s). sahabet skishin mundur te flinin deri ne mengjes duke menduar te emocionuar “valle kujt do ti takonte ky nder i madh”? Dhe te nesermen me te njeten aspirate kishin zene rreshtat e pare ne faljen e mengjesit. Pas Namazit flamuri do ti jepej atij qe i perkiste . pas faljes kur i Derguari i Allahut do te kthehej nga xhemati te gjithë syte do te perqendroheshin te i pushtetshmi ite dy boterave dhe do prisnin me padyrim fjalet qe do dilnin nga goja e tij. Pas pak buzet do te leviznin dhe nga goja qe kundermonte arome parajse do te dilte nje fjale e vetme mjaft e rendesishme qe do ishte emri i njeriut me me fat ne bote. Emocionet kishin arritur kulmin dhe casti i shumepritur kishte ardhur, i Derguari i Allahut me zerin e tij te sjellshem e plot takt do te pyeste:’Kush eshte Aliu?’”

tashme cdo gje ishte e qarte ,njeriu me me fat ishte Hz Aliu(r.a) por ama kishin shpres akoma se Hz Aliu(r.a) ishte i semure nga nje semundje shume e rende ne sy. Zoteria yne e thirri prane tij dhe me gishtat e bekuar e i preku syte pasi i afroi te goja dheHz Aliu(r.a) u sherua duke mos vuajtur me nga ky shqetesim gjate gjithë jetes. Si rezultat flamuroi kishte kaluar ne duart e atij qe duhej dhe Hz Aliu(r.a) u nis drejt hajberit. Papritur u kthye dhe ju drejtua te Derguarit te Allahut(s.a.s):“O i Derguar i Allahut!Mbi cfare gjeje

te lufto me ta?Cfare propozimi mund tju dergoj atyre?” I pushtetshmi i dy boteve i dha kete pergjigje:

“ Deri sa te shkosh te ata mos e fillo menjehere luftimin. Pastaj ftoi te behen myslyman. Ne qofte se pranojne gjaku dhe malli i tyre eshte i mbrojtur. E drejta dhe drejtesia e jetes se pertejme i perket Allahut. O Ali?betohem per Zotin se ai qe shpeton permes teje eshte me me vlere se si qe mund te harxhoje ne rrugen e Allahut siperfaqen e tokes plot me deve te kuqe.”

Qe nga ajo dite e gjere me sot cdo ushtar i ushtrise islame kudo dhe kurdo qe te pergatitet per beteje duhet ta degjoje mire kete mesazh dhe e ka tedetyrueshme te veproje sipas ketij urdheri. Duke marre parasysh ato qe ka bere i Derguari i Allahut nga njera ane,dhenga ana tjeter ngjarje te mbushura plot ne epokat para nesh shohim se urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi i gjerave te gabuara eshte praktikuar sistematikisht. Ne vendin qe mendohet te shpetohet para ushtrise do te cohen ekipet e shpetimit te cilet duke cuar drejtesi e zbusin atmosferen ne dobi te myslimaneve. Nes kjo rruge per perhapjen e islamit jep rezultat ai vend futet vete ne bashkesine islame,nes pala tjeter reziton dhe pengon ne hapjen eislamit atehere kalohet ne gjendjen per te triumfuuar duke u sjelle sipas principeve te lartpermenduara. Pra para se gjithash atyre u behet thirrje per te perqafuar islamin pasi te jesh ndermjetes per shpetimin e dikujt eshte me me vlere se te harxhosh ne rugen e Allahut siperfaqen e tokes plot medeve te kuqe.

Si rezultat per nje mysliman dhurata me e bukur qe mund ti ofrohet njerzimit sikurse e paraqitem me lart e shte realizimi i detyres te urdherimit te gjerave te mira dhe ndalimin e gjerave te gabuara. Pa prishur raportin ne cdo kusht a ambjent qofte kryerja e kesa detyre me tolerance e mirekuptim ,pa renene pesimizem ,merzitur apo demoralizuar eshte dhurata me e madhe dhe meme vlere.

4. Thirrja kerkon vazhdueshmeri.

Detyra e te urdheruarit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te gabuara kerkon vazhdueshmeri dhe durim. Nje nje Ajet kjo shprehet keshtu:

“Ju jeni nje popull i mbare qe beson Allahun, ka dale per njerzit , urdheron te miren dhe ndalon te gabuaren. ”(Ali imran,3/100).

Po te shqyrtohen me me kujdes thenjet qe permenden ne Ajet do te kuptohej me mire kuptimi Kuranor i percaktimeve te mesiperme. "Kyntym"që perdoret ne arabisht do te thote "u bete". Zgjedhja e fjales qe do te thote u bete dhe "jo ishit" ne Ajetin Kuranor eshte mjaft kuptimplote. Behet fjale per nje kthim me pas ,(kejnuret)pra ne fillim nuk ishit por u kthyet me pas, se ska as ndonje kenaqesi te qenurit qe ne fillim. Ato qe perftohen me vone kane vlere, atehere vazhdueshmeria e kesaj gjendjeje lidhet me pranine e kushteve qe e perfitojne ate gjendje.

" Ju u bete me te miret nder popujt ". Ky eshte tipar i fituar me vone ndaj dhe mund te humbase. Miresia eshte dicka e trashegueshme. Ne skemi ndonje diference nga ai qe lind ne Moske apo ne ndonje vend tjeter , te gjithë jemi krijesa te formuara nga nje pike e ngjizur. Ndersa anen tone shpirtore dhe karakterin tone e ben ndryshe nje faktor tjeter duke na vecuar nga njerzit e tjere.

Ketu me neve nenkuptohet i gjithë populli qe beson i cili eshte i paisur me miresi qe ne zanafille. Por kjo vecori seshte dicka e meshiruar dhe e rrjenjosur mire ne karakterin e njeriut, kjo bashkesi ka trasheguar disa kushte dhe ka arritur nje nivel te tille i cili ndonese i arritur ne disa kushte nuk garanton vazhdueshmeri. Nese braktisen keto kushte humbet edhe kjo vecori.

Zoti i Madherueshem nepermjet shprehjes, nese zbatoni urdherin ne te mire dhe ndaloni te gabuaren do te jeni me te miret ,nenkupton edhe kushtin e pare qe na ben ndryshe. Nga ky kusht i pare dhe duke pare dhe te kunderten e Ajetit dhe duke u munduar ti japim nje shpjegim do thonim se "Ne qofte se nuk urdheroni ne te mire dhe ndaloni te keqen do te beheni me te keqinjte nder njerzit". I Derguari(s.a.s) e forcon edhe me teper kete nepermjet shume haditheve te transmetuara dhe shume ngjarjeve te lidhura me Sahabet. P.sh ky popull qe e ka patur per nder puthjen e uzengjise se kalit per sakohe ka urdheruar ne te mire dhe ka ndaluar te

gabuaresh ka mbetur gjithmone i larte dhe kur ka braktisur kete detyre ka arritur ne nje gjendje sa te puthe uzengjizen e nje kali. Besoj se dhe gjendja e mjeruar dhe prapambetja ne shume drejtime jetesore te botes islame duhet te jete nje mangesi e kesaj detyre jetesore.

Nese lihet kjo detyre nderpritet begatia ,mendimete behen te paqendrueshme dhe gjykimet behen te pavlere, cdo jaleedhene mbetet njegenjeshter e kote. Mund te thuhet mjaft fjale magjike dhe te medhaja por nese ato fjale nuk vihen ne praktike su mbetet asnje lloj vlere. Keto cojne ne nderprerjen ekesaj begatie pasi humbja e frymezimit ne mendime dhe ide cojne ne prapambetje dhe regres si ne planin kulturor dhe ne planin teknik. Sot eshte bere dicka e pashmangshme e fatit te myslimaneve qe te jene te varur ne dhume fusha duke kerkuar ndihmen e tjereve. Rrejna ne boten islame fillon njekohesisht me shkeputjen nga besimi. Me tutje do te mundohemi te analizojme kete gjeresisht duke u munduar ta ilustrojme me shume shembuj. Duke shqyrtuar me kujdes aspektet qe preken ne Ajet le te kthehemi ne ceshtjen kryesore. Ajeti i mesiperem thekson se detyra e te urdheruarit ne te mire dhe i ndalimit te gabuarave kerkon nje **vazhdueshmeri**. Ne nje tradite thuhet keshtu duke perforcuar kete mendim :”Nese shihni nje te keqe largojeni me dore. Po nuk mundet largojeni me te thene. Po smundet prape largojeni me zemer por dijeni se jeni te dobet ne besim”.

E keqe(Mynker) eshte gjithshka e papelqyeshme ne fene islame. Ndaj cdo myslyman duhet te nderhyje ne dicka te papelqyeshme nga feja. Realizimi i kesaj varet nga kushtet ne te cilat ndodh kjo e keqe. Sidoqofte duhet te kete perpjekje per te ndryhuar kete te keqe dhe kjo kerkon vazhdueshmeri. Besimtarit i del qe ne rradhe te pare re

mundet ta largoje te keqen me dore, nes smundet ta largoje me fjale dhe smundet per kete ta largoje me zemer duke shfaqur besim te dobet. Pas kesaj as qe mund te behet fjale per besim pasi pajtimi me te keqen eshte shenje largimi nga besimi. Largimi me zemer duhet te kuptohet keshtu. Njeriu ben cmos te mos gjendet ne te njetin vend me nje person i cili e ben te ndjehet keq, duke mos dashur te ndaje asnje mendim apo opinion. Dashuria dhe zemerimi smund te ndjehen ne te njejten kohe, ate qe urrejme smund ta ndjejme prane. Besimtari qe spajtohet me te keqen arrin te ruaje gjendjen e tij shpirterore, por seshte vetem kjo ajo qe pritet nga ky besimtar. Moepajtimi me zemer duhet te pasohet nga nje e thene ose nga nje veprim konkret. Po edhe ky mospajtim me zemer eshte nje tregues i fatit qe e keqja eshte e keqe. Ajo smund te jete e pranueshme nga besimi, smund te pelqehet nga besimtari. Ajo smund te heshte apo te beje sikur se sheh kur nje e keqe e tille behet edhe nga njerzit e tij, pasi kjo do ta bente edhe ate bashkfajtor. Besimtari duhet te jete ne nje reflektim te vazhdueshem. Ajeti dhe Hadithi neve na japin neve kete mesim.

Njeriu mund ta beje kete me dore dhe me gjuhe, me te shoqen dhe femijet pasi eshte me i lire ti perdore te dyja. Ne ato vende ku dora smund te perdoret duhet te vihet ne perdorim gjuha. Kjo metode duhet te perdoret me gjakun e afert. Nese smund ta beje kete duhet ta beje nje analize te mardhenjeve shpirterore qe e lidhin me te. Kjo mund te quhet nje bojkot sepse ai qe ben vepra te keqija e ka shkeputur lidhjen qe ka me Zotin. Besimtari ndaj atyre personave qe shkepusin lidhjen qe kane me Zotin duhet te zene nje pozicion kritikues dhe qortues. Pasi lidhjen qe kane me ata

njerez duhet ta pershtase me lidhjen qe ka me Zotin. Raporti me njerzit me njerzit qe shkepusin lidhjen me Zotin dhe te Derguarin e Allahut(s.a.s) duhet kaluar edhe nje here parasysh.

Dhe Sahabet vepronin ne te njejten menyre. Kur po debatoj ne lidhje me roberit e betejes se Bedrit mendimi i Hz Omerit(r.a) eshte shembulli me i spikatur i saj.

“O i Derguari i Allahut,cdo njerin dorezoua te afermve te tyre dhe ta mbarojne ata kete pune. Hz Hamzase dhe Aliut jepu vellezerit e tyre ti vrasin ndersa mua mi jep kusherinjte e mi qe tu jap denimin qe meritojne. Sepse keta rober jane armiqte te islami dhe seshte e drejte te mos i denojme.”

Ne fund te debatit ky mendim sdo pranohej por ja vlen te permendet si nje ragim i duhur i nje besimtari i veprimeve te keqija. Po ta permbleddhim besimtari duhet te marre si njesi matesi raportin qe kane njerzit me Zotin per te ndertuar nje raport dhe nje lidhje me ta. Ju smund te keni nje miqesi te mirefillte me njerzit qe jane larg Zotit. Veprimi me i vogel eshte mospajtimi me zemrat dhe kjo kerkon nje vazhdimesi. Dhe ne duhet te sillemi si Sahabet. Nese ne nje krah te peshores eshte dashuria per Allahun dhe te Derguarin e tij(s.a.s) dhe ne krahun tjeter jane njerzit tone te afert por qe jane larg Zotit pa nderhyrjen me te vogel dashuria ndaj Allahut dhe te derguarit duhet te triumfoje. Por jo vetem ne aspekin e dashurise me ane te urdherimit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te keqija e verteta dhe drejtesia duhet mbajtur mbi gjithshka,aty ku arrin dora te perdoret dora,aty ku fjala ndikon me shume te predoret fjala,dhe aty ku asnjera nga te dyja skane ndikim duhet te nderpritet raporti qe ekziston dhe cdo lidhje dhe afrimitet duhet te vleresohet edhe nje here. Nese raporti qe ekziston me nje person bie ne kundersiztim me raportin kundrejt Allahut(xh,xh) dhe te Derguarit te Allahut ky raport do ta demtojte ate person. Ne anen tjeter kjo detyre ka edhe aspektin shoqeror. Urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi

i gjerave te gabuara futet dhe ne pergjegjesite e vazhdueshme qe ka shteti. Shteti eshte nje organizim qe mund ta largoje te keqen duke nderhyre praktikisht. Shteti eshte i plotefuqishem per te rregulluar me doren e tij semundjen shoqerore,si prostitucionin,alkolin,bixhozin dhe shume te keqija te tjera. Ne ato vende ku individi sarrin dot shteti vepron mjaft lehte. Asnje individ smund te gjykoje dike per tradheti bashkeshortore por konsumim alkoli apo lojra bixhozi dhe smund ti ndaloje keto me doren e tij keto te keqija. Me lart e permendem se ku mund te nderhyje individi por tani po e marrim ceshtjen nenje plan shoqeror me te gjere dhe ne kete aspekt kjo detyre e larte mund te merret persiper vetem nga shteti duke qene detyra parimtare e tij. Cdo shtet per gjate gjithë ekzistences se tij duhet te kryeje si duhet detyren e tij. Nese shteti tregohet i dobet per realizimin e kesaj detyre populli duhet te ngreje zerin e tij dhe ne zgjedhje duhet te jape reagimin e tij permes votes. Kjo nga nje ane formon frontin per te urdheruar nete mira dhe ndaluar ta gabuarat. Ja vlen te citohet nje panorame e jetuar ne shekullin e lumturise. Sad b.Ebi Vakkas(r.a) eshte nje nga Sahabet e shperthyer ne parajse. Ne kohen e Hz Homerit(r.a)eshte nje nga ryekomandantet e ushtrise qe clironte tiranin duke u bere dhe administratori rajonal i kesaj province. Duke qene se te dera kishte vendosur nje roje populli ankohet tek Hz Omer(r.a) dhe kerkojne ta takojne pa ndermjetes. Hz Omer(r.a) pyet nese ka ndonje tjeter dhe i thone qe nuk fal namazin mete tjeret. Sigurisht ky ishte opinionin e tyre pasi as qe mund te mendohej qe nje Sahab si Sad b.Ebi vakas nuk falte namaz mete tjeret. Ajo qe dua te them eshte sesi populli kontrollon te zgjedhurit dhe drejtuesit e tij. Dhe ka nje kontroll reciprok mes popullit dhe shtetit. Ne kete menyre sigurohet edhe drejtesia e rendit shoqeror por edhe shteti me popullin ruhen nga e keqja. Po te analizojme situaten aktuale ne boten islame do te shohim se as shteti as populli nuk luajne rolet e tyre kryesore. Nderkohe qe njerzit po kryejne paturpesite nga me te ndryshmet shteti mbetet i pafuqishem per te vepruar madje edhe nen emertime

e tituj te ndryshem arrin te nxjerre dhe ligje per mbrojtjen e tyre. Ka shembuj reale ku mjaft te keqija kryhen permes dores se shtetit ne mjaft vende. Detyra kryesore e shtetit eshte ruajtja e rendit dhe e moralit shoqeror permes ligjeve ndeshkimore per abuzuesit. Individidi mund te denoje ne emrin e tij ate qe vjedh ,qe mashtron ,grabit apo tradhton pasi ateherë do te behej nje kaos i vertete ku gjithsecili do te dilte rugeve per te vendosur drejtesi duke vrare kedo qe ai mendon qe eshte gabim.

Permes kesa kuptojme se urdherimi igjerave te mira dhe ndalimit te te gabuarave ka nje kufi qe arrin nivelin shteteror dhe aty vetem shteti mund te nderhyje. Ka edhe nje dimension qe mund te realizohet edhe nga individidi duke perdorur gjuhen dhe mospajtimin me zemer. Eshte nje pergjegjesi individuale shoqerore qe te tregohen te keqijat e marrdhenjes jashte martesës ,vjedhjes,grabitjes e mashtrimit dhe te tregohet perpjekje per te penguar perhapjen e ketyre semundjeve te keqija shoqerore. Nese veprimi me dore eshte nje detyre meteper shteterore ,largimi me goje lidhet ngushte me veprimin e besimtareve. Ne aspektin e pergjithshem klasa e dijetareve ka nje pergjegjesi dhe me te madhe ne lidhje me kete aspekt. Ata qe mbeten ne gjendjen e trete te veprimit ne zemer jane te vobektit dhe te pafuqishmit. Nese i gjithe populli mjaftohet vetem me nje mosaprovim me zemer kundrejt te keqijave qe ndodhin ateherë ai popull eshte i vobekte dhe i dobet. Sikurs kjo detyre u shkallezua ne tre shtresa dhe per njeriun mund te bejme nje ndarje me tre nivele. Ndonjehere del nje shtate ku individidi duhet te nderhyje konkretisht. Le te themi dikush ka hapur nje qender te lojrave te fatit pa lejen e shtetit. Ti shkosh ketij personi dhe ti thuash nese nuk e mbyll kete qender do ta padisesh ne shtet eshte nje veprim me dore i individit. Nese kjo qender eshte hapur me leje nga shteti dhe individidi ska force per ta mbyllur kete aktivitet personit pergjegjes duhet ti shpjegohet te keqijat e ketij veprimi me anen e gjuhes. Nese edhe kete here eshte e pamundur ateherë duhet te nderpritet cdo lloj kontakti me kete person duke patur

dhepergjegjesi per te larguar edhe te tjeret nga ky njeri dhe nefund ska vend per nje ceshtje te katert. Nga sa u tha me siper nga cdo prizem qe do ta shohim kete ceshtje vazhdueshmeria qe kerkon Ajeti „u befte“ eshte evident ne cdo suate. Aty ku forca sna mjafton ku shteti nuk nderhyn ne keto ceshtje ,ne kohet ku mbare populli e ka braktisur kete detyre te shenjte eshte obligim moral per ta realizuar kete detyre me ane te gjuhes dhe zemres. Sduhet ta harrojme qe fitorja me te diturit vjen nga bindja e jo me detyrim.

5.Dimensioni i thirrjes ndaj Zotit dhe ndaj popullit.

Te urdheruarit e gjerave te mira dhe ndalimit i gjerave te keqija eshte nje detyrim qe duhet te behet per detyrim te Allahut (xh,xh) ose per llogari te drejtesise se perbashket te zbritur nga Allahu (xh,xh) ne mes te njerzve. Se pari pergjegjesia per thirrje dhe shpetim eshte nje detyre qe duhet realizuar kundrejt Allahut(xh,xh). Atehere cdo besimtar duhet te vrapoje pas saj ashtu sikur vepron pas namazit. Kur urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi i gjerave te keqija lihet pas dore dhe kur e keqja pushton vendin gjithandej kjo detyre behet edhe me e rendesishme se detyrimet personale si namazi, haxhi dhe dhenia e zekatit, per te cilat as qe mund te flitet kur lihet kjo detyre kryesore. Ne ato raste kur te mirat ndalohen dhe stimulohet e keqja kjo detyre behet nje nga pergjegjesite qe i interesojne popullit ne keto etapa te erreta. Personalisht ne ditet e sotme nuk di ndonje detyre me te larte e me fisnike se kjo detyre. Kam bindjen se ata qe e kalojne jeten duke u mbushur perplot ne kete detyre do te sigurojne dhe kete jete dhe ate te pertejme. Qofte duke ju falur njerzve ose duke i keshilluar permes librave, secili duhete ta realizoje sa me mire kete detyre. Pavarsisht nga metoda dhe teknika qe do te perdoret duke u perpjekur per te urdheruar ne te mire dhe ndaluar te keqen duhet te veprohet me mjaft takt dhe politike. Pasi vazhdueshmeria dhe ndikimi i dickaje eshte ne perpjesetim te drejte me sjellen e duhur e me takt. Nese kjo detyre e shenjte nuk do te realizohet me singeritet dhe perkushtim asnjehere s’do te arrihen rezultatet e duhura, madje ne ditet e gjykimit do te jete pergjegjesi per vete personin. Ata qe urdheruarojne ne te mire dhe ndalojne te gabuaren sikurse thuhet edhe ne hadith “Eshte ne rrugen e duhur ai qe ben perpjekje ne drejtimin qe te

lartesojne emrin e shenjte te Zotit” duhet te kete parasysh qe lufta dhe perpjekja qe bejne, te behet vetem ne emrin e Zotit duke mos e ngaterruar me veprimet dhe qellimet e tjera, duke ngritur cdo sistem pune mbi kete. Parim themelor-konviktet, shkollat dhe qendrat e edukimit dhe shume institucione qe do te ndertohen ne te ardhmen sipas nevojës duhet te kene vetem qellimin per te ralizuar kete detyre te shenjte sikurse duhet. Cdo institucion arsimor dhe qender sherbimi duhet te edukoje me normat me te larta brezin e ri dhe te mbushin mangesite dhe boshlleqet shpirtore me qellim qe te mos i japin mundesi kaosit dhe cthurjes shoqerore te leshojne rrenje ne mesin tone. Cdo perpjekje per tu sherbyer njerzve duhet te jete si nje prite per te zbutur sulmin e te keqes. Kjo eshte rruga e vetme per ta ndaluar dhe shkaterruar te keqen ne emer te mendimit, opinionit dhe veprimeve konkrete. Dua te theksoj faktin se nese ne se mbushim kete boshllek dhe si dalim te keqes dhe shthurjes para per ti thene qe ketu s’mund te kalohet, c’vlere i mbetet perpjekjeve dhe luftes qe kane bere te paret tane per te mos lejuar pushtimin e vendit nga Ruset, Greket, Anglezet, Francezet apo te ndonje kryqezatori tjeter. Ata vendosen gjokset e tyre perballe topave, predhave e bajonetave te kundarshtarit per kete qellim, duke dhene shume deshmorie. Nese ne sot hapim portat plotesisht perballe kultures, mendimeve dhe moralit te tyre, a mbetet gje nga perpjekja e te pareve ne ato pozicione ku rane deshmor dhe kjo sjellje e jona a eshte te shkelesh mbi gjakun e tyre? Jo s,mund te shkelet mbi gjakun e 300 mije njerzve burra e gra qe luftuan heroikisht ne canakale, pasi perpjekja e gjithë ketyre heronjve do te na kape pas qafe dhe s’do mund te shpetojme lehte nga kjo pergjegjesi. Dhe ne duhet te tregojme te njetin shpirt sakrifice per te mos lejuar neperkembjen e atdheut per te cilin ato dhane jeten pa hezitim per te mos shkelur kemba e te huajit. Megjithse perpjekja jone dhe lufta e tyre jane mjaft te ndryshme, sot ne duhet te pergjigjemi me te njeten metode dhe teknike qe perdorin dhe armiqte tane ndaj nesh. Nese te paret tane me perpare u pergjigjen me arme, ne sot duhet te perdorim teknika te tjera per te mos shkelur mbi gjakun e derdhur mbi kete vend.

Atehere sot ne varesi te kushteve dhe te veprimit duke ngritur faltoret ku do te lulezoje mendimi islam dhe te praktikohet adhurimi duhet te behen perpjekje per te ndertuar edhe institucionet qe do te realizojne te njejtat funksione qe do te kryejne ato faltore ne zanafillen e tyre. Shpirti dhe botekuptimi islam do te forcoje boten e brendshme shpirtore te rinise pasi brezi pa besim s’mund te realizoje asnje pune te

pranueshme. Edukimi i personaliteteve me te medha te veprimit ne emer te fese eshte lidhur me kete perpjekje. Nese punohet sistematikisht personalitete fetare si iman Rabani, imam Gazali, Shah Nakshibendi, Fatihu, Javuzi por edhe personalitete te mendimit dhe shkences si Farabi, ibni Sina, Muhjidin ibni Arabi dhe Mevlana do te mund te rriten dhe ne brezin dhe epoken tone. Asgje s'na pengon te kultivojme ato trendafila ne kopshtin tone, **mjafton qe kopshtari dhe kujdestari te bejne mire punen e tyre.**

Sikurse e permenden edhe me lart te urdheruarit e te mirave dhe ndalimi i te gabuares ka nje aspekt qe duhet te behet ne emer te drejtesise kolektive mes njerzve dhe ne te njeten kohe eshte nje detyrim i te jetuarit ne komunitet. Eshte nje pergjegjesi shoqerore per kete klase qe te siguroje qe mendimet dhe morali islam te degjohet, te ndahet dhe te jetohet. Si ligjet themelore ne shitblerjet mes myslimaneve ashtu edhe ruajtja dhe mbrritja e te drejtave ne mes te individeve duhet te vleresohen ne kete prizem. Le te ndalemi edhe pak ne kete aspekt.

Islami ka ne vetvete nje moral te tregetise dhe ekonomise, dhe cdo mysliman eshte i detyruar te zhvilloje aktivitetin e tij brenda ketij morali. Ai s'mund te beje hile, s'mund te mashtroje dhe s'mund te spekuloje. Ai eshte i deturuar te rrije larg sjelljeve jashte ketij morali per te favorizuar shtresat e larta dhe per te shtypur shtresat e mesme duke ruajtur nje ekuilibër dhe mase ne shitblerje. Myslimani s'mund te merret me asgje qe s'vlersohet si mall i vleresueshem nga feja islame, duke u përpjekur per te ndertuar aktivitetin e tij tregtar ne nje gjendje te pranueshme dhe kostante. Ky eshte nje aspekt tjetër i te urdheruarit te gjerave te mira dhe te ndaluarit te gjerave te gabuara. Ne kete prizem myslimani i jep nje goditje te forte tregut te zi, mashtrimit e spekulimit duke mos lejuar qe gjerat e ndaluara nga feja te gjejne terren te pershtatshem brenda kesaj bashkesie.

Si cdo sistem edhe islami ka sjelle principet e veta ne cdo fushe jetesore, si ne tregti, familje dhe ne marrdheniet sociale. P.sh per familjen islami ka vendosur kusht martesën nepermjet se ciles duhet te shtohet shoqeria. Aty ku jetohet islami, s'ka vend per prostitucionin dhe marrdheniet jashte martese pasi keto dy faktore jane dy faktore qe e shkaterrojne shoqerine dhe familjen duke e bere ate kundershtarin me te eger ndaj cdo veprimi ne dem te jetes shoqerore. Dhe ne familje islami eshte nje rregullator i qendrimit dhe sjelljes ne mes te prinderve dhe femijeve. Feja islame eshte mjaft e ndjeshme ne ruajtjen dhe mbrojtjen e familjes, ndaj dhe cdo mendim dhe botekuptim qe do te shkaterroje kete cerdhe do ta gjejte

islamin perballe. Ky unitet eshte i domosdoshem per mos denigrimin e shoqerise. Sikurse shihet besimtari mundohet qe te vere ne jete vete dhe te ndihmoje edhe te tjeret te vene ne jete gjerat e urdheruara nga islami; dhe nga ana tjeter perpiqet te largoje nga jeta e tij dhe ajo e bashkesise gjerat e papelqyeshme dhe te pranueshme te islamit duke qene edhe nje nga rruget e te urdherimit te gjerave te mira dhe ndalimit te atyre te gabuara. Si rezultat permes gjithë këtyre rrugëve të ndryshme nese besimtari ben si duhet punen qe i takon dhe te paise me virtyte te larta veten dhe shoqerine ku jeton dhe vetem ateherë mund te flitet per nje popull me virtyte te larta. Nje bote plot me njerez me moral te paster, nje shoqeri e mbushur me keta njerez dhe nje bote ku sundon kjo shoqeri eshte bota qe besimtari thur si ne dantelle, eshte ajo bote qe ne deshirojme. Dhe kjo bote eshte e lidhur ngushte me “se si mund te punoje si duhet urdherimi ne te mire dhe ndalimi i te gabuares”.

Ne nje bote te tille qe enderrojme dhe presim me padurim, individet mundohen te jene te vlefshem per njeri tjetrin, popujt perpiqen qe edhe kete bote edhe te ptejmen ta kthejne ne nje parajse te vertete. Ne shoqerine ku konkurojne vlerat e larta eshte sundues botekuptimi “Ne” dhe jo “Une”.

Mendimi “Nese une vdes nga etja mos rente asnje pike shi” nje mendim mjaft i ulet dhe egoist duhet te groposet nje here e pergjithmone dhe ne vendin e tij te lulezoje e fuqizohet mendimi “nese dikush do te vdese nga etja, le te jem une i pari”. Botekuptimi “Le te jete cdo njeri i lumtur se do me vije edhe mua rradha por ne cdo kusht pas te gjithëve, “do te lidhe ngushte njerzit dhe shoqerine duke jetuar ne cdo ore,do te ndihet ndjenja e miqesise duke u harruar armiqesia dhe urrejtja.

Ne fakt keto qe u thane jane evidente ne sistemin e mendimit ne boten tone te brendshme shpirtore. Kur njerzit ta kuptojne kete sistem duke e perjetuar dhe jetuar, ajo bote me e mire do te shfaqet menjehere. Duhet qe kete fakt e gjithë bota ta mesoje, ta njohe dhe ta shohe ne realitet dhe kjo do te arrihet permes urdherimit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te keqja.

Sot per sot nje detyre e tille ne planin individual, familjar e shoqeror pret ato duar te bekuara qe do ti zgjaten dhe do ti marrin persiper.

6. Raporti Thirrja dhe individ-shoqeri.

I derguari i Allahut(s.a.s) ne nje hadith sherif thote:

“Mysliman eshte ai njeri nga i cili myslimanet e tjere jane te shpetuar nga dora dhe gjuha e tij,dhe jane te garantuar.”

Nga ky hadith kuptohet se myslimani nuk i ve syrin prones,pasurise,nderit,personalitetit te te tjereve dhe nuk kryen asnje veprim qe mund te kercenoje sigurine dhe jeten e te tjereve.

Eshte nje e drejte dhe detyrim qe disa pjese te femres te cilesuara te turpshme nga feja te preken vetem nga i shoqi. Atehere si mund te jete i pranueshem raporti i nje tjetri me ate grua. Dalja e femres zbuluar,zhveshur eshte nje faktor qe i perket vetem asaj ,por edhe nese ajo del ashtu seshte shkak i pranueshem qe nje i huaje ti ngule syte apo ta ngacmoje. Duke qene nje aspekt aq delikat per nje myslyman e si mund te mendohet kryerja e mekateve te cilesuara te tilla nga feja me te renda se edhe te paret? Sjellja individuale ka ndodhur ne cdo bashkesi dhe kohe pasi kjo ceshtje lidhet me qellimin dhe synimin e secilit.

Une kam njohur djem te tille qe kur shihnin dicka te keqe ne pazar ,rruge duke menduar se po benin mekat vraponin me te shpejte ne porten e pendimit dhe cdo myslyman duhet te jete i tille. Myslyman eshte ai qe u jep siguri te tjereve dhe qe nuk zgjat as doren te ajo qe u perket te tjereve. Sikur prane tij te gjenden edhe nje mal me ar qe i perket nje tjetri ai as qe mendon te perfitoje as edhe nje gram. Ai eshte njeri qe jep siguri dhe besim dhe bashkesia islame eshte nje bashkesi qe formohet nga njerez te tille. Nje bashkesi e tille askujt si krijon probleme e shqetesime. Ne anen tjetere nga hadithi Sherif kuptohet qe i pabesi(kafir) eshte ai njeri qe nuk jep siguri dhe sot eshte mese e drejte per te patur frike nga keto lloj njerzish. Tek keta njerez nuk ekziston as besimi me i vogel dhe faktet historike a nuk jane te mjaftueshme? Duke qene i paisur me virtytet me te larta morali i Myslymaneve dhe gjendja e tyre shpirtore eshte shume e ndryshme nga te tjeret dhe duhet te jete e tille. Bashkesia ne te cilen Myslymani jeton eshte larg cdo lloj shfaqjeje te nje morali te ulet duke marre qendrim ndaj atyre te keqijave qe konsiderohen te tille nga feja.

Bashkesia shoqerore qe formohet nga njerez te tille eshte shume ndryshe nga bashkesite ku qellimet e ulta kane zene vend kryesor duke reflektuar ne mjedisin perrreth drite dhe patesterti. Eshte detyre primare per cdo myslyman per te formuar nje strukture te tille solide dhe per ta mbartur ate gjithandej. Do te thote qe ko detyre ne rradhe te pare duhet te konsolidohet ne planin individual duke kaluar ne ate shoqeror dhe ate shteteror. Padyshim qe shoqerite e larta formohen nga nje emisar te tille te

drites se vertete. Nje formacion i tille mahnit jo vetem individet por mrekullon grupet shoqerore dhe popujt. Nje shembull spikant e bindes ne kete aspekt eshte ngjarja e pranimet te islamit dhe kthimit mysliman ne Nexhashit.

Nexhashi ishte sundimtar i Abisinise. Gjate sundimit te tij kishte marre nen mbrojtje nje grusht myslimanesh qe ishin larguar nga perssekutimi i idhujtareve te Mekes dhe duke ndjekur nga afer fjalet dhe sjelljet, veprimet dhe qendrimet e tyre kishte kuptuar rrugen e shpetimit qe reflektehej nga besimi i tyre duke iu dorezuar menjehere te derguarit te Allahut(s.a.s). duke qene nje meshirim i gjalle i te urdheruarit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te keqija ajo bashkesi individesh ato qe do tja thoshin Nexhashit i kishin transmetuar permes sjelljeve dhe veprimeve te tyre. Ato qe e kishin magjepsur Nexhashin nuk ishin vetem fjalet magjike qe dilnin nga buzet e tyre por edhe cilesite e larta qe shfaqeshin ne rrafshin moral te meshiruar ne personalitetin e tyre. Letra qe Nexhashi i shkruan te Derguarit te Allahut(s.a.s) nga fillimi ne fund eshte e mbushur me fjale te medhaja. Qe ne fillim te shkrurart "Te Derguarit te Allahut nga Nexhashi..." tregon edhe modestine e letres duke qene se ne ate kohe shkruhej para emri i atij qe pranohej si i larte nga gjendja e brendshme shpirtore te shkaktuar ne ate moment por edhe nga madheshtia e fjaleve te perdorura te shkaktuar ne ate moment por edhe nga madheshtia e fjaleve te perdorura ja vlen te lexohet e te rilexohet disa here. Dhe sae goditur e spikante eshte thenia e tij: "O i Derguar i Allahut nese te kerkon do vi menjehere dhe nese deshiron qendroj ketu qe te shpetoj popullin tim..."

Nje dite tjeter me perulesi te plote dhe plot devotshmeri do thoshte: "Sikur ne vend te ketij pushteti qe kam te isha nje sherbyes prane te Derguarit te Allahut(s.a.s)."

Ajo qe kishte sjelle Nexhashin ne kete gjendje ishte jetesa islame e nje grupi sahabesh dhe fjalet plot jete qe dilnin nga buzet e tyre. Transmetuesit e hadithit e percjellin keshtu kete ngjarje: "Meka kishte filluar te behej e veshtire per myslimanet. Asnje skishte te sigurte as jeten pasurine, dinjitetin dhe nderin. Ne kete kohe lejohet migrimi ne Abisini. Myslimanet u perballen me nje perkujdesje dhe interesim me te madh nga se prisnin duke u pritur si mysafir te vecante. Mosbesimtatet e Mekes duke dashur tjuja veshtiresojne jeten kudo qe shkonin u moren vesh mes tyre dhe derguan nje perfaqesi ne Abisini. Ne krye te tyre ishte Amr b.As(r.a) nje nga sahabet me te medhenje te mevonshem. Qellimi i tyre ishte te nxisnin Nexhashin

kundra myslimaneve qe te hiqte dore nga mbrojtja e tyre. Kjo do te ishte edhe nje goditje tjeter ndaj shpresave te Myslimaneve.

Sundimtari i degjoi gjere e gjate ndersa mosbesimtarete e Mekes nuk lane shpifje qe mund tu vinte ne mendje pa thene duke u munduar ta bindnin Nexhashin. Nexhashi ishte nje simbol i larte i drejtesise dhe smund ti hidhte tutje pa ndonje shkak per te qene njerzit qe kishin kerkuar mbrojtje. Keto mendime ua percolli edhe parise se kurejsheve duke u shprehur hapur se sdo te jepte vendim pa i degjuar edhe ata vete. Nje grup me ne krye Xhafer b.Ebi Talib(r.a) u ftua ne pallatin mbreteror. Xhaferi ishte nje nga fisniket e Mekes,djali i xhaxhait te Derguarit te Allahut(r.a) dhe vellai i madh i Hz Aliut(r.a). Myslimanet kishin caktuar ate te mbante fjalen. Ne mes te tyre kishte unitet dhe mirekuptim ,sikur sishin nje trup i vetem dhe ky unitet ishte dicka qe smund ti shpetonte kujt pa u vene re. Ata qe futeshin ne pallatin mbreteror duhej te perkuleshin sipas protokollit te asaj dite ,por myslimanet su perulen pasi ishte e pamundur ti perkuleshin kujt tjeter vec Zotit. Kjo sjellje e tyre i kenaqi se tepermi mosbesimtarete e Mekes sepse menduan se Nexhashi do te zemerohet dhe do ti debonte. Por Nexhashi perfaqesonte virtytet me te larta te drejtimit. Ata qe sot mendojne semund te perfaqesojne demokracine sikur te mund te perfaqesonin demokracine qe ekzistonte ne Abisinine e katermbedhjet shkuje meperpare atehere do te mund te perfaqesonin dicka te vertete ne ate qe thone.

Nexhashi u beri disa pyetje myslimanve dhe Xhaferri iu pergjigj:

“ Ne ishim nje popull injorant. Pinim alkol,luanim bixhoz,kryenim mardhenie jashte martese dhe vrisnim njerez. Benim gjithte te keqijat dhe sbenim asnje pune per se mbari.(A seshte e tille edhe injoranca e shek.XX?) Allahu(xh,xh)dergoi nje profet ne mesin tone. Ai na tregoi rrugen e drejte neve. Na nxorri dhe na shpetoi nga cdo e keqe duke na paisur me virtytete me te larta...”

xhaferi filloi te fliste edhe per shume gjera te tjera ndersa Nexhashi e degjonte si i humbur ne boten hyjnore. Pyeti ne lidhje me ceshtjen eHz.Isa(a.s) dhe te Hz.Merjemes. Xhaferri(r.a) ne nje mallengjim te plote lexoi suren Merjem. Ato qe thuheshin ne Ajat e kishin prekur ku duhej Nexhashin. Smund ti mbante lotet dhe filloi te qante me denese. Pastaj u perkul mbi nje fije te holle nga dysHEMEJA sikur donte te thoshte ndal me degjo mua,shtoi: “Pasha Zotin mes atyre qe i kane zbritur Profetit tuaj dhe atyre qe i kane zbritur Hz.Isase ndryshimi eshte aq sa kjo fije e holle...!”

Vertete qe skishin ndryshim pasi ato qe u zbrisnin profeteve buronin nga i njeiti vend. Nexhashi ua ktheu mbrapsht dhuratat e mosbesimtareve te Mekes duke shpallur se do ti mbronte myslimanet. Kjo sepse edhe pse kishte biseduar shume pak me ta kishte verejtur rezatimin e vlerave te larta morale dhe kjo mjaftonte qe ai te zgjidhte si besim ate islam. Po te kthehemi edhe nje here ne fillim ,nese kjo detyre e larte dhe e shenjte nuk merret si duhet qe ne planin e individit te presesh qe te shfaqet nje popull me vlera te larta morale pervecse nje iluzion nuk kishte ndonje kuptim tjeter. Kjo per arsye se mes individit dhe shoqerise ka nje raport mjaft te ngushte ,kjo pasi shoqeria eshte nje bashkesi individesh mjaft te vecante. Nje shoqeri do te karakterizohet nga vlera te larta atehere edhe kur individet e saj perfaqesojne vlera te larta morale. Si individet ashtu edhe shoqeria jane te detyruar qe te ruajne vlerat morale qe ata kane. Sikurse e prekem percipitas me larte njeriu duke mos i patur qe ne fillim keto vlera ,ai smund ti kete pergjithmone. Behet fjale per dicka qe fitohet ndaj duhet te ruajme nje vazhdueshmeri te kushteve qe na sigurojne keto vlera. Ne kete aspekt pervec profeteve askush smund te kete garanci te plote. Kjo garanci u eshte dhene atyre si nje shperblim per perpjekjet dhe luften qe do te japin me vullnetet e tyre per perfitimin e ketyre vlerave. Zoti medijen e tyre te pafundme duke ditur edhe piken se deri ku mund te arrije ju ka dhene nje shperblim. Pervec Profeteve cdo njeri tjeter sado i madh te jete jane te detyruar qe gjithmone te ruajne poziten qe kane fituar dhe arritur. Ne te kundert do behet fjale perrenie dhe humbje. Ajo qe duam te arrijme eshte qe vlerat qe arriten permes urdherimit te gjerave te mira dhe ndalimit te gjerave te gabuara mund te ruhen dhe te zhvillohen me tej permes kesaj rruge,nese sarrihet kjo do te filohet renia dhe prapambetja e cila do rezultoje ne shkaterrimin total te kesaj shoqerie me probleme. Per te mos aritur ne nje gjendje te tille duhet ruajtur nje levizje dinamike qe eshte e mundur vetem permes urdherimit ne te mire dhendalimit tese keqes. Kjo detyre e larte eshte edhe jeta edhe kushti qe e ruane dinamiken e kesaj jete. Ndoshta per kete arsye me i larti nder Profetet(s.a.s)ndersa pranonte biatin e te tjereve u vinte kushtin qe te “urdheronin ne te mire”. Psh dhe biati i Xharir b.Abdullah el-Bexheli(r.a) u pranu me kete kusht. Ky sahab i larte e tregon keshtu kete ngjarje:

“Une bera berimin ndaj te Derguarit te Allahut. Kur mori fjalen pas meje ma pranoi betimin(biatin)ne keto kushte. Te fal namazin,te jap zekatin dhe

cdo njeri qe me del perpara ta keshilloj.“ Kjo ne menyre te qarte do te thote te urdherosh ne te mire dhe te ndalosh gjerat e keqija.

Vecanarisht zbatimi i kesaj detyre e ben njeriun pjestar dhe ne te mirat e urdherimeve te tjera,sepse njeriu qe urdheron ne te mire dhe ndalon te gabuaren eshte nje besnik i dedikuar i kesaj detyre,duke qene i paisurme te gjitha vlerat me te larta dhe i motivuar per cdo lloj veprimi. Pastaj ai realizon edhe punen qe eshte edhe qellimi i jetes se profeteve ,puna e tyre madje me te renden dhe me te veshtiren ne te gjitha punet. Patjeter qe edhe lartesia e tij do te jete ne te njejtin nivel.

Shihni se si Kurani thekson veshtiresite e kesaj detyre te shenjte ne keshillat qe Hz.Lokman i le te birit:

“O biri im!Faleni namazin si duhet,urdheroni gjerat e mira dhe ndaloni te keqijat dheduroni kur ju ndodh ndonje fatkeqesi. Padyshim qe keto jane nder punet me te veshtira.”(Lokman,31/17)

Sikurse shihet Hz Lokman te birit ne fillim i keshillon te falin namazin dhe pastaj u thote te urdherojne gjerat e mira dhe te ndalojne te keqiajt. Duket sikur do ti thote te birit:”Biri im asgje smund te presesh nga ai qe sfal namazin. Pasi namazi(falja)eshte kushti i pranimi te cdo adhurimi. Prandaj ne fillim ploteso kete detyrim ndaj Zotit tends dhe pastaj me energjine qe ke brenda urdhero te miren duke e perhapur dhe pengo te keqen duke e ndaluar. Duke u munduar ti realizosh keto do te bien ne toke kokecarje e probleme te ndryshme por qe ne fillim duhet te tregosh durim. Per njerezit e perkushtuar ndaj kesaj ceshtjeje problemet dhe fatkeqesite sduhet te jene surprize ,por ata duhet te parapergatiten per keto gjera. Gjer me sot seshte pare ndonje rast ndryshe pasi kesaj pune mund tja dalin mbane vetem njerez te medhenj dhe shperblimi i saj mund te pritet vetem nga Allahu i Madherueshem. Keto pune do ti ngrene perkrahesit e tyre ne majat me te larta por njekohesisht do tu duhet te perballen me veshtiresi e fatkeqesi,ne raste te tilla ata duhet te tregojne durim qe ju ka hije vetem te medhenjve.

Rendesine dhe njekohesisht pergjegjesine e madhe kesaj detyre Profeti(s.a.s)mundohet ta thote permes ketij hadithi: “Me i miri nder popullin tim ,eshte ai qe ne mes te injoranteve bie pre e problemeve dhe konflikteve.”

Ne nje hadith ky mendim forcohet keshtu: “Besimtari qe ndodhet mes njerzve duke u perballur me ngacmimet e tyre fiton me vlere sesa ai qe qendron larg per tu shpetuar ketyre ngacmimeve.”

Vertete qe ai qe perpiqet per te urdheruar ne te mire dhe ndaluar te gabuaren nemesin e nje shoqerie qe e lufton ,ben nje sherbim me te larte

sesa ai qe terhiqet ne qoshen e tij duke iu perkushtuar vetem adhurimit si individ. Po te mos ishte kjo detyre eshenjte me e rendesishme se adhurimi personal,i Derguari i Allahut sdo te dilte fare nga shtepia duke iu perkushtuar vetem adhurimit dhe lutjes ndaj Zotit. Po te mos ishte kjo me me vlere se cdo veprim tjeter vete Profeti yne (s.a.s) Allahu(xh,xh) sdo ti drejtohej:”Ej ti njeri i mbuluar!Cohu dhe urdheroi njerzit ne te drejte!”(Mudesi: 74/1.2) Feja ne vetvete eshte nje keshille ,urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi i gjerave te keqija. I Derguari i Allahut(s,a,s) u kishte dhene kete urdher njerzve te tij(sahabeve):”Feja eshte keshille.” Ata e kishin pyetur ;’Per ke(eshte keshille)?”

Profeti pastaj ju eshte pergjigjur: “Per Allahun,per librin e shenjte,per Profetin,per drejtuesit e myslimaneve (imanet) dhe per gjithë myslimanet.”

Atehere besimtari pa pushim do te flasi per Zotin dhe kjo do te jete edhe detyra e tij primare. Do ti perkushtohet aq shume kesaj pune saqe ate dite qe sdo te flase per Zotin do ti ike oreksi,gjumi dhe do te marre sikur se ka jetuar ate dite. Nje preokupim tjeter do te jete te flase rreth te Derguarit te Allahut(s,a,s)se cfare ka bere ai per hire te kesaj ceshtje madhore,ci eshte dashur te duroje dhe ne fund te perpiqet qe njerzit besimtar te marin shembull. Te flase rreth librit te shenjte qe eshte derguar si nje ftese dhe nje ligj,si nje udherrefyes dhe keshillues. Te flase per ate liber ne te cilin nderi dhe prestigji yne eshte ne nje raport te drejte. Faktet historike tregojne se bota islame per sa kohe ka qene e lidhur ngushte me ate liber ,pa kuptuar permbytjen e tij duke e pasqyruar edhe ne menyre jetese ,gjithmone ka qene ne majat me te larta edhe atehere kur eshte larguar nga Ai ka vajtur keq e mos me keq.

Ketu smund te rri pa shfaqur nje shqetesim,nje shqetesim qe sa here e mendoj me dhemb ne zemer kur e prek kete ceshtje. Myslimanet e sotem kane ardhur ne nje gjendje te tille dhe se kuptojne gjuhen e ketij libri,shume larg njeri-tjetrit. Lidhja me Kurani ka mbetur vetem ne formen e jashtme. Do shihni se menyra e jeteses se njeriut qe i terheq vemendjen dikujt qe e mban Kurani me poshte se mesi,duke e keshilluar qe ta mbaje gjithmone siper mesit gje qe eshte vetem shfaqje respekti eshte diametralisht e kundert me Kuranin.

Njeriu qe nuk i del ne mbrojtje Kuranit,qe nuk din se qellimi i jetes eshte perfaqesimi i tij ,cfaredo grade qe te kete ne afiret ,do te denohet me kete qendrim qe ai mban ndaj Kuranit. Nese ne ditet e sotme ai ka marre nje Kuran duke e varur ate ne mur,kush e di ne ahiret e tij do te paguaje denimet

e mekatit te tij duke u varur nga koka apo nga kembet. Ah sikur te hapej perdja ndarese qofte edhe nje moment dhe te gjithë qe nga drejtuesit fetare,shkrimtaret,mendimtaret,lexuesit,degjuesit,mesuesit ne shkolla e te gjithë te tjeret te shihnin denimin dhe fatin qe i pret si rrjedhoje i shkeputjes dhe largimit nga Kurani. Por dicka e tille eshte e pamundur si rezultat i se fshehtes se testimi ne kete bote.

Ska nevojë te hapet perdja pasi mendoj vetem nje mendim i shkurter mjafton per te pare se ku mund te perfundojme. Sot a nuk shihet qarte se cfare mund te pesojne ata qe jetojne larg Kuranit? Cfatkeqesi duhet te na bjete mbi koke qe te na nxise te perqafojme si duhet Kuranin,te vrapojme drejt tij? E gjithë bota islame duhet ti thote ndal ketij drejtimi qe po ndjekim dhe te kuptoje se shpetuesi i vetem i saj eshte libri i shenjte. Edhe Profeti yne(s.a.s) i nderuar,ka ardhur per te treguar kete dhe mbare njerzimi do te mund te lartesohej ne masen qe do ta kuptojme ate.

Si rezultat njeriu qe ne planin individual,duke realizuar kete detyre ,behete shkak i zgjimit te te tjereve te besim do te fitoje sevape sa te gjithë ata bashke. Kjo ka kete kuptim:”Le te themi qe ju qete shkak dhe ndermjetes qe nje njeri filloi te fale namazin,te agjeroje dhe te jape zekatin ose ta bindni ate ne ceshtjet e besimit. Nga te gjithë sevapet qe fiton dhe do te fitoje ky njeri po aq do tu shkruhet edhe juve. Ne kete rruge nje veprim i vogel i kryer te ben te fitosh shume sevape dhe kjo gjithashtu tregon sesa e rendesishme eshte te urdheruarit e gjerave te keqija dhe ndalimit te te gabuarave. I Derguari i Allahut(s,a,s) permes nje hadithi tjeter:”Kush hap nje rruge fiton edhe sevape nga kjo rruge e hapur”,mundohet te transmetojë kete te vertete dhe nga nje gjuhe tjeter. Ata qe do te ecin ne ate rruge qofshin te aferm apo farefis,qofshin te njohur apo te panjohur ska ndonje ndryshim.

Te hapurit e nje rruge per te gjallëruar nje pike te vdekur ne jeten shoqerore nga libri kendveshtrimi i fese duke ja dhene bashkesise edhe nese vdesim do te beje qe e jetes te jete i hapur ne ate pike. Kjo eshte e vlefshme edhe per te keqijat.

Sduhet te harrojmë qe nje dite do te na vene ne nje tabut pa shpirt dhe do na zbresin ne nje grope te erret,do na mbulojne me dhe,dhe do na vene nje gure te koka. Miku,vellai,shoku,te dashurit e zemres,nena,babai dhe te gjithë ata qe na kane dashur ne kete jete do na lene aty dhe do te ikin. Ndersa sevapet nga kjo rruge qe keni hapur,do te rrjedhin mbi ne dhe do te ndricojne boten tone te pertejme. Edhe nese fizikisht kemi vdekur ne kete bote,ajo hibrite qe kemi hedhur ne kete jete do te vazhdoje deri ne ditën e

fundit te kjametit. Po ta mendojme ndonese Hz Muhamed(s.a.s)ka katermbedhjetë shekuj që ka shtegtuar në botën e përtejme a ka njeri tjetër në sipërfaqen e tokës me të gjallë e të përjetshëm që çdo ditë hapen fletët e librit të të mirave dhe nuk mbyllen kurrë? Pas kësaj vijne të gjithë ata që kanë vendosur mure prej ari në strukturën e brendshme të jetës shoqërore duke arritur në miliona deri tani dhe të gjithë kanë fituar sevapë në masën që kanë kontribuar. Meshira e Allahut të Madhërueshëm është aq e madhe saqë mjafton që njeriu të hyjë në rrugën që të çon drejt meshirës.

Zoteria ynë në një hadith thotë:

“Libri i jetës së çdonjerit mbyllet dhe vulloset me vdekjen. Por vetëm libri i jetës së atij që ka bërë të mira shoqërore qëndron i hapur deri në ditën e fundit të kjametit.”

Ai që ka bërë të mira shoqërore “murabeti” është njeriu që ja ka dedikuar veten rregull së drejte dhe duke mos menduar gjë tjetër përveç misionit të tij. Ai ja ka bërë qëllimin e jetës mbylljen e të gjitha të carave të rrezikshme në vendin e tij duke u munduar tju ofrojë të tjerëve të gjithë pasurinë që ai ka duke e pranuar si detyrën me të lartë.

Libri i jetës së njeriut të tillë nuk mbyllet asnjëherë. Në historinë e thirrjes në fenë islame ka prej atyre që kanë hedhur mijëra farëra por që janë larguar pa parë as edhe një buzeqeshje të vogël. Ka prej atyre që kanë hedhur farën dhe pesëdhjetë vjetë më pas kanë çelur duke sjellur pranverën përreth. Sevapet e gjithë këtyre njerzve i kanë shndërruar varret e tyre në qendra drite. Zoti i madhërueshëm e ka shpërblyer mundimin e tyre duke ruajtur ata nga e keqja e varrit duke dërguar aty rreze drite. Ata njerez janë edhe me të gjallë se vetë të gjallët që kanë arritur një rezultat të tillë.

7. Thirrja në lidhjen mes besimit dhe Nifakut(?)

besimtari është ai që përhap vlerat e larta morale brenda bashkësisë ku jeton duke filluar nga rrethi më i ngushtë familjar në emër të së vertetës. Ky është një kusht i domosdoshëm i të qenit besimtar, ndaj dhe të tjerët janë të siguaruar nga dora dhe gjuha e tij. Në anën tjetër të gjithë myslimanët janë si organizëm i vetëm, sipas kuptimit të hadithit. Neqoftese në një nga organet që përbejnë atë organizëm peshohet ndonjë dëmtim, dhimbja dhe shqetësimi ndihet në të gjithë organizmin. Nga ana tjetër nëse çdo organ është i persosur dhe pa të meta dhe organizimi në tërësi do të jetë pa të meta dhe i persosur. Është mëse normale që besimtarët të jetojnë me gezimet dhe shqetësimet e njeri tjetrit, pasi ata janë si pjesët e një organizmi.

Po qe se ky gezim apo shqetesim lidhet ngushte me boten e pertejme si mundet qe nje mysliman te qendroje i painteresuar me fatin e vellait te tij per te shkuar ne ferr apo parajse. Realizimi i detyres se larte ndermjet besimtareve per te urdheruar gjerat e mira dhe per te ndaluar ato te gabuara eshte kusht i pandare i te qenit besimtar. Duke e theksuar kete fakt ne Kuranin Kerim thuhet:

„Burrat dhe grate besimtare jane kujdesur per njeri tjetrin,urdherojne te miren dhe ndalojne te gabuaren. Falin namazin,japin Zekatin dhe i binden Allahut dhe Profetit. Ata pra do te meshirohen nga Allahu. Pasi Ai eshte padyshim i plotfuqishem dhe i gjithëpushtetshem.“

Qofte burre apo grua cdo besimtar eshte mik per njeri-tjetrin. Si rezultat i kesaj miqesie ata urdherojne te mirat e pelqyera nga Allahu dhe e largojne njeri-tjetrin nga te keqijat e papelqyeshme. Pastaj miqte ne mes te tyre smund te sillen ndryshe.

Vetem se ndersa ben kete besimtar sduhet te lere pas dhe veten e tij. Ai duhet te kuptoje si duhet islamin duke shnderruar botkuptimin islam nemyren e tij te jeteses,te fale drejt namazin dhe te jape teplate Zekatin si dhe ne cdo ceshtje te bindet Allahu(xh,xh) dhe te Derguarit te tij(s.a.s). Nese ne nje bashkesi dhe individet rrethohen nga krahet e pushtetshem te meshires duke krijuar nje atmosfere hyjnore perreth.

Perballe kesaj tabloje magjike,Kurani i portretizon ne kete menyre mosbesimtaaret qe jane te kundertit e besimtareve te devotshem.

“Burrat dhe grate mosbesimtare jane nga njeri tjetri.” Urdherojne te keqen dhe behen pengese per te mirat duke e treguar dhe koprace. Ata e kane harruar Allahun(per kete arsye). Dhe Allahu i ka harruar ata. Ne te vertete mosbesimtaaret jane vete (percaresit).“(Texba 9/67)

Sikurse shihet ajeti per mosbesimtaaret nuk thote se jane miq por lajmeron se jane nga nje i njejti lloj ,pasi ata as qe behet fjale te jene miq kundrejt njeri-tjetrit. E vetmja gje qe i lidh ata eshte interesi. Po qe se u cenohet sado pak interesi ata jane gati te luftojne pameshirshem dhe ne mes te njeri-tjetrit. Keto arsye ti shpreh ne menyre te mrekullueshme dhe te qarte gjendjen e tyre shpirterore duke i cituar nga i njejti lloj.

Ane tjeter e perbashket e tyre eshte se ata urdherojne dhe nxisin ne te keqen. Permes perdes se kinemase dhe ekranit te televizorit ata stimulojne te pamoralshmen duke ndikuar te mendjen e te rinjve dhe prishur moralin e tyre ,perballe kesaj gjendjeje njerzit ulin koken te perulur. Keto mjete propagandimi jane mjaft te fuqioshme per te patur ndikim te njerzit. Ata qe

u ka humbur arsyeja dhe u eshte mjegulluar te papercaktuarit jane kukulla ne duart e mosbesimtareve dhe te lehte per tu skllaveruar. Per te mbajtur ne kembe fuqine shfrytezuese slene intrige dhe loje pa perdorur kundrejt njerzimit. Kudo qofshin ne bote keto grupe sioniste permes kesaj vecorie te tyre eshte lehte per ti dalluar ,pasi ata vazhdimisht urdherojne te keqen dhe pengojne njerzit ne veprime te mira. Kjo eshte dhe tipari i dyte i perbashket i tyre. Per te mbajtur bashkesine nen nje presion psikologjik cdo njeri me vlera te larta morale e perfshin per te prapambetur dhe injorant. Per keta njerez ata qe falin namazi dhe agjerojne jane reaksionare dhe veshja e grave ndryshe duke mbuluar dhe koken per ta eshte shenje e prapambetjes dhe injorances. Edhe nese ju flisni per dashuri kombetare per ta ju jeni me keq se ultranacionalistat.

Cdo gje e bukur perta eshte e keqe. Cdo vlere e larte morale e popullit atyre u shkakton alergji sepse kjo eshte kunder kaosit si nje situate ku perfundojne ata njerez si ne planin e jashtem shoqeror dhe ate te brendshem shpirteror skane asgje te perbashket. Sipas thenjes se Kuranit keta jane me te mjeret ne nivelin me te ulet te ferit:” jo,jo ata sjane kafshe por mete ulet se kafshet”.(Araf,7/179) eshte panorama qe i karakterizon me se miri.

Nga kjo pikpamje besimtaaret duhet te realizojne pergjegjesite qe u takojne duke u ruajtur nga te renit ne kete gjendje. Ruajtja relizohet vetem duke urdheruar vazhdimisht ne te mire dhe duke u perpjekur perte larguar njeri-tjetrin nga e keqja. Duhet te frikesohen per te mos rrene ne nifak si vete ashtu duhet ruajtur dhe miqte duke ruajtur gadishmerine dhe duke hapur syte si ai vete si dhe bashkesia ku jeton perballe kesaj te keqjeje. Kjo eshte tipari i ndashem i te qenit besimtar. Per te patur nje bashkesi te qete dhe pa probleme sdo te jepet as shanci me i vogel te keqes qe te shfaqet ne kete bashkesi. Ne te kundert nje e keqe sado e vogel perhapet ne nje kohe te shkurter duke u shendrruar ne nje epidemi te rrezikshme e vdekjepruresse per bashkesine,popullin e madje per mbare njerzimin. Problemet e medhaja shoqerore fillojne si nje perhapje e te keqijave sado te vogla qe mund te duken.

Po te hidhet nje shikim nga ky prizem i historise do te verehen shume probleme te perseritura shoqerore qe rezultojne ne te njetin perfundim.

I Derguai i Allahut(s.a.s) thote:

“Shembja shoqerore ka hyre ne kete menyre: Kur nje person e shihte tjetrin duke bere dick ate keqe I thoshte ,”O njeri hiq dore nga ky veprim se

seshte I pranueshem” Por kur vinte ditën tjetër dhe e shihte tek bente të njëjtin veprim akoma e ruante miqesinë me të duke ia shtruar me të ngrene e me të pire. Pas kësaj Allahu(xh xh) I bëri të pasojnë njëri tjetrin.” Pastaj I Derguari I Allahut(s.a.s) lexoi ajetin:

“Ata që mohojnë nga Izraelitet janë mallkuar nga goja e Davudit dhe Isait djalit të Merjemes. Kjo ngaqë ata ngrihen koke dhe e tejkaluan masën. Ata nuk e ndalnin njëri tjetrin në të keqijë që bënin. Ky veprim i tyre ishte mjaft i keq.”(Maide.5/78.79) dhe pastaj shtoi: “pasha Zotin duhet që patjetër të urdheroni në të mirë dhe të ndaloni të keqen duke i detyruar shkelesit që të vinin në rrugë të drejtë. Ketu përmendet gjendja e izraeliteve që toleronin të keqen duke paralajmëruar dhe tërhequr vemendjen besimtareve për të mos rënë në të njëjtën gjendje për të mos pasur të njëjtin fund. Të diturit e ngjarjeve të tilla ka shumë anë pozitive.

Kjo ngjarje mund të analizohet në këto mënyra. Personi që i tërheq vemendjen atij që kryen një të keqe ditën e parë gjendet personalisht përballë kësaj të keqeje. Duke qenë se në këto çështje kërkohej vazhdueshmëri dhe durim personi në fjalë në vend se të kembengule humbet shpirtin e veprimit dhe përfundon duke vazhduar miqesinë në atë dhe duke ia shtruar netë ngrene e në të pire. Mospajtimi në zëmër duke qenë dhe shenja e fundit të ekzistencës së besimit tek ky person por ai as edhe këto smundet që ta bëjë. Në këto mënyra duke qenë se e keqja nuk gjen as edhe rezistencën me të vogël gjen terrenin e përshtatshëm për tu përhapur në bashkësi. Ndaj dhe Zoti i plotfuqishëm i barazon zemrat e tyre duke i bërë ata të pasojnë njëri tjetrin madje duke shkaktuar dhe ferkime të brendshme i bënin ata të ndahen grupe-grupe. Allahu(xh xh) i barazoi zemrat e ciftëve që e mohuan duke i futur ata në një kundërshti të vazhdueshme ,dhe për një periudhë të gjatë ata provuan të gjitha vuajtjet dhe ofendimet në botën kristiane. Edhe me parë shekuj me rradhë ata jetuan një jetë skllavi në sundimin e babilonit,dhe në një periudhë tjetër në sundimin e Shaburit ata përjetuan torturat nga më të mostruozet.duke mos patur për asnjë cast qetësi. Shkaku i vetëm i rënies në këto gjendje ishte moszbatimi në mes tyre i urdherimit se gjerave të mira dhe i ndalimit të gjerave të keqja duke lulezuar në zemrat e tyre ndjenjën e ndarjes dhe kundërshtisë duke pasur dhe tronditje që nga themeli. I Derguari i Allahut(s.a.s) duke treguar këto gjendje i tërheq vemendjen popullit të tij mbi domosdoshmërinë e kryerjes që në fillim të kësaj detyre për të mos patur të njëjtin fund duke mesuar tekniken dhe metodën për të mos u shkatërruar si bashkësi.

Duke ardhur ne nje pike te tille mendoj se ja vlen te permendet qofte edhe nje a dy fjali nje fakt mjaft domethenes. Izraelitet edhe ne kohen e Hz Musa(a.s)nuk kane arritur te bashkohen dhe te kene nje unitet. Dhe sot ata nepermjet nje uniteti dhe kembenguljeje duket sikur ja kane arritur qellimit,duke shfrytezuar levizjet historike dhe arritjen e krijimit te nje shteti. Ne momentin kur ata do te largohen nga vlerat historike duke u futur ne nje perplasje te brendshme shoqerore sdo te mund te evitojne shkaterrimin dhe shperberjen e tyre. Cifutet dhe pasardhesit e Izraeliteve ne nje fare mase po marrin shperblimin e te sjellurit me respekt ndaj nje feje me prejardhje qiellore pavarsisht se ne shume drejtime ka mjaft per te korrigjuar dhe permiresuar. Ndoshta edhe gjendja jone e mjeruar i ben ata edhe me te fuqishem.

Vlen te permendet qe bota islame vuan nga semundje te ndryshme shoqerore ,nga pamjaftueshmeria cdo dite ne rritje. Eshte e domosdoshme qe te shkundet dhe te kthehet ne origjinen e saj. Ajo po perjeton nje tronditje te madhe si ne aspektin shoqeror ,mendor e socialo-shoqeror. Nese nuk arritet te merren masat parandaluese para se te jete vone gjendja do te perkeqesohet gjithmone e me shume. Nese arrin te kurohet si duhet ate e pret nje mision qe perfshin gjithe universin. Shpresojme qe ate dite feja islame te perfshij ne harmoni ,nje shpirt dhe nje sistem te ri.

Ne historine islame ka shume fakte qe deshmojne se detyra e thirrjes eshte obligim per cdo besimtar. Do mundohem ta ilustroj kete permes nje shembulli, qe lidhet me Hz Ebu Bekir(r.a). Nje dite Hz Ebu Bekir(r.a) u drejtohet atyre qe po e degjonin permes ketyre fjaleve:

Ajetin “O ju qe besuat ! Shihni veten tuaj ,nese jeni ne rruge te drejte,asnje i humbur juve smund tju demtoje...”(Maide,5/105) e lexoni por e praktikoni gabim pasi une e kam degjuar te Derguarin e Allahut(s.a.s) te thote: “ Nese ne nje bashkesi,kryhen mekate dhe ne mes tyre ka njerez kopetente qe mund te ndalin kryerjen e ketyre mekateve por qe se bejne si duhet detyren e tyre,atehere eshte e pashmangshme renia e denimit te Zotit mbi ta.”

Ne ajetin e mesiperm nuk thuhet mos e ngaterroni me te tjeret por shihnie vetem rehatine tuaj ,perkundrazi kuptimi qe duhet te merret eshte qe kur te tjeret flasin per gjera te gabuara dhe te papranueshme sduhet ta humbase logjiken. Ne kete mes ka nje nxitje per te bere nje analize te brendshme shpirterore. Hz Ebu Bekir(ra) duke qene nje nga ata qe e kupton

me mire kete gje e transmeton thenjen e te Derguarit te Allahut(s.a.s) si nje prove argumentuese per kete botekuptim.

Ka shume fakte ne lidhje me kete teme te transmetuara nga Profeti yne (s.a.s). Do desha ti permendja disa te tille duke qene se hedhin drite mbi kete teme.

Ne nje hadith te transmetuar nga Tirmizi, i Derduari i Allahut(s.a.s) shprehet keshtu:“Ose udheroni ne te mire dhe ndaloni te gabuaren ose Zoti do tju denoje dhe kur te luteni per ti shpetuar ketij denimi lutjet tuaja sdo tju pranohen“.

Ne nje hadith tjeter te dobet serish Termizi perserit njesoj fjelet e mesiperme duke shkaktuar kete:“...Allahu ju leshon mbi koke te ligat. Pastaj me te miret nder ju luten por dhe lutjet e tyre nuk pranohen.“

Te liget jane nje bashkesi njerzish ta pasjellshem qe skuptojne nga profesioni dhe drejtimi,skane njohuri per fene dhe besimin,snjohin librat e shenjte dhe profetet dhe tallen me cdo vlere te larte morale dhe cdo gje te shenjte. Cdo popull a shtet ne krye te cilit Allahu(xh xh) dergon njerez te tille ska arritur te beje hap para. Allahu i madherueshem te ofron mundesi,te jep shanse te reja por sle gje pas dore. Denimi per mekatin e mos urdheruarit ne te drejte dhe ndalimit ne te gabuar mund te vonoje ne kohe por kur vjen koha e denimit perfshin te gjithë njerzit duke i tronditur ata. Nje nga denimet e merituar per myslimanet eshte ai i ardhjes ne pushtet i njerzve te tille te ligj dhe i drejtimit me anen e forces. Ne kete kohe edhe sikur njerzit e mire te mbushin xhamite dhe te fillojne te luten duke lagur me lot sexhadet pa u plotesuar loha e denimit ai popull ska per ta marre veten. Ky eshte nje ligj hyjnor dhe asnjehere ska per te ndryshuar. Nese ne planin real keto thenie do ti mund ti shtrinin ne cdo aspekt te jetes do shihnim nje panorame te pandryshueshme dhe konstante. Gjendja e sotme eshte vetem nje aspekt i kesaj riperteritje. Nder lutjet neper xhami e ne cdo vend,te qaret e te pergjeruarit nuk pranohen kjo gjendje seshte gje tjeter vetem borxhi per kryerjen e nje mekati. Ky mekat duke insistuar ne te madhe eshte nenvlersimi i kesaj detyre te shenjte ose moskryerja e saj ne masen e duhur. Ky mekat na solli ne nje gjendje te shkeputur nga Zoti pasi ne fakt urdherimi ne te mire dhe parandalimi i te gabuares eshte qellimi i ekzistences tone. Ne u krijuam per kete qellim... si ushtare te se drejtes,si persona qe ja kane kushtuar jeten e tyre kesaj rruge madje duke mos patu si objektiv dhe qellimin kryesor dhe parajsen ne perpjekjet dhe mundimet tona. Ne qofte se ka mundesi dhe realizohet duke arritur deri atje sa te jemi te apasionuarit e

kesaj pune edhe ne parajse duke e parapëlqyer kete mbi te mirat e parajses ose te pranojme pa ndonje te hyre dhe ne ferr per tju treguar dicka banoreve te ferrit. Nese lihet pas dore kjo detyre qe eshte dhe shkak i krijimit do te thote se ju i keni lene hapur deren fatkeqesive dhe katastrofave te ndryshme. E vetmja gje qe mund te behet pertej saj eshte lutja dhe Allahu e di dobine e lutjes. Ardhja ne kete gjendje ne nje ane do te thote se po shkohet drejte shkaterrrimit total. Nje dite e tille eshte katastrofike. Ate dite me shira ka mbuluar fytyren dhe tmerri ka vershuar ane e mbane duke u futur ne nje rrjedhe kthim pas.

Po te hedhesh nje sy mbi gjendjen e mjeruar te botes islame do te gjeni te gjithë faktoret qe permenda me siper. Do te tmerroheni duke pare se ku ka qen dhe ku eshte katandisur kjo bashkesi e madhe pjese e se ciles sot jane brezat e shkeputur nga rruga e Kuranit, Profeti dhe Allahut, ata qe i kane drejtuar keta breza ne rruge te gabuar, jane krijesa qe mendojne vetem te ngrenit dhe rehatine personale duke humbur zemren dhe shpirtin, dhe nje histori e pakuptueshme a rezultat i hallkave te shkeputura te saj dhe i kohes se shkuar kot plot me turma pa ndonje drejtim te caktuar. Kjo bashkesi plot madheshti e se kaluares por e pa fat e drejtuar nga funderrinat po perpelitet nen duart e te ligeve dhe mjaft e pashprese. Ku shkuan lutjet e bera rreth qabes? Perse jane te padobishem lotet e derdhur neper xhami? Pasi keto nuk jane shpagimiper mekatin e kryer ndaj dhe ndodheni ne kete gjendje. Aty ku filloi renia duhet te filloje dhe rilindja.

Ne kemi rene ne kete gjendje duke lene pas dore kete detyre dhe shpetimi dhe shpetimi do te vije si rezultat i kryerjes si duhet i kesaj detyre e cila eshte dhe lutja me e mjaftueshme. Ato lutje padyshim qe kane vleren e tyre per jeten e pertejme urdherimit te gjerave te mira.

Sikurse u mundova te permendi edhe ne fillim ne cdo bashkesi apo shoqeri ka njerez me virtyte te larta morale. Keta nga ana shpirtërore mund te jene shume afer Allahut. Nese ne ate bashkesi nuk urdherohet ne te mire dhe te ndalet e gabuara, nese nuk ndertohen institucionet qe do ta kryejne si duhet kete detyre. Allahu do ta sjelle koken mbi koke asaj bashkesie dhe ai popull asnje here sdo te shohe dite te mbare. Ne te vertete Allahu i madherueshem nuk ndeshkon masen per mekatin e kryer nga nje person. Sfajsohet nje bashkesi per shkak te disa personave qe iu kane rrjedhur trute dhe nuk njohin ligjet dhe zakonet shoqërore. Ne qofte se nuk del ndonje grup qe ka forcën per tu perballur me te keqen ,per te urdheruar ne te mire dhe ndaluar te gabuaren e te thote “Zoti yne eshte Allahu” atehere ndeshkimi

bie mbi te gjithë. Ahmed b.Handel ne nje hadith qe e transmeton e thekson ne kete menyre kete ceshtje:“Allahu nuk denon te gjithë per mekatet e kryera nga disa njerez. Por nese ata e shohin te keqen dhe ndonese kane forcen e nevojshme per ta parandaluar te keqen nuk e bejne kete ateherë ata smund ti shpetojne ndeshkimit.” Ne kete ajet theksohet ky fakt dhe kjo gjendje tregohet keshtu:“Ruajuni nga denimi qe nuk ju godet vetem ata qe i bene mizori prej jush dhe ta dini se Allahu eshte ndeshkues i rrepte.”(Enfal,8/25).

8. Thirrja ne besim dhe shkaterrimi permes fakteve historike.

Mund te hedhim nje veshtrim mbi detyren e te urdheruarit ne te mire dhe te ndalimit ne te gabuar. Ne lidhje me shkaqet e shkaterrimit te shume popujve ne histori. Ne nje analize dhe vleresim te tille na bien ne sy menjehere ky fakt qe ka dy faktore kryesore qe garantojne nje bashkesi besimtaresh. Mosprezenca e tyre percakton sjkaterromin dhe fatin e pashmangshem te bashkesise ne dy klasa. Nga cdo ane qe mund ti afroheshim kesaj ceshtjeje do te arrinim ne te njetin perfundim. Nese ne nje bashkesi zbatohet konkretisht udhezimi ne te mire dhe ndalimi ne anen tjeter edhe nese nje bashkesi ka qofte edhe pak persona qe e kryejne kete Allahu(xh xh) nuk e shkaterron ate bashkesi. Deri tani iu afruam ne anen pozitive te kesaj ceshtjeje. Natyrisht duhet te shqyrtojme kete ceshtje duke theksuar notat kritike edhe ne anen negative. Nese ne nje bashkesi nuk ka asnje qe te udhezoje te miren dhe te ndaloje te gabuaren Allahu(xh xh) e shkaterron totalisht kete bashkesi. Ne anen tjeter nese ne nje bashkesi ka nje numer te konsiderueshem trimash qe e kryejne kete detyre te shenjte por kane shpallur daten dhe jane prane humbjes perballe arrogances dhe ngacmimeve te te tjereve perseri Allahu(xh xh) e shkaterron ate popull. Ne momentin e duhur do te mundohemi ta sqarojme kete aspekt ne ditën e qarte te ajeteve. Qe ne fillim dua te theksoj faktin se faktor i vlefshem per te ndaluar shkaterrimin total te nje populli eshte kryerja e kesaj detyre te shenjte permes ngritjes se cerdheve te shpetimit te ngritura nga bashkesia e besimtareve. Nje popull mund te shpetoje nga nje rruge e tille pa krye vetem ne saje te perpjekjeve te ngjashme serioze...

Ja disa shembuj:

a) Hz Nuh

Hz Nuh(as) gjate gjithë jetes se tij kishte thirrur ne rruge te drejte,por ne cdo perpjekje te tij populli i tij e kishte kundërshtuar dhe e kishte keqtrajtuar. Sase Hz Nuh(a.s) do te detyrohej ti kerkonte ndihme Allahut kunder mosbesimtareve duke pranuar edhe disfaten e tij. Lutja e nje Profeti te tille smund te refuzohej dhe nuk u refuzua. Kurani fshnik na e tregon kete ngjarje domethenese:” Populli i Nuhut qe ishte para ketyre idhujtareve pergenjeshtroi dhe robin Tone (Nuhur) e quajten genjeshtar dhe i thane :”i marre!” dhe ju pre rruga. Dhe ai iu drejtua fatit te vet :”Une jam i mundur,prandaj me ndihmo!”

Atehere ne me nje shi te vrullshem i hapen dyert e qiellit. Dhe ne token e zberthyem ne burime uji ,kurse uji u bashkua sic ishte caktuar. E Ate (Nuhun) e barten ne “anijen” derrasash e shtyllash te gjunjezua qe lundronte ne mbikqyrjen tone.(i fundosem).

Si ndeshkim per ate(Nuhun) qe ishte mohuar(perbuzur). Ate anije ne e lame per kujtim,po a ka ndokush qe nxjerr mesim? E si ishte mdeshkimi dhe kercenimi im?”(Kamer,54/9-16)

Hz Nuh(a.s) ishte nje profet i paisur me forcen profetike dhe mbartur mbi koke kuroren e te qenurit profet. Ai ishte nepunes i Allahut dhe jo i ndonje tjetri dhe i ftonte njerezit te beheshin mbreterit e Allahut. Por populli i tij e quante ate “te cmendur”. Kjo shprehje e tyre deshmonte madheshtine e besimit te profetit,sepse ekuilibri i jetes shoqerore te asaj bashkesie ishte permbytur duke i kthyer ne te kundert te gjithë vlerat morale. Ne syrin ishte e natyrshme qe gjendja e Profetit te ishte jonormale dhe te arrinte ta quanin te cmendur. Ky profet famelarte perpiqej ta restauronte shoqerine qe ata e kishin prishur dhe padyshim qe nje njeri i tille do te damkosej me nje epitete te tille. Per kete arsye edhe i Derduari i Allahut(s.a.s) ne nje hadith thote se te quajturit i nje besimtari i cmendur tregon madheshtine e besimit te tij. Hz Nuh(a.s)perballe kryengritjes se popullit te tij hapi duart dhe ju lut Zotit te tij,“O Zoti im,une deshtova,me ndihmo!”. Dhe Allahu(xh xh) e fundosi nen uje popullin e tij te pangopur. Nga uji qe binte nga qielli e buronte nga toka te gjithë mohuesit u zhduken duke u mbytur. Ndoshta ishte qyteterimi Atlantis e ndoshta edhe ndonje qyteterim tjetër ska rendesi nese ata njerez u fundosen ne oqeanin Atlantik apo ne ndonje det tjetër. Vlen te permendet se ndonese ne mes tyre kishte nje profet qe udhetonte ne te mire dhe

ndalonte te gabuaren nje qyteterim fundosej sepse ai profet shpall deshtimin e tij.

Ajeti pas tregon gjendjen e tyre qe po mbyteshin nen ujerat dhe gjendjen e Hz Nuh(a.s)dhe i njerezve rreth tij ne nje varke pyet: A ska njeri qe snxjerr mesim?”

Ne kete rast le te bejme edhe ne shtesen tone. A ska njeri qe snxjerr mesim nga germadhat e Sartit? A ska njeri qe snxjerr mesim dhe si vjen te qaje nga mbetjet e Bergames? As nga Troja snxirret mesim? Ka me qindra germadha ne siperfaqen e Tokes ...dhe secila prej tyre tregon ne menyre te qarte fatin e nje populli duke qene si shembuj te gjalle para syve. Akoma ska njeri qe te nxjerre mesim nga te gjitha keto?...

b) Hz Salih

Edhe fisi i Hz Salih(a.s)kishte ngritur krye ndaj profetit te tij. Allahu(xh)si mrekulli i dergoi nje deve dhe kerkoi qe ajo te mos prekej. Ishte e dhimbshme se ata duke u treguar te pafytyre e djallezor e preken devene. Te mos prekurit e devesh ne pamje te pare duket e veshtire per tu kuptuar. Njerzit nen cdo etape kane qene nen disa detyrime dhe obligime. Te falurit,te agjeruarit dhe Zekati jane nje lloj i ngjashem obligimesh por mund te permendim edhe te mos piset e alkolit,mos kryerja e zimase dhe mos marrja e rryshfetit. Por dhe te mos prekurit e devesh mund te jete nje obligim dhe nje prove e tille. Populli i Hz Salih(a.s) ndodhej perballe nje prove te tille duke e humbur ate. Ne suren(kaptinen) shems kjo ngjarje na percillet ne kete menyre:

“Populli Themud pergenjeshtroi(te Derguarin e Allahut) per shkak te arrogances se vet. Kur ne fatkeqesi mes tyre u hodh(per te prere devene) profeti iAllahut ju drejtua atyre:

“Mos prekni devene e Allahut dhe mos cenoni te drejten e saj perte pire uje “ Por ata e mohuan dhe e theren ate deve. Pas kesaj Zoti i tyre u leshoi njeri pas tjetrit ndeshkime per shkak te mekatit te tyre duke i rrafshuar.

Perballe mosbindjes se popullit te tij shohim se Hz Salih(a.s) eshte ne gjendje qe tju terheqe vemendjen vetem me fjale duke i paralajmeruar”Mos e prekni ate deve” ,pasi te prekurit e devesh do te thote ti besh varrin vetes.

Po shihej qarte se populli i tij nuk e degjoi ate dhe me arroganti si perfaqesues i tyre beri ate qe duhej bere.

Ne fakt ne cdo epoke ka ndodhur njelloj. Dikush ka mbajtur flamurin e mosbesimit e turma te tera i kane shkuar pas. Dhe ata qe ne apoka te ndryshme kane prekur fene tone u kane hapur rruge fatkeqesive e katastrofave te tilla duke cuar ne shkaterrimin e nje populli me virtyte e me histori te lavdishme. Tatepjeta e nje populli ka nisur ateherë kur kane filluar tendencat per te prekur uranin. Me vone edhe nese kane nderruar personat stragjedia dhe perpjekjet kane mbetur te njejta. Gjithmone ka patur prej atyre qe jae munduar te fshehin rrugen per ne Qabe dhe qe jane munduar te turbullojne ujrat e kulluara e gjithmone do te kete njerez te tille...

Dhe ne arroganti i popullit Themud u hodh para dhe pa ju vene veshin fjaleve te profetit e therri devene. Ne kete menyre si ai qe kreu kete veprim dhe si ata qe heshten perbale nje veprimi te tille pergatiten fundin e tyre. Allahu(xh xh) i shkatërroi i Popullit i shkatërroi te gjithë dhe pa ndare te miret nga te keqinjtë i groposi te gjithë ne varrin e te shkuares. Ky qe nje shkatërrim jo vetem fizik por arrite te fshije emrin dhe cdo gjurme te ekzistences se tyre. Ndonjëherë fatkeqesite nuk prekin pamjen e jashtme por shfaqen ne formen e shqetesimeve e konflikteve te brendshme sociale. Eshte e veshtire te besh dallimin mes tyre por tronditje te tilla te brendshme shpirtërore lidhen me faktin qe njerzit sa arrijne te kuptojne rrezikun qe ju kanoset.

Ne fund te sures(kaptines) Shems thuhet: “Se mos kane frike nga nje fund I tille (nga nje denim I tille I Allahut)?” Pastaj ai eshte poseduesi I gjithshkaje ndaj mund ti administroje sipas deshires gjerat qe u perkasin. Nen driten e ketij ajeti shihet qarte se kur Hz Salih(a.s) ishte shume prane disfates dhe sishte ne gjendje ti bente ata ti binden me fjale Allahut(xh xh) e shkatërroi ate popull duke e fundosur ne toke. Allahu(xh xh) e krijoi universin dhe vecanarisht njeriu qe ta njohe ate. Ky eshte qellimi I ekzistences se botes dhe kur njerzit e asaj kohe dhe ndonjëherë sikurse dhe ne shembullin e mesiperm igropos perjetesisht. Ky eshte nje ligj hyjnor qe ska ndryshuar dhe sdo te ndryshoje ndonjëherë.

c) Hz Lut

Hz Lut(a.s) u shfaq ne nje vend qe mund ta quajme shume prane nesh. Populli I ketij njeriu te larte si pasardhes I Hz Ibrahim(a.s) kryente nje mekat qe deri ateherë se kishte pare njerzimi qe quhej “Livata”(marrdhenie Brenda se njetes gjini) dhe profeti famelarte bente nje lufte te madhe nga mengjesi deri ne darken e kete mekat.

Nje dite ne shtepine e tij vijne engjejt ne formen e djemoshave simpatik. Populli arrogant vjen ne shtepine e Hz Lut(a.s)

Duke iu pergjeruar ju tha “Mos me turperoni para mysafireve te mi”. Ju ofron vajzat e tij per tu martuar me to duke u munduar ti ftoje ne nje rruge te prenueshme por te gjitha perpjekjet e tij shkuan kot... njerzit e ulet ju pergjigjen: “Ne skemi asnje pune me vajzat tuaja,ti e din shume mire se cfare duam”. “Sikur te kisha force te mjaftueshme ndaj jush e te kisha ku te mundte mbeshtetesh ,”(Hud.11/78.80) ju drejtohet i lenduar shpirterisht Hz Lut(a.s). Ne fakt ai kishte nje mbeshtetes te fuqishem ,por situata e ndere e bente te shprehej ne ate menyre. Engjejt nen pamjen e djemoshave i treguar se kush ishin,atehere Hz Lut(a.s) mori fryme lirisht.

Ja disa aspekte te permenduara ne Kuran ne lidhje me kete histori te gjate. “Kur i erdhen te Derguarit tone Lutit ,ai u merzit e u ndie ngushte nga ardhja e tyre e tha:<< Kjo eshte nje dite e veshtire>>. Populli i tij qe dhe me pare benin pune te turpshme erdhen me te shpejte te ai ,e ai ju tha:<<Populli im! Keto jane vajzat e mia(martohuni me to),ato jane mete pastra per ju ,pra kijeni frike Allahun dhe mos me turperoni para mysafireve te mi. A ska ne mes tuaj ndonje te mencur?” Ata i thane:<<Ne nuk kemi ndonje lakmi ndaj vajzave te tua dhe ti e di shume mire se cfare duam.>> Ai tha:”sikur te kisha force te mjaftueshme ndaj jush ndaj jush ose te kisha se ku te mbeshtetesh per perkrahje?” Engjejt i thane :“O Lut!ne jemi te Deguarit e Zotit tend ,ata skane pertua afruar dot ...e ti nisu per rruge se bashku me familjen tende naten. Pervec tat shoqjeje asnje te mos shohe pas dhe ajo do te goditet me ate qe do te goditen dhe ata. Afati i tyre eshte mengjesi ,a nuk eshte mengjesi afer?” Kur erdhi urdheri yne atyre ua soli token mbi koke duke leshuar mbi ta gure te medhenj. Ky fat sdo te jete i larget per tiranet .

Vertete Sodom Gamore u shkaterrua duke u groposur ne thellesi e liqenit Lut. Nje fat i tille i popullit te Hz Lutit do te jete fundi i padiskutueshem i tiraneve dhe te pabindura ne cdo epoke kohore.

Edhe pompeii eshte nje nga shembujt mete spikaturit te nje fati te tille. Aty kishte kristiane qe propagandonin te drejte dhe te verteten por edhe ata ishin ne gjendje disfate. Populli ishte zhytur ne nje degjenerim i imoralitet te tille saqe Allahu(xh xh) i beri ata te bashkohen me te vdekurit duke u shnderruar vendin ne nje varreze nga lava qe te dilte nga mali Vezuf. Megjithse disa ishin larguar ne bregun e detit ata u gruposen dhe aty nen valen e mases se llumit sa lartesia e shtepive.

Allahu(xh xh) me qellim qe brezat e ardhshem te nxjerrin mesim i beri keto vende si nje deshmi e gjalle e fatit qe pesojne ata qe kryejne veprime ne kundershtrim me te drejten e padiskutueshme te fjales se Zotit. Ne muret e mbetura te Pompeit mund te sodisni imoralitetin me te shemtuar. Vendet e pushtuara nga prostitucioni qofte edhe pjeserisht jane nje tablo domethenese. Allahu i madherueshem i la ato si nje panorame mesimdhenese me qellim qe te mencurit te shohin dhe te nxjerrin mesim nga e shkuara.

a. Te tjeret

Pushteti i pafund ashtu sikurse i dha denimin kapital per popullin mosbesues te Hz Lut(a.s) ka dhene te njetin verdikt edhe per shume popuj te tjere ne histori.

P.sh Andaluzia pas nje sundimi te nje qyteterimi madheshtor per mese gjashte shekuj me fillimin e ndryshimeve te brendshme u detyrua te largohet me pahir nga shpata e Ferdinantit nga vendi ku ishin futur si triumfator. Ne kete kthim te turpshem myslimanet qanin. Ndonese koha e te qarit kishte kaluar me kohe,per me keq qanin per gjera qe sja vlente te qajej. Ndersa ja vlen te qajej per shkaterrimin qe u kishin bere me duart e tyre qenjes se tyre duke pare hamanet e Tulej tules te mbetura nga ajo kohe ,ata qanin per kufomat e tyre.

Kjo ishte edhe fryma qe shkaterrroi Abbasite dhe Emevite. Edhe selcuket provuan fundin e dhimbshem ne jetuaren sipas qejfit. Fundi i Osmanllijve ishte nga e njeta shembje shpirterore. Kur futemi ne pallatin mbreteror te Dolmabahcese dhe degjoni se vetem per te mbushur me yje gjashtembedhjete ton ar do ta kuptoni lehte shkakun e shembjes e shkaterrimit. Ky eshte nje ligj hyjnor qe asnjeher ska ndryshuar kurre.

Duke filluar nga shembja e perandorise Romake ,e asaj te Sasanit e deri ne shembjen e kultures se lashte Egjyptiane te gjithe muzete historike entografik smund ti analizoni duke u mbeshtetur ne nje parim. Allahu(xh xh) e shkaterron ate vend ku ai spermendet dhe skujtohet ,sepse atij vendi si mbetet me shkak per te vazhduar ekzistencen e saj. Mendoj se ky eshte dhe shkakun i kjametit(apokalipsit). Kur besimtaret ndihen shume te dobet dhe kur arroganca te arrije kulmin Allahu(xh xh) do ta ktheje boten permby. Pasi kesaj bote sdo ti kete mbetur me qellim egzistence.

Kur Kurani fisnik te shnderrohet ne nje liber te pakuptueshem te dihet mire se hija e fatkeqesive dhe katastrofave eshte mbi koken tone. Nese

akoma sbehet fjale per nje shkaterim total kjo per shkak temeshires se tejskajshme te Allahut fuqiplote. Hz Ebu bekir((r.a) perballe kesaj meshire te Allahut habiste veten dhe thoshte:” Sa e madhe eshte dija jote o Zot!” Vertete qe Zoti eshte zoteruesi i dijes dhe gjithmone u jep shance per tu penduar por nese ata tregohen kokeforte atehere si fal me. Mendoni se Allahu mundohet te prezantoje veten permes meshirimit dhe meshireberjes. Atehere ne na del si detyre ti pergjigjemi meshires se Zotit me nenshtrueshmeri e perkushtim duke u bere ushtare shpetimi te sigurte qe mbartin drejt Allahut boten e tyre shpirtore plot besim dhe siguri.

Ne fakt besimtari para se gjithash eshte nje njeri qe jep siguri dhe as qe behet fjale qe te vije ndonje e keqe nga ai. Myslimanet jane garancia e njerzimit dhe jeta shoqerore eshte e brojtur me ta. Duke qene ne nje pozicion te tille perballe gjithë njerzimit besimtari per njerzit e tjere qe besojne eshte me i afert dhe me i afrueshem. Per kete arsye ai gjendet ne nje pozicion te tille qe bukurite qe i jane dhuruar nga Allahu(xh xh)dhe i Derguari i Tij(s.as.) tjua transmetoje tegjitheve pa dallim.

Eeshte i sjellshem dhe i kujdesshem ndersa mundohet qe nga njera ane te forcoje besimin ne bashkesine ku jeton dhe nga ana tjeter ti mbroje ata nga demet e ndryshme.

Ata qe sduan ta marrin persiper nje detyre te tille do te thote qe refuzojne titullin “besimtar” qe iu jep atyre nje superioritet.

Duke filluar nga rrethi me i vogel qe eshte ai i zemres e deri ne rrethin me te madh qe eshte ai shoqeror sipas gjendjes qe ka secili besimtar ndodhet perballe nje sere detyrash. Per te arritur shtepine,fshtin,krahinen e mbare gjithë njerzimin ai duhet te perhape ndricimin permes shpalljeve qe rrezatojne drite qe ai i ka ne dore. Eshte nje mangesi dhe nje e mete qe con ne privimin e te tjereve nese nenvleresohet kjo ceshtje dhe nese ata se kuptojne se kane te qarte.

Ne te njeten kohe nese si dihet para mosbesimit dhe ateizmit nuk do te jete vetem mosbesimtaret dhe ateistet qe do te shkaterohen por edhe besimtari do te marre pjesen qe i takon ne kete shkaterim. Prandaj besimtari te pakten duke filluar nga kjo pike duhet te urdheroje nete mire dhe te ndaloje te gabuaren dhe nuk duhet ti jepet mundesi fatkeqesise se pergjithshme njerzore.

Duke e theksuar kete fakt i Derguari i Allahut(s.a.s) e nje hadith thote:

“ Shembulli i atyre qe zbatojne dhe nuk zbatojne urdherat e Zotit ngjan me shmebullin e udhetareve te nje anije udhetimi. Nje pjese e tyre gjendet

ne katin e poshtem dhe nje pjese ne katin e siperm. Ata qe ndodhen poshte e sduan te shqetesojne vellezerit e tyre larte ju thone atyre qe per te marre uje duhet te shpojne fundin e anijes, nese kur ata perpiqen te bejne kete ata qe banojne larte mbyllin syte ndaj ketij veprimi, te dy palet jane te destinuar te fundosen.

Ne fakt fjalet e te Derguarit te Allahut(s.a.s) jane nje shembull. Ne logjike kesaj i thone krahasim me shembellyura. Ne kete menyre Vula e Profeteve permes ketij shmbulli mundohet te trajtoje nje problem te brendshem shoqeror duke e shprehur sipas niveli tone te kuptuarit. Dëshira e atyre qe duan te shpojne anijen duket shume i pafajshem por rezultati nuk duket dhe aq i pafajshem.

Mund te themio duke u nisur nga ky hadith se bota eshte nje anije si ajo e Hz Nuh(a.s). i gjithë njerzimi pavarsisht nga preferencat tashme ka hypur ne ate anije pasi ne kete bote te gjithë jemi te detyruar te jetojme ne te njejtin mjedis. Mjeti lundruar me te cilin udhetojne dhe jetojne bashkesite eshte i vetmi dhe nuk ka te dyte. Menyra e jeteses ne kete anije i perket atij qe na ka vene ne ate anije ,ndaj asnjëri ska te drejte te cenoje dhe te shkele kete rregullsi. Ne kete rast sbehet fjale per jeten personale.

Eshte detyre e te gjithëve ta ruajne dhe te kujdesemi qe kjo anije te mos fundoset. Eshte nje pergjegjesi qe e kemi marre persiper qe kur kemi hypur ne kete anije. Duke u sjelle ne menyre njerzore per te mos u ngaterruar gjoja me punet e te tjereve nuk mund te tolerojne sjellje qe mund te demtoje miliona njerez te pafajshem. Eshte e nevojshme te perballemi me cdo njeri qe do te shpoje kete vapor dhe te ngararroje jeten shoqerore. Atehere eshte detyrim moral qe nga njera ane te zhdukim te keqen ,genjeshtrën dhe mashtrimin nga shoqeria duke mbrojtur mbare njerzimin nga e keqja e tyre dhe nga ana tjeter duhet ta paisim kete shoqeri me vlerat dhe virtytet me te larta. Bashkesia e formuar nga individë te paster moralisht eshte e paster nga cdo ves i keq. Kjo eshte nje ane e kesaj ceshtjeje nga ana tjeter kjo kushtezon faktin qe ne bashkesi te hedhin shtat vetem virtytet e larta.

Ky eshte misioni qe kemi marre persiper ne shoqerine tone. Ky eshte nje mision sa i shenjte aq i rende dhe i veshtire. Eshte domosdoshmeri misionare qe njeriu qe ka provuar shijen e besimit te vertete, te ndihmoje te tjeret ta provojne kete ndjesi dhe te ndaje me to ato gjithshka qe ai ndan. Besimtari eshte krye e kembe burim miresie. Nderkohe qe ai jeton nje pranvere mendon qe edhe te tjeret te perfitojne. Ja kjo pranvere ,duke i bere

ata te perjetojne te njejten ndjesi. Pastaj a nuk eshte besimtari njeriu qe heq dore nga deshira e te jetuarit per tu dhuruar jete te tjereve? Nese drita e besimit futet ne shpirtin e nje njeriu si mund qe ai njeri te qendroje ne vend dhe te mos levize? Kjo pamundesi e ben besimtarin te shetise shtepi me shtepi ,Pazar me Pazar e dyqan me dyqan duke i bere njerzit te jepen shpirterisht pas tij. Nga nje ane kjo eshte garancia e ekzistences se tij,eshte garancia per te ruajtur besimin deri ne vdekje dhe per tu futur ne varr me po ate besim. Ai qe nuk urdheron ne te mire dhe nuk ndalon te gabuaren nuk ka ndonje garanci te tille. Atehere per besimtarin se paku per te shpetuar gjendjen e tij duhet qe patjeter te beje kete detyre te shenjte.

9) Thirrja eshte mase vleresimi sesa dalin ne mbrojtje te fese.

Feja islame ka garancine e Allahut(xh xh). Kjo garanci do te zgzjase deri ne ditet e kjametit(diteve te fundit te shkaterrimit). Ne kete aspekt ka nje prentim hyjnor dhe Allahu do ta mbroje fene e tij. Kjo ruajtje dhe mbrojtje do te behet permes daljes ne krah ndaj besimit te gjithë individeve mysliman. Kjo eshte nje kusht i vene nga Allahu(xh xh). Per sa kohe qe ky kusht do te shkoje ne vend kjo do te thote qe kjo fe do te ruhet,ndaj dhe premtimi hyjnor duhet kuptuar me teper ne kete drejtim. Njeriu besimtar duhet te ruaje rolin e kopshtarit kundrejt fese se tij. Neqofte se njerzit besimtar nuk behen kopshtar dhe mbrojtësit ata privohen nga begatia dhe miqesia qe sjell feja. Kjo sdo te thote qe Allahu nuk do ta mbroje fene. Ndoshta ata nuk luten dhe skerkojne ndonje gje,duke mos iu falur kesaj pune ndonese kjo eshte nje kusht per ta ,ndaj dhe Allahu do ti shkaterroje e do ti beje si mos me keq ose do ti privoje ata nga begatia. Feja do te ruahet nga Allahu(xh xh) permes daljes ne krah te besimtareve. Feja do te lartësohet ne masen qe ndjekësit e saj do ta arrijne ta perhapin ate gjithandej duke i cuar dhe ne skajet me te larta. I derguari i Allahut(s.as.)i doli ne krah fese dhe Allahu(xh xh) e ruajti fene. Dhe me vone per shekuj me rradhe i dolen ne krah asaj dhe perseri Allahu(xh xh) e ruajti ate te paprekur. Atehere kur feja e la pas dore Allahu(xh xh) i beri si mos me keq cdo njeri me gjithshka qe kishte. I derguari i Allahut e mori kete ceshtje si me te vyeren duke u munduar ti terheqe vemendjen popullit te tij dite nate. Lumturia ne boten e pertejme lidhet me perjetimin qe njeriu i ben ceshtjeve te besimit. Me pas si ne ditet e gjykimit ,ne urin e Siratit ne parajse dhe ne momentin e vrojtimit te mdheshtise hyjnore e vetmja qe ka vlere eshte besimi ndaj fese,punet e mira dhe zemra e paster. Dhe i Derguari i Allahut(s.a.s) u perpoq pa rreshtur per te mund

tju dhene popullit te tij nje leter te tille kalimi. Thirrja ne fe eshte ceshtja me paresore e tij. Permes perpjekjeve te tij arriti qe te zgjaste te njeiten vetedije ne popullin e tij. Dhe ata me gjithë zemer i dolen ne krah fese dhe perpjekjet e tyre nuk shkuan kot. Sepse Allahu i Madherueshem(xh xh) iu pergjigj pergjigjeve te tyre duke ruajtur fene. Dhe Sahabet(shoket e Profetit)shperndare ne kater cepat e botes mesazhin qe moren nga i Derguari i Allahut(s.a.s) duke konkuruar me njeri tjetrin. Ndoshta ne emrin e fese ato dinin disa Ajete dhe disa hadithe por ata dhe i vinin ne jete dhe i perhapin ane e mbane botes. Vajtja e Musab b.Umeyr(r.a) nga Meka ne Medine ishte vetem si pasoje e ketij qellimi ,dhe ai kishte shkuar i vetem ne kete krahine te larget,duke mos patur asnje me vete. Nga Medina ishin ngritur dhe kishin ardhur te Profeti yne duke iu kerkuar nje mesues qedo tju mesonte fene ,dhe i Derguari i Allahut(s.a.s) dergoi i Musab b.Umeyrin(r.a) i cili rrinte si mysafir ne nje shtepi. Cdo dite i vini nje nga te paret e Medines dhe ai ju mesonte fene. Nje dite kishte ardhur Usejd b Hudajr(r.a) tjetren Sad b.Ubade(r.a) dhe pastaj Sad b.Muaz(r.a) per te degjuar ate. Ata qe vinin me shporta nder duar ktheheshin ne zemrat plot besim. Musabi(r.a) sillej aq njerzishem me keta sahabe te medhenje te se ardhmes saqe ata smund te rezistonin gjate sjelljes se tij mjaft precese. “Shoku im,me degjo mua nje here ,pastaj po deshe ma prit koken se per Zotin as qe do te rezistoj...” ju thoshte Musabi. Perballe ketij personaliteti qe te vetmin preokupim qe kishte ishte tju fliste njerzve per te drejten dhe jeten e ndershme askujt shkriheshin dhe rradhet rreth tij cdo dite e me shume zgjeroheshin. Deri ne betejën e Bedrit jeta e Musabit kalonte vetem duke propaganduar fene. Ishte epoke propagandimi dhe detyra qe u dilte sahabeve ishte propagandimi i fese. Perhapja e fese eshte nje pergjegjesi por dhe ruajtja e saj eshte nje pergjegjesi tjetër. Ne betejën e Uhudit Sahabet kapnin shpaten per te zbatuar detyrimin e ruajtjes,dhe nemes trimave qe kishin kete detyre ishte dhe Musabi(r.a). ai luftoi me shpate deri ne mbremje aq sa dheengjejt e kishin zili. Nje moment Musabi shembet perdhe nga plaget e marra. Nje engjell merr formen e tij dhe vazhdon betejën. Nga mbremja i Derguari i Allahut (s.a.s)e therret “Musab!” por ai i pergjigjet:”une sjam Musabi O i Derguar i Allahut” sishte e veshtire per tu kuptuar Musabi kishte kohe qe kishte rene shehid(deshmor).

Me vone i Derguari iAllahut(s.a.s) dhe nje grup Sahabesh ofrohen prane trupit pa jete te Musabit dhe shohin se dy krahët i kishte te keputura te shpatullat. Goditja qe kishte marre ne qafe kishte qene aq e fuqishme sa

per pak e kepuste koken nga trupi. Vetem disa muskuj e mbanin ate koke te vyer me trupin dhe dukej sikur Musabi po e fshihte fytyren ne toke.

Vazhdimi i historise ne nje transmetim te dobet tregohet keshtu:

“Perse Musabi i kishte fshehur fytyren vetem i Derguari i Allahut (s.a.s) e kishte kuptuar. Mes loteve ai iu shpjegon ngjarjen Sahabeve ne kete menyre:”A e dini se perse Musabi e ka fshehur fytyren? Arsyeya e pare ishte se i kishin keputur krahët dhe tashme ai smund ta mbronte te Derguarin e Allahut. Cdo te bente nese ne ate moment dikush do te sulmonte te Derguarin e Allahut. Arsyeya e dyte ishte po dilte para Zotit ndersa duhej te ruante Profetin. Po sikur Profetit ti ndodhte dicka me csy e faqe do ti dilte para Zotit ndaj dhe mundahej ta fshihte fytyren.

Teksa thoshte keto i Deguari i Allahut shprehte mendimet rreth nje shpirti besnik dhe te perkushtuar perballe te vertetes se pamohueshme. Ate dite sishte vetem Musabi qe mbarte nje shpirt te tille. Te gjithë Sahabet(shoket e Profetit) mbartnin te njetin shpirt dhe te njeten vetedije. Perballe ketij perkushtimi e devotshmerie te tyre Allahu eruante fene.

Kjo ruajtje vazhdoi per njefarekohe dhefilloi te perjetonte lekundjet e pjesshme. Nekete faze lekundjesh duke mos i dale nekrahe fese dhe Allahu e preu pjeserisht begatine dhe miresine e fese,sepse kjo fe eshte e jona ne masen qe ne i dalim ne krah Allahu do te na privoje nga te mirat e fese.Selahadin Ejubit si qeshi fytyra mbeti duke qare per vite me rradhe per sa kohe qe zgjati pushtimi i Jeruzalemit nga tryqtaret. Nje dite ai qe mbante kumtesen(hajipi)po fliste mbi domosdoshmerine e te qeshures dhe buzeqeshjes. Pas faljes kur Hatipi po kalonte prane Selahadinit ai e kapi per dore dhe i tha keto fjale qe do te mbesin ne kujtesen njerzore:

“Zoti mesues,me duket se fjalen e kishit per mua. Por pashe Zotin me thuaj se si mundte qeshi ku xhamia ku profeti u ngrit ne mirazh ndodhet ne duart e armikut?

Ai njeri i madh do te flinte ne nje tende deri sa xhamia e Jeruzalemit te rimerej. Shpesh thoshte si mund te kem shtepi une kur shtepia e Allahut eshte pushtuar. Ja pra ata e mbrojten fene ne kete menyrendaj dhe feja ishte e tyre. Tashme eshte rradha jone sikur te mundti dilnin per zot fese si ata!...Eshte detyrim mbi detyrim per cdo besimtar qe ne ditet tona te mund te dale zot fese duke e perhapur ate permes perfaqesimit dinjitoz ,dhe asnjeri smund te mbetet jashte kesaj te fundit. Cdo besimtar para se gjithash duhet ta njeohe fene e tija pra se gjithash ,ta jetoje dhe tjua tregoje te tjereve

feneqe eshte bere jeta e tij duke e zbukuruar jeten e tyre ne kete drite. Sipas besimit islam cdo besimtar e quajne te ngarkuar ne kete detyre.

Dua te ndalem ne disa aspekte qi i gjej te rendesishme pasi jam i mendimit se nuk njihet si duhet rendesia e tyre dhe sqendrohet sa duhet mbi kete fakt. Them se ka disa shkaqe qe kane cmuar qe myslimanet e diteve te sotme te bie ne kete gjendje te mjerueshme.

Se pari eshte neglizhimi dalengadale i fese,se dyti eshte lenia e sherbimeve fetarete nje kategorie te caktuar njerzish te cilet kane zyrtarizuar dhe shnderruar ne nje monopol te tyrin. Arsyeya e dyte eshte e rrezikshme per ne po aq sa dhe arsyeya e pare. Pasi feja smund te privatizohet dhe smund te behet prone e nje kategorie te caktuar njerzish. Feja eshte e te gjitha besimtareve te saj. Cdo individ ka njelidhje te vecante me Zotin dhe sikurse smund te zhduket ky raport individual mes Allahut dhe besimtarit ashtu dhe smund te ndalet asnje individ qe do ti dale ne krah dhe ne mbrojtje fese. Monopolizimi i sherbimit fetar eshte nje mekat dhe nje gabim qe seshte e mundur te falet. Pa shpetuar mire nga ky gabim seshte e mundur te mund te shpetoj nga kjo gjendje per te ardhur keq. Cdo individ duhet te zere vendin e tij perkrah fese me qellim brenda nesh te marre rruge shpetimi dhe shprese. Sjallja e ndryshme dhe te gabuara behen pengese qe feja te shpalose forcen e saj te padiskutueshme dhe mjaft te nevojshme.

Ne fakt lenia e sherbimeve fetare nje grupi tecaktuar duket se eshte pjese e nje loje te ndokujt. Nje veprim i tille nuk ka lidhje fare me botekuptimin e thirrjes dhe luftes per perhapjen e islamit. Feja islame nuk eshte nje fe qe mund te mbyllet brenda mureve te nje xhamie. Feja islame eshte derguar per te siguruar jeten tone ne kete bote dhe ne jeten e pertejme. Eshte njeteresi e tille qe nuk njeh copezim dhe ndarje. Atehere kur do mundta analizojme fene si njeteresi duke e meshiruar ne shpirtrat tane do te arrijme te shpetojme nga gjendja e mjeruar nete cilen ndodhemi. Ate dite individi do te mund te shqyrtojete gjitha ceshtjet njerzoree shoqerore nen driten e shpalljes hyjnore duke e shpetuar njeriun tone nga te kredhurit ne erresire. Per te arritu ne nje suate te tille para se gjithash duhet ti drejtohem me gjith shpirt fese qe mbeshtet mbi shpalljen hyjnore dhe mbi transmetimet plot drite te Profetit tone(s.a.s) dhe ta ndricoj boten tone shpirtore me ate drite madheshtore. Duhet te kemi parasysh faktin qe nese ne nuk endryshojmesituaten me perpjekjet tona dhe Allahu nuk do te na ndryshoje neve. Kjo eshte si ne aspektin e pergjithshem dhe ate

individual. Ajo qe do te na coje ne nje situate te tille eshte drejtimi i zgjedhur i individeve.

Devijimet e individeve sikurse mund ta fshijne jeten fetare drejtimi isakte i tyre e risjell edhe nje here ate. Atehere eshte thelbesore edukimi i individeve nje e nga nje qe ata te dalin per krah te fese se tyre.

Sduhet harruar se individe te shndoshe sjellin familje te shendetshme dhe familjet e shendetshme formojne bashkesi te shendetshme. Ne bazen e shoqerise nje here eshte individi e pastaj vjen familja. Pa edukimin e mire te individeve dhe familjeve as qe mund te formohet nje bashkesi e shendetshme. Kjo bashkesi e shendetshme mund ta siguroje vazhdueshmerine e saj duke ndjekur kufijte e caktuar nga Allahu dhe i Deguari i Tij(s.a.s). per te patur vijueshmeri brenda ketyrekufijve duhet qe cdo shpirt te pajiset me vlerat e larta morale dhe te pastrohet nga veset e keqija. Kjo eshte dicka qe mund te behet nga vete individet. Metoda dhe teknika per kete ceshtje najane percaktuar drejt per se drejti nga Allahu dhe i Derguari i Tij(s.a.s).

Drejtimi dhe thirrja qe nuk behet sipas kesaj metode dhe teknike nuk mund te jape kurre rezultatin e deshiruar. Pasi Zoti i madherueshem nuk mund te pajtohet me ndjekjen e njerruge tjeter pervec asaj qe eshte caktuar prej tij. Pa paelqimin e tij edhe sikur bota ta pranoje ate ceshtje ska fare vlere. Sa me afer Allahu(xh xh) te jemi ne aq me e madhe do te jete ndihma dhe meshira e tij ndaj nesh. Fatin tone te keq do ta ndryshojne vetem ata qe do ti dalin ne krah fese duke rregulluar nje komunikim permes meshires. Po e theksoj edhe nje here se kjo fe eshte e jona en masen qe do te mund ti dalim asaj ne krah.

PRINCIPET DHE METODAT E THIRRJES

Kapitulli i dyte.

Cdo shkence ka nje perkufizim dhe cdo pune ka nje menyre te vecante per tu bere. Pa nje perkufizim dhe pa nje teknike te percaktuar nuk mund te flitet per ndonje dege shkencore apo lloj pune. Dhe detyra e thirrjes si puna me e larte dhe e vecante ka sipas saj disa teknika dhe metoda. Nese thirrja nuk behet ne perputhje me keto teknika dhe parime do te ishte nje perpjekje mjerane dhe sdo tja vlente per asgje. Nese arrihet nje fitore e perkohshme duke mos patur nje te neserme do te jete nje disfate e pakthyeshme.

Poshte ketij titulli mendojme te paraqesim disa teknika ne formen e disa ceshtjeve. Po ta pranojme qe ne fillim metoda e thirrjes ne fene islame nuk eshte vetem mbi bazen e atyre gjerave qe do te rendisim ne. Si nje njeri qe e ka renditur veten ne rradhet e ushtareve te thirrjes dhe shpetimit (irshdit)qe ne moshen 9-10 vjecare ,duke u munduar ti vere ne jete keto parime dhe metoda nen driten e haditheve dhe ajeteve eshte marre per baze venia e lehte ne praktike jane pergatitur dhe do te mund tju percillen juve si mangesi e paaftesise tone per te qene sa me praktik. Sduhen harruar mendimet qe fitojne te drejten per tu ven ne jete jane ato qe shprehen duke u jetuar. Ky ka qene parimi yne kryesor ne kete permbledhje.

1.Lidhja mes shkences dhe thirrjes ne fe.

Eshte e rendesishme qe njerezit qe do te urdherojne gjerat e mira dhe ndalojne gjerat e keqija duhet te kene njohuri te mjaftueshme mbi shkencat e ndryshme. Pasi dija dhe thirrja e jane dy faqet e se njejtes se vertete. Per kete arsye njeriu qe ben thirrje ne fe si perkrahes i nje feje para se tju flase te tjereve mbi te vertetat e fese duhet te pergatise veten e tij si duhet ne fillim. Nete kundert sikurse mund te propagandohen shume gjera jo te verteta ne emer te fese por edhe personat ne kontakt me te mundte tremben dhe te largohen nga feja. Nje rezultat i tille ne nje fare mase do te ishte cenim i se drejtes ne kete bote dhe ne tjetren per veten dhe te tjeret.

Mendojme qe ne kete kapitull para se gjithash do te shpjegojme botekuptimin tone mbi dijen dhe shkencen ne kuptimin absolut dhe pastaj te shqyrtojme lidhjen mes thirrjes,dijes dhe veprimeve.

Dija eshte nje minare Ademjane ne te gjithë boten e qenjeve. Ne kohen e Hz Nuh ajo shenderrohet ne nje varke dhe u njesua me Hz Nuh. Dija te Hz Ibrahim shenderrohet ne nje fushe ne te cilen bie me bollek frymezim hyjnor. Te Hz Musa merr formen e njeshkopi duke u njesuar me te. Atehere gjithshka qe shihet ne univers formohet nga i njeiti model. Esenca e universit eshte dija.

Ceshte dija? Dija eshte njehja e Zotit permes njohjes se vete natyres njerzore. Njeriu duke u nisur nga vetja duhet te shohe Zotin,ne ndjenjat e tij te gjeje meshirimin e titujve dhe cilesive te vete Zotit duke u perpjekur qe ta kuptoje dhe ta njohe ate. Kjo eshte dija e vertete.

Dijetari Junus duke u shprehur:

“Dija eshte te njohesh shkencen

*shkenca eshte te njohesh veten
nese njeh veten cdo mund te thoje!”*

mund te theksoje boshtin kryesor te dijes. “Ai qe njeh veten njeh dhe Zotin’ eshte nje fjali plot delikatese qe mund te pranohet si hadith. Nuk eshte hadith por nje parim mjaft t goditur mbi bazen e kuptimit dhe mendimit qe jep. Kurani fisnik e forcon kete mendim permes ketyre fjaleve:

“Mos u beni si ata qe harruan Allahun,dhe Allahu i beri ata qe ta harrojne.”

Nese harroni Zotin ai ju ben juve qe te harroni veten dhe karakterin tuaj. Dhe kur harroni veten largoheni nga Zoti,dhe duke u larguar prej tij do te harroni gjithshka qe u jep forme juve. Ne kete menyre formohen nje sere rrathesh qe mbeshtesin dhe lidhin njeri-tjetrin. Nese futeni ne kete bashkesi rrathesh qe lidhen me njeri tjetrin dhe veshtire te dilni qe aty nese tentoni do te merrni te tatepjeten.

Ne anen tjetet nga ky ajet mund te nxirret dhe ky kuptim i tille:

Kini kujdes mos e harroni Zotin se nese ju e harroni ai ju ben te harroni veten tuaj. Dhe ju do te vazhdoni te merreni vetem me boten e jashtme duke mos ditur te analizoni si duhet veten tuaj. Kerkoni islamin por ate filloni ta kerkoni aty ku seshte. Permendni Kurani por prisni qe ato qe ai urdheron ti jetojne te tjeret. Ndersa rendni rrugeve e mitingjeve me nxenesit tuaj sarrini te kuptoni se po ndiqni djallin. Per te mos rene ne nje nivel te tille para se gjithash duhet qe njeriu te beje nje analize te vetes se tij dhe ti hedhe disa here brenda dites lidhjes qe ka me Zotin. Sikurse alpinistet qe u ngjiten majave te maleve duhet te kontrollojme disa here vendin ku kemi vene kembet dheku do ti veme. Duhet te sigurojme veten duke bere lidhjen nenje vend te sigurte pasi gabimi me i vogel mund te na kushtojte jeten.

Eshte per te ardhur keq kur njeriu humbet veten ne xhami ,ne faltore madje dhe prane Qabes! Duhet ta pranoj me keqardhje se numri i atyre qe kane humbur veten eshte shumeper tu numeruar. O Zot cfatkeqesi e madhe.

Qellimi i dijes eshte qe te rezultojne ne mjeshterine dhe dashurine hyjnore. Nje shkence qe eshte ne gjendje te flakeroje deshirat shpirterore si garanci e te mirave te parajses dhe te zgjojte dashurine per Allahun,nuk ja ka arritur qellimit te mirefillte te saj. Shkenca qe arrin synimin e saj eshte burim i nje jete te lumtur dhe epiqendra endjenjave tona. Te mbeturit pa te eshte nje vdekje shpirterore. Ndonese dija nuk eshte tema jone kryesore

duke arritur ne nje pike te tille dua te preki disa hadithe dhe ajete qe lidhen me dijen dhe shkencen.

“Thuaj a eshte njelloj ai qe din me ate qe nuk din?”(Zumur,38/8) A eshte e njete dija qe e merr perdore njeriun duke e cuar te Zoti medijen qe e burgos njeriun brenda laboreve?

A eshte njelloj dija qe e con njeriun tek koka e nje mikroskopi drejt Allahut permes shkalleve te drites duke e kapur per kendveshtrimin dhe qellimit temire ne dijen qe e con njeriun vetem drejt sistemeve dhe yjeve? A mund te njesohen keta njerez qe kane kendveshtrimete ndryshme? A eshte i njejte njeriu i ditur qe me nje rresht te vetem te shpalljes Kuranore sa nje biblioteke plot me libra mund ta fluturoje si nje pellumb ne qiell duke perjetuar cdo moment nje ndjesi te ndryshme,me njeriun qe shetit si mi i droguar neper libra duke shkruar gjithje jeten gjera te pavlera? Mendoj se mes tyre ka nje ndryshim te madh sa ne mes asgjese dhe gjithshkase. Dija qe e con njeriun te Allahu eshte gjithshka dhe ajo qe e braktis ate ne mes te rruges eshte asgje.

Ata qe jane plotesisht te respektueshem kundrejt Allahut jane dijetaret(Fatir,35/28).

Ne kete ajet shihet qarte vleresimi ndaj dijes dhe dijetareve. Kjo lidhet me situaten e njeriut qe me dijen e tij respekton Zotin e tij. Cdo dije ka nje peshe te caktuar ne jeten shoqerore. Per kete arsye i Derguari i Allahut(s.a.s) i afron dijetaret e vertete me profetet. Vetem profetet mund te shohin ne menyre te qarte te verteten ne siperfaqen e tokes. Ne mund te shohim anen e brendshme te gjerave permes drites qe reflektohet nga profetet. Nese nuk shkohet pas profeteve eshte e pamundur per njeriun te gjeje te verteten absolute. Ndoshta vete ai mund ti afrohet asaj permes perpjekjes dhe mundimit te tij por te verteten absolute ai mund ta arrije vetem permes deshmise se profeteve. Ne siperfaqen e tokes ata qe jane prane te vertetave te Allahut jane profetet dhe pas tyre vijne roberit e ditur. Ka nje lidhje te qarte mes fjaleve te Profetit tone te lartpermendura dhe kuptimit te ajetit te mesiperem. Besimtarete e devotshem qe kane fituar te drejten e mekembesit te Zotit ne siperfaqen e tokes sjane te tjere pervec dijetareve qe u afrohen profeteve. Profetet jane zedhenesit e se vertetes ndaj dhe cdo njeri ne masen qe arrin te jete pasqyrues i te vertetes arrin tju afrohet Profeteve.

I Derguari i Allahut(s.a.s) per te treguar vlerat e larta te dijetareve ben nje krahasim te tille:

“Epersia e dijetarit eshte si ai prioriteti qe kam si pozite une me me te ultin tuaj.”Ai qe eshte larg dijes ka shume mundesi qe ne cdo cast te rreshqase e te devijojë. Devijimi paraqet raportin qe ka individi me Zotin. Ka njerez te tille qe ne qoftese edhe per nje cast e largojne nga mendja Allahun dhe te Derguarin e Tij(s.a.s)u duket sikur kane bere nje devijim te madh. Dijetaret qe iu afrohen Profeteve gjithmone gjenden ne nje analize te vazhdueshme. Eshte mjaft i kujdesshem dhe i vemendshem perballe cdo rreziku qe i kanoset. Ai dijetar qe analizon cdo ceshtje me vetedije te plote dhe ben adhurimin si duhet eshte po aq superior sa dhe shoket e profetit dhe me larte se ata qe kryejne adhurimin dhe faljen pa vetedije. Ne fakt as qe mund te behet krahasim mes ketyre dy kategorive.

Nje ane tjeter ne kete ceshtje eshte qe njeriu qe u afrohet Profeteve nuk i shpeton asnje rreze drite nga frymezimi hyjnor ,e shnderron zemren e tij ne nje shkolle sa gjithe fakutetet ,duke mos shperdoruar asnje frymezim te shenjte si nje shembelltyre e meshires hyjnore duke thithur shprehjen e njesise dhe madheshtise se Zotit si nje central thithes i gjithe radiacionit qe vjen nga dielli duke u shenderruar ne nje ndermjetes dhe mbeshtetes i ketyre frymezimeve. Kjo ne te njeten kohe eshte shprehje e respektit ndaj Zotit dhe si mjet qe e karikon ate per te vazhduar perpara. Nje njeri qe mbushet perplot keshtu duhet qe te zbrazet. Kjo zbrazje arrihet permes transmetimit te drites dhe shkelqimit qe ndodhet ne shpirtin e tij dhe te gjithe te vertetave te tjera. Nuk ka ndonje njesi matese per te vleresuar kete veprim te tij te brendshem. Per kete arsye sado qe besimtari te thellohet ne adhurimin e tij sdo te arrinte adhurimin e barazvlershem me punen e dijetareve te vertet. Njeriu duhet ta vere ne praktike ate qe ai din. Ne te kundert ata do te perballen me kercenimin e Kuranit fisnik qe thote:

„Ka nje grup mes tyre qe ndonese e dine te verteten mundohen ta fshehin ate!“ (Bakara,2/146).

Dime shume gjera por sbejme asgje se vrimat e zeza ne kozmos qe thithin gjithe driten ose asnjeri sperfiton nga potenciali i drites qe kane,qe sido te jete nuk mund te shenderohet ne diell. Dielli eshte burim ngrohtesie si mjet ngrohes ,burim drite dhe nje ylber ngjyrash. Sikurse ledhaton lulet permes drites se tij u jep drite edhe planeteve. Ne lidhje me njerzit qe u ngjajne vrimave te zeza qe ndonese posedojne nje force dhe potencial te jashtezakonshem por qe mbyllen ne erresiren e tyre Profeti yne thote:“Kush meson dijen dhe e fsheh ate,ne ditën e gjykimit ne gojen e tij dote jete vene nje fre zjarri.“

Eshte mjaft i qarte kuptimi i kesaj fjale te mocme. Kush meson dicka dhe sjua transmeton mjedisit perreth ,kush mbushet dhe nuk zbrazet duke mos qene shembull edukativ ne fjalen dhe sjelljen etij,kush nuk behet pishtar i se vertetes hyjnore per te ndricuar gjithshka qe e rrethon ditën e gjykimit do te pesoje nje denim te tille. Ne kete hadith behet fjale per nje qortim dhe kercenim mjaft serioz. Freri u vihet vetem kafsheve dhe eshte nje shprehje mjaft e rende duke e krahasuar kafshen me njeriun qe fsheh dijen. Ai njeri ska ditur rendesine e njohjes se dijes se fshehte te Zotit,duke mos e pasqyruar ne qenjen e tij ,ka nenvleresuar rendesine e shprehjes se ndjenjave ,te te menduarit dhe shprehjes se menimeve qe e bejne njeiun qenje te zgjedhur dhe te vecuar nga kafshet,dhe si perfundim nuk ka shprehur falenderimin e tij per gjithshka qe i eshte dhene. Se sa i drejte eshte veprimi per ti marre ketij njeriu ate cilesi te vecante po jua le te gjykoni vete.

Dija dhe thirrja jane dy fytyrat e ndryshme te se njetes se vertete. Veprimi eshte kushti i pashmangshem i te dyjave. Keto te treja eshte e veshtire qe ti vecosh dhe ti ndash nga njera tjetra. Eshte shprehje respekti e dijes ta vesh ate ne praktike. Njeriu qe e njeh Zotin por qe nuk ben adhurimin qe i takon nuk eshte vetem nje mungese respekti por edhe nje moskokecarje,nje shurdhim dhe verberi. Madje mangesite qe tregohen nga ata qe kane marre persiper ti sherbejne besimit e demtojne fene islame me shume nga demet qe mund ti shkaktohen nga jashte. Qendrimi qe mbajne dhe opinionin qe percjellin perendimoret duke pare Myslimanet qe se jetojne islamin besoj se eshte nje argument i forte ne kete aspekt. Ky argument i percjelle nga ata qe gjithmone kane ushqyer armiqesi ndaj Kuranit eshte mjaft domethenes dhe i pranueshm.

Pyetet nje mysliman anglez se perse te gjithe anglezet se pranojne islamin. Pasi ata jane njerez te zgjuar qe kane drejtuar boten me politiken e tyre. Myslimani anglez nuk thote asgje por e merr perdore personin qe i beri pyetjen dhe e con ne nje xhami qe ndodhej aty prane. Ne xhami kishte mjaft njerez qe kryenin adhurimin vetem formalisht. Pergjigja e anglezit eshte vetem tregimi i asaj xhamie dhe i njerzve brenda saj. Kuptimi i kesaj eshte ky. Dihet qendrimi i perendimoreve ndaj sistemeve fetare te feve qe nuk kthehen ne nje menyre jetese duke mos u shenderruar ne praktike. Perderisa ne te dalim para tyre duke pasur unitet ne mes te botes se brendshme dhe asaj te jashtme ,duke pasur nje sinkronizim te zemres dhe mendjes,me shpirt te lidhur me Kuranin ,me veprime ne perputhje me fene

islame ,me synimin e vetem qe te dalim si nje bashkesi me preokupimin per te shpetuar njerzit,ata ne te shkuaren pa pritur nje propozim nga ne kane perqafuar islamin dhe do ta perqafojne ne te ardhmen.

Perendimoret perse te shkojne pas nje bashkesie qe nuk njihet fene e saj,nuk njihet Zotin e saj dhe si bindet librit te shenjte me nje paraqitje plot probleme e shqetesime. Ata shohin boten shpirtore dhe formimin e muslimanit dhe sesa i ve ne praktike ato. Vleresojne njeriun e tille qe ne renkiimin e tij permban dhimbjen e mjerave ,qe mban ne goje vetem fjalet hyjnore dhe naten e kalon ne adhurim,qe minimizon kohen e shkuar kot dhe e kalon kohen duke bere pune te dobishme ne cdo moment. Nese perfaqesuesit e islamit do te ishin te tille perendimi do te vinte duke vrapuar pertu futur ne islam,duke qene situate e kundert edhe reagimi i tyre eshte i ndryshem ndaj dhe ata per momentin jane larg nesh.

Ne menyre te permbledhur do te thoshim se islami eshte nje sistem hyjnor qe bashkon ne nje te vetem besimin dhe veprimet. Ne nje ane te tij eshte besimi dhe ne anen tjeter eshte venia ne jete e besimit. Eshte bukur tju shpjegosh te tjereve ceshtjet qe lidhet me besimin dhe kryerjen e veprimeve te mira,eshte mjaft domethenese por mos praktikimi dhe mos venia ne jete e ketyre gjerave nga muslimanet ka nje ndikim te kundert mbi te tjeret. Islami seshte vetem tregimi i njerzve te perkushtuar ndaj fese por meshirimi ne menyren e jeteses dhe praktikimi i gjithshkaje ne relitet. Islami eshte besim dhe praktike. Predikimi rreth sherbimit te islamit i atyre qe se pranojne ne kete menyre sehte gje tjeter vecse fjale pa ndikimin e duhur.

2. Te vertetat e islamit dhe njohja e epokes qe jetojme.

Ne kohen e sotme ka ndryshuar komplet vleresimi i sendeve ,analizimi i ngjarjeve dhe shikimi ndaj botes. Te llogjikuarit dhe te arsyetuarit sot eshte ne nje nivel me te larte. Mosbesimi dhe ateizmi po flet ne emer te shkences dhe filozofise. Perballe kesaj edhe muslimanet duhet ti pergjigjen me te njejten gjuhe,dhe kjo lidhet nga afer me njohjen e kultures se epokes tone. Kjo eshte dhe dija dhe shkenca e vertete. Dituria dhe perparimi jane nje cilesi e pandashme e besimtarit.

Njeriu qe nuk njihet epoken qe jeton do te thote qe jeton ne nje qorrsohak. Nje njeri i tille lodhet me kot qe tju flase te tjereve ne lidhje me

fene dhe besimin. Koha dhe evolimi i ngjarjeve ne mos sot nesisht do te lene te pafuqishem dhe pa ndonje ndikim. Per kete arsye myslimani duhet ti shpjegoje gjerat ne nje nivel te pershtatshem dhe ne perputhje me kulturen dhe nivelin e dijes se sotme dhe te komunikojme me te tjeret ne te njejtin nivel. Duhet te theksojme me force faktin qe udherrefyesit dhe keshilluesit qe do te mund ti mbahen ketij fati ne ditet e sotme ditet e gjykimit do te kalojne shume persona dhe d ote zene vend pas profeteve ,sepse kjo eshte nje detyre e shenjte dhe e rendesishme. Sado e veshtire eshte te arrihet nje pike e tille po aq eshte e nevojshme.

Njeriu qe nuk njeh kohen qe jeton ska ndonje ndryshim me ata qe jetojne nen toke. Njeriu i kushtuar thirrjes duhet te kete nje nivel te larte. Nderkohe qe ai me koke shetit mes yjeve me zemer e me shpirt duhet be jete ne thellesite e parajsës. Mendja duhet ta marre ate dhe ta coje ne labororet e Pastorit ,duhet te shetise me Ajshtajnin ne thellesite e ekzistences ,dhe me shpirtin e natyrshem te zere vend pas te Derguarit te Allahut(s.a.s)dhe disa here ne dite te kaloje permes shkolles se tij te jetes. Ky do te ishte pasuesi i devotshem sipas meje.

Shihni vulen e Profeteve(s.a.s) sesi u mor vesh ne epoken e tij duke ja paraqitur si shembull cdo gje per te ftuar ne besim bashkekohesve te tij. Cdo udher qe vinte nga Allahu i madherueshem nuk binte ne kundërshti me ngjarjet qe ndodhin ne univers. Mjafton qe njeriu te zoteroje shpirtin dhe qellimin e ekzistencen e njeriut dhe thirrjen ta pershtate me te. Dhe sahabet duke zbatuar mesimet e marra e zbatuan detyren e thirrjes ne perputhje me kushtet e diteve qe jetonin dhe ne perputhje me personat me te cilet ishin ne kontakt. Per kete arsye ata ne nje kohe te shkurter ata ua ngjiten ne nje nivel te fuqishem e dominues te afte per te gjunjzuar te gjithë boten. Te gjithë ata qe erdhen me pas qe mund ti afroheshin te Derguari te Allahut ndoqen te njejten menyre sjelljeje dhe komunikimi. Iman Gazali ,iman Rabani dhe Mevlana Xheladin Rumi e thuren rrjeten e thirrjes me botekuptimin dhe kulturen e kohes se tyre. Per kete arsye ndikimi i tyre ndihet i fuqishem dhe sot. Por sa keq qe i kthyem shpinen dijes si nje trashegimi e keqe ,harruam cilesite qe na bejne mysliman te vertete duke u bere kurban te injorances dhe paditurise se zemres tone.

3. Lidhja me (botes se brendshme shpirtore)dhe Kuranit.

Zemra e njeriut te thirrjes duhet te rregullohet sipas Kuranit. Kurani e shpjegon kete fakt ne kete menyre:

„Ky Kuran,eshte keshille per ata qe i vene veshin, i drejtojne syte dhe i hapin zemrat ndaj tij.“(Kaf ,50/37).

Vertete qe Kurani eshte keshille ,kujtese ,permendes dhe paralajmerues. Per te perfituuar nga keto ane te Kuranit eshte kushti i domosdoshem qe zamrat te jene hapur ndaj tij. Per te qene zemra e hapur duhet qe njeri te perqendrohet me sy e me veshe ne fjalet e Kuranit. Kjo eshte menyra e sakte e drejtimit te plote drejt Kuranit ne te kundert eshte e pamundur te perftohet ne masen e duhur prej tij. Njeriu qe nuk mund te ktheje shikimin ne kete drejtim nuk mund te shohe absolutisht anen plot mrekulli te Kuranit qe shkelqen plot hijeshi. Duke mos qene i afte per te dalluar kete fakt per te smbetet ndonje ndryshim mes fjales se Kuranit dhe fjaleve te tjera te njerzve. Nje njeri qe bie ne nje nivel te tille gjykimi as qe mundet te beje dicka ne emrin e Kuranit per kete arsye pas ajetit “Ska dyshime ne kete liber”,shtohet”jane te shpetuar ata qe i frikesohen Allahut” ska dyshim qe Kurani eshte fjala e Allahut. Por mund te perfitoje nga ai ne masen qe ata vete duan.

Njerzit me virtyte te larta jane ata qe njohin mire ligjin e natyrshem. Arrogantet duke mos qene me virtyte te larta smund te mendohet se mund te perfitojne nga Kurani. Pasi tashme zemra e tij ka marre fund. Ne nje ajet qendrimi i ketyre njerzve ndaaj te Derguarit te Allahut(s.a.s) permblidhet ne kete menyre.”Ata te shohin ty si njerzit e tronditur mbi te cilet ka ren hija e vdekjes”(Muhamed ,47/20). Njerzit qe kane nje kundershtrim te tille cfare mund te kuptojne nga Kurani dhe thirresi i tij i Derguari i Allahut(s.a.s)! Asgje besoj. Perkundrazi njeriu qe akordon zemren e tij sipas Kuranit mund te degjoje pulsin e universit dhe ngjarjeve qe ndodhin mbi te sikurse mund te degjoje dhe rrahjet e zemres se tij. Perse? Kjo per arsyen e vetme se ne mes tij dhe universit eshte formuar nje lidhje si nje trup i vetem. Njeriu qe smund te kontrolloje pulsin e ngjarjeve as qe mund te beje dicka ne emer te shpetimit dhe te drejtimit te njerzve ne rruge te drejte. Kjo lidhet ngushte me gjykimin e Kuranit si nje teresi e vetme.

Nese te njejtes ceshtje i afrohemi nga nje aspekt tjeter per thirresin ne fe eshte kusht paraprak qe te mos qendroje asnjenes kur shprehja objektive dhe subjektive pershtaten me ajetet Kuranore duke ndertuar nje shkalle te

larte sjelljeje. Ai duhet i suksesshem ne thirrje po aq sa duhet te jete edhe ne kete fushe. Ne te kundert me tutje si per te ashtu edhe per personat me te cilet eshte ne kontakt eshte humbje kohe. Njeriu i thirrjes duhet te jete i pajisur me cilesite me te larta te islamit duke qene gjithmone ndryshe dhe superior. Sjellshmeria,dhembshuria,disiplina dhe perkushtimi duhet te jene cilesite dhe virtytet e nevojshme te cilat duhet te kete njeriu i thirrjes. Po ta shprehim ndryshe sikurse cdo cilesie mosbesimtarit mund te mos ishte e keqe dhe cdo cilesi e besimtarit mund te mos jete e mire. Ndoshta pas sukseseve ne fushat e ndryshme te mosbesimtareve ne gjithë boten fshihet fakti se ata mund te jene te pajisur me cilesi qe ju perkasin besimtareve. Dhe sigurisht qe dhe disfatat tona mund te lidhen qe edhe ne mund te jemi ndyre ne cilesite e mosbesimtareve! Cdo besimtar duhet te tregoje rendesi te vecante te cilesive qe burojne nga te qenurit besimtar. Madje njeriu i thirrjes duhet te jete disa shkalle me para se besimtares e thjeshte ne perfaqesimin si duhet te ketyre vlerave. P.sh besimtari duhet te jete njeri i sjellshem ,i perkujdesshem dhe monument dhembshurie ndaj dhe ai permes ketyre cilesive duhet te shohe universin si shtrati i vlazerimit dhe djepi i meshirimit. Jeta e tij ne teresi eshte nje rregull dhe disipline ,per rrjedhoje cdo cast duhet ti kaloje i ndricuar dhe plot drite. Ai duhet ta vleresoje shperdorimin e kohes si humbjen me te madhe. Per myslimanete ska jete qe kalon kafeve,sepse i Derguari i Allahut as qe behet fjale te kete kaluar neper vende te tilla gjate jetes se tij. Pervet shtepise se tij me teresine e vendeve ku mund te qendroje jane xhamite ,shkollat dhe ambientet ne te cilat ai ben perpjekjen e ceshtjes se tij. Ai eshte plot dije dhe dituri. Ai eshte larg veprimeve te rastesishme duke qene gjithmone njeriu qe vepron me plan dhe program. Duhet te jete i kujdesshem ne lidhjen shkak pasoje dhe mjaft influensues ndaj botes se brendshme ,ndaj sendeve dhe objekteve. Sikurse e theksuam me siper bota perendimore e diteve te sotme duke mate cilesite e myslimaneve sot kane arritur majat e perparimit. Ndersa bota islame duke marre te gjitha cilesite e keqija te tyre eshte bere per te ardhë keq. Ndersa myslimani ka marre cilesite e tyre si nje cante pas shpine duke ardhur per ne xhami,ndersa tjetri vrapon per ne kishe me cilesite e myslimaneve. Sot nuk kemi nje triumf te perendimit por te cilesive qe kane huazuar nga myslimanet,dhe disfata e pesuar e pesuar nuk eshte e myslimaneve por e cilesive te imituara nga mosbesimtares. Nga kjo pike shpetimi yne lidhet me njesimin total tonin me Kuranin.

4. Perdorimi I rrugeve te drejta.

Njeriu I thirrjes ndersa therret njerzit ne rrugen e drejte duhet te tregoje shume kujdes ne

Perdorimin e rrugeve te pranueshme e te drejta. Per te nje objekt te drejte mund te shkojme vetem nepermjet rrugeve te drejta. Duke perdorur ajete e ndermjetesori jo te pranueshem nuk mund te arrijme ne nje objektiv te drejte. Objektivi yne eshte e drejta. Kundershtari yne eshte perendimi. Per te arritur objektivin tone te drejte nuk mund te perdorim tekniken e kundershtrimit tone, pasi ate here do te perjashtonim dhe te hidhnim poshte veten tone dhe gjithshka qe kemi bere. Asnje ceshtje smund te ngrihet mbi genjeshtren dhe nese ngrihet se ka jeten e gjate. Allahu(xh xh) ju ka prere bagetite dhe preparimin atyre qe ndjekin rruge te ngjashme per ti sherbyer islamit. Ata mund te tubojne mijera njerez shesheve dhe te mbajne fjalime por perballe turmave te tyre te medhaja ne dukje, tre ushtare te devotshem te kesaj rruge qe fjalën dhe veprimin e kane nje ,ne nje shtepi mjaft te thjeshte me thirrjen dhe qe mund ti bejne nje grupi te vogel jane edhe me te suksesshem dhe te dobishem. Njeri nga nje mije perfundon ne nje te vetem ndersa tjetri nga nje eshte i padispozuar per tu bere nje mije. Zemrat jane ne doren e Allahut(xh xh). Per ti bere njerzit te pranojne fjalën dhe kesahillat qe do thonin per te pregatitur shpetimin e tyre permes fjaleve tona eshte dicka drejt per se drejt ne doren e Allahut(xh xh). Per rrjedhoje nese qellimi yne eshte drejtimi i njerzve ne rruge te drejte ,genjeshtrat dhe mashtrimet qe do te perdoreshin ne vendet qe do te jepnin nje rezultat te dobishem do te shkaktonin pasoja te demshme. Jeni te detyruar dhe te caktuar qe detyren qe keni marre persiper ta bejne brenda kornizes qe na ka caktuar islami. Per kete aesyje ne emer te sherbimeve te islamit nuk behet fjale qe te rreshqasim ne nje mjedis jo te pranueshem. Madje sot kur e verteta dhe genjeshtra shihen ne te njejtin dyqan jemite detyruar te flasim drejt, te sillemi drejt dhe perfaqesojme te drejten pa e deformuar fare.

5. Pagesa dhe kerkesa per pagesen.

Njeriu i thirrjes kundrejt kesaj detyre te shenjte sduhet te kerkoje pagese. Pagesa qofte materiale, morale apo shpirterore lene ne hije singeritetin dhe perzemersine, dhe ne kete rast humbet dhe vlere morale e punes qe behet. Duhet te mbartet shqetesimi se thirrja seshte e singerte jo vetem kur e ben ate kundrejt nje pagese por edhe gjate kryerjes se saj kemi

ndonje kenaqesi apo lumturi morale. Nese ne kete pune futet perfitimi material singeriteti as qe permendet fare dhe ajo squhet me thirrje dhe smund te quhet e tille.

Kurani fisnik permes fjales se transmetuar nga profetet:

“Une nga ju pres ndonje shperblim ,shperblimi im i takon Zotit te boterave Allahut”(Shuara ,26/109)jep nje argument te qarte mbi kete argument.

Ne fakt ne shprehjen e Profeteve ndihet dhe ky renkim:

“Une dergjem ne nje shqetesim dhe preokupim per hir tuaj. Ndersa ju me quani te cmendur ,me shani ,me qelloni me gure dhe mundoheni te me largoni nga bashkesia. Une perpiqem te shkoj dere me dere te flas per te verteten ju perpiqeni te na perplasni deren ne fytyre. Pavarsisht te keqijave qe keni bere ndaj meje une nga ju skerkoj asgje as per kete bote dhe as per tjetren. Shperblimin tim do te ma jape i gjithëpushtetshmi qe me ka ngarkuar kete detyre. Ky eshte zeri dhe permbledhja e detyres se gjithë profeteve qe nga Hz Adem(a.s) deri te profeti Yne(s.a.s). Kur dishepujt e Hz Isait arriten ne vendin e quajtur Antakja,perfaqesuesi i shtetit te asaj kohe kerkon burgosjen e tyre. Urdhri i tij zbatohet dhe dishepujt burgosen. Kur kete histori e degjon Habib Nezhari nje person i respektuar mendimet e te cilit degjoheshin u drejtohej pergjigjeve te ketij veprimi.“Degjojini keta njerez qe jane ne ruge te drejte dhe qe skerkojne asnje pages nga ju...”(Jasin,36/21). Kurani duke na percjelle kete ngjarje te permendurr permes ketij ajeti thekson dy detyrat ose dy kushtet qe duhet te plotesoje thirresi. Nga keto e para eshte personi qe ben thirrjen para se gjithash duhet te jete ne ruge te drejte dhe i dyti eshte qe te mos kerkoje asgje nga asnjeri per detyren e thirrjes qe ben. Nga njeriu qe sfal namazin as qe mund te behet pranues apo anetare i devotshem i nje ceshtjeje te caktuar. Ai qe nuk realizon adhurimin e tij pa mangesi as qe degjohet dhe as qe mund te kete ndikim. Njeriu qe futet ne fitime te ndaluara si rrushfeti,kamata,fajdja nuk mund te behet kurre udherrefyes shpirteror. Ata qe kane nje jete te rehatshme dhe plot shpenzime duke qene se per jeten e pertejme kane vete nevojë per udhezime si mund te behen udherrefyes shpirteror dhe edukator. Ai qe nuk ka bere regullimin e kushteve te jeteses sipas atyre te caktuara nga rregullatori universal Allahu i madherueshem as qe behet fjale se ndjek rrugen plot drite te profetit dhe te shoqeve te tij. Fjalet dhe sjelljet e njerzve te tille jane genjeshtra dhe permes ketyre genjeshtrave asnje nuk mund te gjeje te verteten. Eshte e pamundur qe ai qe e ka gjetur vete te vereteten

tju mundesoje te tjereve ta gjejne ate. Njeriu i thirrjes eshte si nje tabele treguese qe tregon drejtimin e duhur. Cdo njeri qe sheh jeten dhe menyren e jeteses se tij sheh edhe gjen ne fytyren e tij misherimin dhe forcen reale te se vertetes. Me sakte duhet ta shohe dhe ta gjeje. Kurani eshte burim shpetimi per ata qe i shkojne pas. Jeta e nje njeriu qe smund te futet ne kornizen e percaktuar nga Kurani si mund te perfitojne nga ky burim shpetimi? Shpetimi i vertete eshte ne rrugen e vertete te percaktuar nga Kurani. Ai qe seshte ne rruge te drejte smund te shpetoje. Eshte nje kundershiti e madhe nese ata mundohen te jene udherrefyes ne kete rruge drejte shpetimit. Udherrefyesit dhe edukatoret shpirtore ne rrugen e profeteve duke realizuar kete detyre qe u eshte caktuar profeteve duhet te bejme sikurse dhe kane bere dhe profetet. Thirrresi i diteve te sotme duhet ti kushtoje me shume vemendje fjaleve te nje udherrefyesi shpirtoror ,intelektual,i mendjes pasardhese ,i shpirtit qe thote:“Mosbesimtaret i vene ne prove dijetaret permes argumentave shkencor i sulmojne pameshirshem ata ,se gjoja ata e kane pervetesuar dijen dhe fene. Ata duhen hedhur poshte permes fakteve.“ Te apasionuar pas kesaj bote duhet te binden ne kete ceshtje permes fakteve ne te kundert do te ishte vetem nje bisede e kote as qe ka ndonje perfitim.

Ne siperfaqen e tokes gjithmone duhet te gjendet nje formacion te devotshmish qe do ti vene shpatullat sherbimit ne fene islame,dhe ky grupim besnikesh qe ekziston per lumturine njerzore duhet ti jape besimin e duhur njerzimit se si duhet te jete thirrresi ne fene islame. Ky formacion duhet te jete aq modest sa pasuria e tyre pas vdekjes te mjaftoje vetem per qefen,madje ndonjehere edhe per te ,te mos jete e mjaftueshme. Ky eshte formacioni qe zbukuron imagjinen time dhe keta jane sherbetoret e ketij misioni madheshtor.

Ky popull kapare e ka degjuar shume deri tani qe jane munduar te bejne dialektiken e te jetuarit te islamit. Me ato gjera qe jane pare tek ata shume here ka ndryshuar bursin duke u perthyer. Besoj se ska mbetur me durim per tu mashtruar edhe me. Tashme duhen pare mire jo fjalet e bukura po sa nga ato fjale vihen ne jete. Nese veprimet mbeshtesin ato qe thuhet duhet te mbeshtetet dhete shkohet nga pas atij njeriu. Ne te kundert ai sduhet degjuar dhe respektuar.

Do doja ta zgjeroja edhe pak kete ceshtje nese me lejoni. Besoj se nuk i pranoni se ju perkasin juve dhe si respektoni ata qe koka te kembet nuk jetojne jeten tuaj. Besimi i plote dhe lidhja pasatyre qe kane devijuar eshte

dicka qe nuk shkon ne te qenurit besimtar. Nese doni te lidheni me dike para se gjithash shikoni menyren e jeteses se tij. Eshte normale dhe mese e drejte nese shkoni pas dikujt qe kalon nje menyre te jetuari mjaft modeste dhe te varfer por qe veprimet vertetojne ato qe ai thote. Megjithate seshte plotesisht e drejte te shkohet pas dikujt pa bere nje analize te tille,kjo mund te vertetohet nga shume shembuj qe kane ndodhur ne histori. Nga kjo pike duhet te ndiqen personat qe nuk kane shume fjale te bukura por qe kane sjellje te ngjashme me ate te Hz Muhamedit(s.a.s). Personat qe mbeten vetem pas paraqitjes se jashtme dhe qe vleresojne ne teper formalitetet pervecse i kane shkaktuar nje humbje te madhe sherbimit te fese islame nuk kane bere dicka tjeter.Nga ana shpirterore ata jane shume larg nesh dhe ne duhet te qendrojme shum larg tyre. Vecanarisht personat qe jane te implikuar diku duke patur detyrime ndaj nje vendi te caktuar nuk mund tju tregojne dicka njerzore ndaj te cilave kane detyrime . Per kete arsye figurat e larta te historise islame si Ebu Hanife,Leja b.Sad,imam Sevri,Fudjal b.ijaz,Ibrahim b.Ethem e te tjere jan e treguar mjaft te kujdesshem ne kete aspekt. Per te njeten arsye keta njerez te shquar ne fjalet dhe thenjet e tyre kane rezistuar shkujve duke ardhur deri ne ditet tona duke qene mjaft efektiv ne thirrjen e tyre. “sa jetegjate eshte ajo epoke qe ka mundur te rrise ne gjirin e saj personalitete te tilla qe kane ndricuar boten me njohurite e tyre.”

p.sh Sufjani Sevri ishte mjaft i mezitur dhe i deshperuar. Kur e pyesin shkaku e merzitjes se tij jep kete pergjigje:

“ U mora me kaq shume persona duke iu mesuar atyre hadithin,histori islame(fikeh)dhe interpretimin(tefsir). Por pashe qe shumica e tyre arriten poste te larta ne administraten shteterore si gjykates etj. Kjo gjendje me shqeteson se tepermi. Kam frike se ditën e gjykimit do te jap llogari edhe une per veprimet e tyre.”

Letra e Sufjan Sevrut drejtuar sundimtarit(halifit) Harun Rashitit eshte shembull i larte sjelljeje. Harun Rashiti behet sundimtar(halife). Pret mbeshtetjen e shokut dhe mikut te vjeter Sufjanit. Sigurisht eshte e drejta e tij per hir te asaj shoqerie dhe miqesie qe kane pasur. Por Sufjani nuk mendon si ai. Ne nje kohe Harun Rashiti nuk i durohet me por merr e shkruan nje leter plot qortim e ankese Sufjan Sevrut ku i thote: Te gjithë erdhen dhe shfaqen perkrahjen e tyre. Por une pres qe te vish ti.”Sufjani nuk e hap vete letren qe i vjen por por ja jep ta lexoje nje nga nxenesit e tij duke shtuar: Sdua as ta prek me dore letren e ketij tirani. Pastaj pergjigjen ua jep tashkruajne ne anen tjeter te se njejtes leter. Nxenesi i tij kundërshton

se nuk ishte e pershtatshme tja shkruanin pergjigjen sundimtarit te vendit ne nje leter te tille por nga ky njeri i larte merr kete pergjigje.”Ne qofte se kjo leter eshte marre nga pasuria e shtetit dhe ne ja kthejme shtetit. Neqofte se kjo leter eshte marre nga pasuria e tij une skam para per te shpenzuar me te...”

Pastaj dikton keto fjale:

“Harun ,u bere sundimtar (halife). Shperndave parate e popullit sa majtas djathtas. Mua po me therret si deshmitar te kesaj pune. Mos harro se nje dite do te dalesh para Zotit dhe do te japesh llogari pe te gjitha...! dhe fillon e i shkruan gjere e gjate keshilla te ndryshme. Vazhdimin e kesaj historie na e tregon nje nga personat qe ndodhej ne pallatin e Harun Rashitit.

Harun Rashiti mori dhe e lexoi letren dhe filloi te qante me denese. Pas cdo namazi(faljeje) kerkonte tja sillnin letren dhe tja lexonin dhe pas kesaj shtonte:”Ne dite te tilla do doja te kisha nje mik si ti. Atehere do te kisha shpetuar nga devijimet dhe nga rreshqitjet nga rruge e drejte...!

Valle cishte ajo force qe i jepte kurajen Sufjanit qe ti drejtohej me nje gjuhe te tille sundimtarit te vendit? Kjo force lidhej me faktin se ai ishte shkeputur dhe i kishte kapercyer problemet qe lidheshin me jeten ne kete bote. Neqofte se ai do te ishte dhene shume pas kesaj bote sdo te mund te fliste ne kete menyre me sundimtarin. Harun Rashidi ishte nje person qe falte pese kohet e faljes ,kryente peligrinazhin dhe agjeronte shtese,ishte i sjellshem dhe mjaft i ndjeshem. Perballe disa veprimeve te gabuara nje mik i tij i vjeter i terhiqte vemendjen duke e qortuar ne kete menyre.

Ketu dua te ndalem pak dhe brezave nga te cilet presin shpetim te mbare njerzimit dua tju jap nje keshille te paren dhe te fundit. ‘Behuni te vyer dhe me nder. Mos bini pre e pushteteve dhe fuqive te ndryshme. Nese ne emerte ketij sherbimi jeni futur ne mesin e tyre veproni me kujdes. Ne emrin e perhapjes te se vertetes mos ndikoheni nga kushtet dhe kuptimet e te tjereve! Parimet qe ka vendosur Allahu jane dhe me te rendesishme. Ju behuni vetem rob te tij. Nese veproni ne kete menyre fjalet tuaja do te kene dhe me shume ndikim dhe gjerat qe ju propagandoni do te gjejne pranim.”

Forcen per te ndikuar fjaleve tuaja jua ka dhene Allahu i madherueshem. Mos prisni ndonje shperblim nga te tjeret per vecse prej Allahut. Si do ta merrni? Ashtu sikurse ne kete bote fjalet tuaja do te kene ndikimin e tyre ne jeten e pertejme do te shperbleheni me parajsen dhe bukurite e tjera hyjnore.

Nese nuk veproni keshtu por prisni ndonje shperblim nga njerzit para se gjithash fjalet tuaja humbasin ndikimin dhe pastaj privohen nga miresia me e madhe.

Pozita dhe posti ne kete bote eshte e perkohshme. Sja vlen as te lidhesh pas tyre dhe as te mburresh me to. Punonjesit e sherbimeve fetare sot lejohen qe te shperblehen brenda rrethit te nevojave. Nje nepunes i sotem nese e perdor rrogen per nevojat e tija dhete familjes nuk duhet te lere trashegimi nga ajo para. Pasi ne rrogen qe ai merr jane perfshire shume gjera problematike. Ky fakt qe them thuhet per kushtet ne te cilat jetojme. Shpresojme qe nje ditet te ndryshojne kushtet jetesore ne teresi dhe secili te gjeje rrugene fitimit te lejuar.

Ne sot jemi te vendosur qe te braktisim poziten dhe postin ne kete bote dhe tjetren qe te realizojme thirrjen sikurse duhet. Per tju treguar dhjete vetave dicka ne emer te se vertetes do te braktisim dhe te qenurit deputet dhe cdo post tjetet. Kjo pasi gjeja me thelbesore eshte paralajmerimi dhe shpetimi i njerzve. Asnje post apo pozite ne kete bote apo tjetern smund te dale para kesaj pune.

Eshte cmenduri qe te perdoresh sherbimet fetare per interesat e kesaj bote, perdorimin ne kete jete te pasurise qe arrihet permes transmetimit te se drejtes dhe te vertetes,dhe te nderrosh me copa xhami floririn apo smeraldin e kesaj pune. Sipas nje hadithi(transmetimi) te dobet lajmerohet se ne kohen e Hz Musa(a.s) nje njeri qe vepronte ne kete menyre eshte shenderruar ne derr. Ndonese ai ne cdo vend fliste per Hz Musane(a.s)dhe madheshtine e tij duke perdorur kete fakt per interesat vetjake u shenderrua nga Allahu(xh xh) ne kafshen me te ulet. Shenderrimi ne kafshe eshte ngritur per kete bashkesi. Per kete aspekt Allahu(xh xh) ka dhene garanci per te zgjedhurit e tij. Por ne aspektin shpirteror shume persona kane patur fatin me te keq sesa ai. Lutja per Zotin tone eshte qe neve dhe te gjithë ata qe propagandojne fene ti ruaje dhe ti mbroje nga nje perfundim i tille. Ai eshte i gjithëpushtetshmi qe i pranon dhe u pergjigjet lutjeve.

6. Te kuptuarit dhe te njohurit e degjuesit

a) Njohja e degjuesit.

Njeriu i thirrjes duhet ta ndjeke nga afer gjendjen e personit tjetet dhe te kete mirekuptim ndaj gabimeve te tija. Perballe besimtareve duhet te tregojme mirekuptim dhe tolerance ndersa ndaj mosbesimtareve dhe idhujtareve duhet te jete i durueshem ,i vazhdueshem dhe sqarues. Permes

ketyre ai duhette depertoje ne mendjen dhe zemren e personit dhe nga njera ane duhet ta beje ta pelqejeajo qe i tregon dhe nga ana tjeter duhet ta binde ate.

Personat qe marrin persiper nje mision te tille duhet te njohin mire gjendjen e personave me te cilet eshte ne kontakt ,dhe te largohen nga sjelljet qe mund ti largojne ,merzisin apoi besdisin. Gjerat qe ai probagandon jane gjera te shenjta. Personi qe gjendet ne nje pozicion qe ti beje njerzit qe te pelqejne Allahun,te Derguarin e tij,librin e shenjte dhe ditën e gjykimit duhet ta njohe mire detyren e tij dhe sjelljen qe ka ta pershtate me detyren qe ka. Nese degjuesi ndjen ndonje shqetesim nga personi qe i flet per besim(Zoti e ruajte)mundte merzitet dhe te urroje dhe ceshtjen per te cilen ky person i flet. Nje veprim i tille ka pasoja te medhaja. Nese shkaku kryesore i nje veprimi te tille lidhet me personalitetin tone do te jemi ne pergjegjesit kryesore qe do te japim llogari.

Shihni sesi i Derguari i Allahut([s.a.s](#)) per te mos futur ndjenjen e fajesise vepronte per ti keshilluar ata. Ai asnjehe qofte mosbesimtarit qofte dikuj tjeter nuk i drejtohej si nje fajtor por cdo gje e thoshte duke iu drejtuar te gjithëve. Brenda bashkesise per mangesite e vogla qofte edhe me detaje dilte para te gjithëve dhe jepte keshilla per te gjithë. Te mundohemi te paraqesim nja dy shembuj:

Nje sahab qe ndodhej diku prane te Derguart te Allahut([s.a.s](#)) po lutej duke hapur duart dhe duke ngritur zerin me sa fuqi qe kishte. Ky ishte nje veprim ne kundërshtim me rregullat e lutjes. I Derguari i Allahut([s.a.s](#)) ne vend qe ta thirrte ate njeri vetem e ta keshilonte mori fjalen duke iu drejtuar te gjithë te pranishmeve.

“O njerëz! Ju nuk po i beni lutje nje shurdh memeci. Kini meshire per veten dhe zbatoni rregullat e lutjes. Ju i drejtoheni me lutjen tuaj atij qe eshte meprane jush se cdo gje tjeter dhe ai ju degjon dhe jua pranon lutjen.

Ne nje rast tjeter njerzit kishin ardhur te ankoreshin te Profeti se imami(drejtuesi fetar) e zgjaste shume faljen(namazin). Ne mes tyre kishte edhe prej atyre qe thoshin “O i Derguar i Allahut! Per pak do ta braktisnim grumbullin e njerzve qe faleshin(xhematin). Dihej se kush ishte drejtuesi fetar(imami). I Derguari i Allahut([s.a.s](#)) u merzit shume per kete gje. Pavarsisht nga kjo ai nuk e thirri personin ne fjale e ta qortonte por aty ne xhami para te gjithëve drejtohej me nje keshille te tille te pergjithshme:

“O njerez! Cfare keni qe i beni njerzit te urrejne. Kushdo qofte imami nga ju le ta fale namazin lehte,sepse aty mund te kete te moshuar,te dobet dhe njerez qe kane nevoja personale.”

Ja pra qendrimi i te Derguart te Allahut([s.a.s](#))perballe gabimeve. Ai perpiquej per shpetimin e njerzve dhe cdo ceshtje e shpjegonte ne rrugen me te drejte dhe me praktike.

“O njerez! Dëshmoni se ka nje Zot dhe shpetoni “ thoshte pasi dhe qellimi kryesor i tij ishte qe ti thirrte njerezit ne besimin ne nje Zot.

Eshte veprim i gabuar qe te mundohesh qe tu tregosh njerzve duke ngjallur tek ata ndjenjen e fajesise ne rrugen e besimit dhe thirrjes ne islam. Gjerat duhet te thuhen duke iu drejtuar te gjithëve. Ashtu sikurse cdo njeri perfiton nga ngrohëtesi diellore sa ka nevojë edhe nga keto fjale mjaft jetesore cdo njeri perfiton sa mundet dhe sa ka nevojë. Ne te kundert largesite qe krijohen eshte e veshtire te mbyllen.

b) Te shmangët debati.

Eshte e nevojshme qe me degjuesin te realizohet nje bisede nje me nje dhe te tregohet kujdes qe biseda te mos kaloje ne debat. Nese bisedohet duke arritur ne debat ne vend qe te flitet per te verteten kalojme ne gjera personale dhe larg asaj qe duhet. Ne nje mjedis te tille kalohet nga e drejta ne te gabuaren dhe djallezoren. Ne kete rast sado me ndikim dhe te pranueshme te jene gjerat qe do themi degjuesias qe do ndikohet fare dhe per rrjedhoje sdo ti pranoje ato qe themi. Nese ceshtja shihet nga ana psikologjike sdo ti pranoje ato qe thoni. Nese ceshtja shihet nga ana psikologjike del se debati eshte gjithmone i panevojshem dhe pavend. Kur ne pergatitemi te futemi ne nje debat duke zgjedhur fakte ,argumente dhe mendime qe ta mposhtin kundërshtarin dhe degjuesi po aq sa ne do te beje pergatitjen e tij. Te dyja palet do sjellin argumente te tilla qe do ta fusin biseden nje rreth vicioz dhe nese bisedohet per dite me rradhe nuk do te arrihet ndonje rezultat konkret.

Ne fakt ne Epoken e Lumtur(Epoka e Profetit dhe e shokeve te tij) Profeti([s.a.s](#)) eshte futur veteme nja dy here per te bindur degjuesit. Duhet te tregohet kujdes qe ne situata te tilla kerkesa te vije nga pala tjeter. Ne nje rast te tille as qe mund te behej fjale qe Profeti([s.a.s](#)) te heshte ,mund te tronditej forca morale e pasuesve te tij. Me kete shumica e atyre qe kane ardhur te i Derguari i Allahut([s.a.s](#)) me qellim per debat serish sjane bindur

por jane futur ne medyshje e cila nuk ben qe degjuesi te gjeje rrugen e drejte.

Profeti yne([s.a.s](#))per vite me rradhe eshte gjendur perballe dijetareve cifute por ne nje mjedis te tille debati asnjeri prej tyre ska gjetur rrugen e drejte. Dhe ai ishte Profeti per te cilin ishte krijuar universi dhe mbare frymezimi i botes rridhte ne zemren e tij ne formen e ujevarave.

Ai ishte i paisur me mrekulli dhe mund te bente gjera te jashtezakonshme. Ne nje menyre apo tjetren ata qe futeshin ne debat nuk mund te terhiqeshin ne rrugen e drejte por vetem tek ata shkaktohej nje medyshje. Abdullah b.Selam ishte nje cifut dhe vinte te i Derguari i Allahut([s.a.s](#)) per te pranuar te verteten e kalonte neper mendje:”Neqofte se ky eshte Profeti qe permendet ne Bibël do ta pranoj dhe do ti bindem menjehere. Sapo sheh Profetin nuk sheh asgje te genjeshtert apo fallco dhe ishte futur ne rrugen e besimit.

Vecanarisht nuk mund te mendohet pelqimi i Allahut te madherueshem ne thirrjet qe behen ne nje atmosfere debati. Sepse te dy personat qe perfshihen ne nje debat te tille ,futen nen ndikimin e egos dhe te mendimeve te tyre personale. Ne nje atmosfere ku smund te mos jete pelqimi i Allahut cfared qe te bisedohet sdo te pranohet. Duke qene se gjetja e rruges se drejte eshte ne doren e Allahut aty ku seshte aprovimi dhe pelqimi as qe diskutohet te aprovohet dhe kuptohet e drejta dhe verteta.

c) Te shmanget egoizmi

egoizmi dhe uni si per personin qe ben thirrjen si dhe per ate qe degjon eshte nje faktor pengues per te qene i suksesshem dhe i pranueshem. Per kete arsye cdo besimtar dhe cdo pasues i nje rryme fetare(myrshit) duhet te largohet nga keto veti te demshme dhe gjerat qe do te percjelle ti shprehe me modesti. Modestia do ta beje degjuesin qe te heqe dore nga inati dhe kryenecesia. Seshte e mire per asnje njeri qe te jete egoist dhete kete teorine e unit. Eshte pare shume here qe thirresi mund te mos kete ndikuar asnje njeri megjithese eshte munduar te perdore gjithë aftesite bindese,zgjuarsine,dijen,logjiken dhe elokuencen e te folurit dhe duke mbajtur dhe fjalime spektakulare dhe mahnitese,ne rastet kur eshte i ndrojtur per te thene dy fjale mund te jete ndikues ne menyre te paimagjinueshme duke mundur te shpetoje duke kthyer nje pjese te njerzve ne rruge te drejte.

d) Te njihet mire struktura e te menduarit te degjuesit.

Nuk mund te kalohej nje aspekt qe ketu mund te llogaritet si nje imtesi. Personat qe ftojne te tjeret ne besim duhet te kene kujdes ne lidhje me sistemin e te menduarit dhe te logjikuarit te degjuesit. Nese e shqyrtojme ceshtjen ne nje aspekt me te vecante ,eshte fakt prania e shume xhamateve(bashkesive) ne islam. Te evidentuarit e ketij fakti eshte dicka tjeter dhete pranosh ekzistencen eshte dicka tjeter. Te mos pranuarit e dickaje qe eshte edhe te besh sikur se sheh nuk jep ndonje rrugezgjidhje. Ndjekesit dhe pasuesit e islamit sduhet te harrojne se degjuesit dhe njerzit qe jane ne kontakt me ta mund ti perkasin nje sekti apo xhemati(grupimi fetar) ndaj kur te flase nuk duhet ti harroje keto gjera. Asnjehere sdueht te futet ne biseda qe mohojne ,percmojne dhe ofendojne nje xhemat(bashkesi fetare). Cdo xhemat dhe meshep duke pranuar drejtesine dhe bukurinee rruges qe ndjek ne anen tjeter duhet te fitoje nje kulture tolerante qe pranon dhe jetesen e grupimeve te tjera. Ne te kundert Allahu nuk eshte i kenaqur dhe pa pelqimin e tij cdo gje qe behet sdo te jete e frytshme.

Secili myrshit(pasues i nje rryme fetare)duhet te mesojte te jete i respektueshem ndaj xhamateve te tjera duke treguar respekt ndaj kultures se degjuesit ,dhe fjalet qe thote duhet te jene te pranueshme nga te gjitha pa perjashtim. Allahu(xh xh) nuk pelqen dhe seshte i kenaqur ndaj atyre qe kane sjellje jo te mire ndaj atyre karshi atyre qe thone Allah,ata qe qortojne dhe kritikojne besimtarete,me ata qe vetem per nje fjale nderpresin kontaktin.

Krijimi i kontaktit me cdo njeri eshte i lidhur me Zotin tregon nivelin e lidhjes se ketij njeriu me Allahun e madherueshem. Eshte e rendesisheme ndertimi i lidhjes me degjuesit ne raportin qe keta te fundit kene me Zotin e vertete. Personat pergjigjes ne kete pune duhet te kene kujdes ne kete aspekt me teper se cdo njeri tjeter dhe te mos i ftoje njerzit ne rrugen fetare qe ndjekin por drejtpersedrejti ne rrugen e islamit. Zhvillimi i ketij botekuptimi te tille eshte faktori kryesor qe do ti bashkoje te gjitha rrymat dhe deget ne nje trup te vetem.

Te kuptuarit e degjuesit ne nje prizem lidhet me perceptimin dhe njohjen e kultures dhe nivelin shoqeror te tij. Kjo eshte mjaft e rendesishemene lidhje me metoden e thirrjes. Thirrja dhe udhezimi ne rruge te drejte eshte nje detyre dhe njohja e metodes me te mire per ti realizuar ato eshte nje detyre tjeter. Psh nese perballe nje armiku qe ju sulmon me pushke e artileri rezistoni me nje cope druri ndoshta vertete keni bere nje akt heroik por duke mos perdorur tekniken moderne ju do te humbisni luften e sdo mund te jeni te suksesshem. Do te ishte dhe me keq nese nje dalje e

tille do te demtonte te gjithë frontin islam. Sikurse e theksuam mete madhe dhe me larte njohja e metodes dhe teknikes se thirrjes eshte nje nga kushtet qe smund te lihet pas dore madje dheme primari. Duhet te pranojme se aq sa i besojme nevojës për thirrje duhet te dime qe ajo eshte nje pune sipas nje metode te caktuar. Nese fjalet qe themi jane me poshte apo me larte se se niveli kulturor i degjuesit veprimi yne sd ote jete i pershtatshem dhe aspak i dobishem dhe i frytshem. Nje njeriu qe endet ne nje ateizem dhe mosbesim te plote gjeja e pare nga e cila do te fillohet ti flitet sdo te jete namazi i nates. Atij duhet ti flitet per parimet e besimit madje ne menyren me te pershtatshme per te kutuarit e tij. Ne ditet e sotme ku mosbesimi shfaqet permes shkences dhe dijes dhe shpjegimi i dueht bere ne nje menyre sa me shkencore.

Te shohesh se cfare gabimesh behen ndaj percaktimit dhe kurimit te gabuar te semundjes se mosbesimit dhe mohimit. Brezi i sotem eshte frikesuar dhe larguar duke u marre me paraqitjen e jashtme pantallonat dhe xhaketen qe ka hedhur supeve ne emer te rregullit te zemrave te tyre. Duke qene se gabimet e bera ne rrugen e thirrjes cojne ne humbjen e jetes se pertejme te njerzve mendoj se mbi kete aspekt duhet ndaluar me insistim.

Njeriut perballe jush qe ju flet rreth shkences dhe dijes ju smud ti pergjigjeni duke i lexuar libra rreth fese(psh ilmiha)jo per te ulur keto libra por per te treguar se veprimi juaj seshte ne vendin e duhur. Nese ai mohon jeten e pertejme ju smund ti flisni rreth legjendave te njerzve fetare(evlijave).

Njeriu seshte nje qenje e formuar vetem nga ndjesite dhe ndjenjat dhe me gjera te tilla ju mund te ndikoni te ai. Njeriu pervec ndjenjave dhe ndjesive ne te njeten kohe mbart dhe logjiken ,dhe permes gjerave logjike eshte mjaft me vlere bindja e tij. Sadetin Taftazani kur flet rreth besimit thote: “ Ti do ti flasesh me faktet e tija dhe Zoti do te ndeze driten e besimit ne shpirtin e tij. Ja pra ky eshte besim.” Nje besim i tille do ta drejtoje personin te kryeje pune te mira dhe te jetoje fene si nje teresi. Personi qe futet ne besim permes ndjenjave te tija ne nje epoke ku ndjenjat vete triumfojne eshte brenda mundesise qe te dale nga besimi.

Kurani Fisnik permend shume fakte rreth shkences dhe teknikes permes qindra ajeteve,por Kurani nuk eshte liber fizike apo kimie. Duke qene se perparimi shoqeror ka nevojë per keto dy shkenca ,Kurani permes disa fakteve nxit pasuesit e tij te merren me keto shkenca. Njeriu qe ska idene rreth astronomise dhe ska lexuar as edhe nje rresht ne biologji seshte e mundur te kuptoje ne masen e duhur te shume ajeteve Kuranore,sepse

ka shume ajete qe per ti kuptuar si duhet lidhet pak me njohjen e ketyre shkencave. Pa e zgjatur fjalen per te permendur te gjitha deget e shkences le te kuptojme kete fakt dhe le te kalojme me tutje. Besimtaret e sotem edhe nese jane vete enciklopedi duhet te ndjekin shkencen dhe tekniken e shekullit tone. Pasi ne te kundert deshira per nje progres qe do te perfshinte te gjitha sd o te arrihej dhe do te mbetej vetem nje fjalim a perpjekje e vecuar.

e) Njohja e kultures se epokes.

Sot gjendja e secili qofte i ri apo i moshuar eshte per te ardhur keq por kjo gjendje ne nje fare mase buron edhe nga paaftesia dhe pamundshmeria e atyre qe kane dale ne emer te progresit dhe perparimit. Seshte e mundur ti tregosh dicka nje njeriu nese nuk njeh kulturen,botekuptimin dhe stilin e epokes qe ai njeh. Sduhet menduar se meqense qenka e demshme shpjegimi i dickaje pa u ditur mire mes aq gjerave qe duhen mesuar ,atehere valle a na del detyre neve te urdherojme gjerate e mira dhe te ndalojme gjerat e gabuara? Nese per ta cuar kete brez perpara do te duhej te udhetohej drejte yjeve dhe te nevojiteshin te silleshin qe andej gjerat qe te shpjegoreshin ne lidhje me progresin do ishte obligimi me i madh te shkohej gjer atje dhe tju paraqitej nevojtareve ato qe do silleshin. Brezin tone e goditen permes fizikes ,e gjynjhezuan me ane te kimise dhe permes astronomise ja leshuan yjet mbi koke,atehere dheti perballe nje situate te tille smund te qendrosh duar lidhur. Duke perdorur te njejtat fakte duhet ta kapeshe prej dore e ta ngresh ne kembe,te mjekosh plaget materiale e morale duke patur si borxh ngritjen dhe lartesimin e tij per te mos u rrezuar dhe nje here,per te mos u penguar dhe shtypur duke u marre neper kembe. Ne univers cdo ngjarje dhe objekt eshte nje gjuhe dhe nje dege. Ata qe e besojne Allahun(xh xh) duhet ta njohin kete gjuhe dhe te kapen mire pas atyre degeve. Ne te kundert eshte e pamundur kuptimi i ligjeve natyrore. Popujt dhe individet qe nuk kuptojne keto ligje jane te destinuar te mbeten ne prapambetje dhe injorance. Dhe Kuarani fisnik ne mes te ajeteve te tija komentimin e ketyre ajeteve ben. Njeriu qe mbyll veshtet ndaj ketyre fakteve dhe sikur cdo dite te lexoje Kuran nga kreu gjer ne fund smund te thuhet qe arrin ta lexoje kuotimin e vertete. Kurani dhe te gjitha ajetet e tij u derguan qe njerzit te arsyetojne dhe logjikojne. Ai qe pretendon sse ndjek ate duhet ta pranoje keshtu kete fakt.

Sado qe keto te verteta jane te shenjta dhe te cmuara eshte e dyshimte ndikimi i nje udhezimi i bere jo ne botekuptimin ,mentalitetin dhe stilin e diteve te sotme. Prezantimi i Kuranit dhe i fese si i nje sere ceshtjeve misterioze te mbuluara ne penden e te paqartes dhe te pamundura per te kaluar permes rrjetes se mendimit,gjykimit,dhe arsyes sherben vetem per te corientuar koken e brezit dhe per te rritur mosbesimin e ateistëve. Ka vite qe na kalon para syve nje tablo e tille qe rrenqeth shpirtin dhe na ben pesimista.

Sahabet ishin edhe me larte se kultura e kohes qe jetonin. Degjuesve mund tua shpjegonin ceshtjen e besimit dhe fese ne pershtatshtje me nivelin kulturor te kohes. Edhe figura te larta qe erdhen me vone ishin te tille. Psh perballe gjerave qe tregonte imam Gazali qe llogaritet si udherrefyesi(myxhedidi) i shekullit,njerzit e atyre diteve mahniteshin. Kjo mahnitje dhe habi vazhdon per shekuj me rradhe. Jane mbrese lenese opinionet rreth tij te perendimoreve si Gibb dhe Renan:”Ne nuk gjetem njeri tjeter qe te zoteronte kulturen e kohes sa Gazali”. Figura te tjera te larta qe kishin celur si lule debore ne shekujt e tyre ,te tille si ,imam Rabbani,Mevlana,halid Bagdati ishin paisur me kulture dhe dituri qe kalonin shekujt e tyre duke marshuar na pararoje te epokave te tyre. Permbledhjet dhe prezantimet e fese ishin ne nivelin e emrit te tyre. Per kete arsye gjerat qe thonin zinin vend ne zemrat e njerzve dhe gjenin mbeshtetje te gjere e te pergjithshme.

f) Myrshiti(udheheqesi shpirteror)duhet te jete elastik.

Ne menyre te vecante udheheqesi shpirteror duhet te ruaje elasticitetin e tij,pasi ndonjehere do i duhet te zbrese ne fundin e humnerave e ndonje here do i duhet te dale majen e minareve. Sepse ne mes te degjuesve te tij ka njerez qe jane ne mes te ketyre skajeve. Duhet te kete nje diapazon mjaft te gjere kulturore ,nese sjane te tille ata sjane udheheqes shpirteror per nje grup fatkeqesh qe pengojne rrugen e shpetimit te progresit. Sduhet tju dalin para njerzve ,tju hapin rrugen dhe te mos ju bejne hije me qellim qe udheheqesit e vertete shpirteror te vijne e ti zgjasin doren ketij brezi qe eshte bere per ti qare hallin.

Nje figure e larte mjaft e shqetesuar dhe me nje shpirt te pervuajtur shprehet keshtu:”Perballe mosbesimit te nje te riu ,zemra e nje besimtari

duhet te copetohet ne pjese sa qelizat e trupit te ij". Ja nje zemer e pervuajtur. njerzit qe nuk ndejne te njetin shqetesim perballe formimit te nje brezi pa besim smund te kene kurre ndonje merite ne thirrje dhe perparim. Udhëheqesi shpirtëror nje kohen e tij por ne te njejtën kohe është person qe mund te zgjidhe cdo ceshtje te kesaj bote. Madje dhe nese duhet te haroje perkohesisht dhe parajsen dhe te jete i vetedijshem qe te beje me nje botekuptim dhe mentalitet te tille cdo detyre qe lidhet me boten e tij personale. Duhet te jete i tille qe te fitoje mbeshtetjen e Allahut dhe te mund te binde njerzit qe e rrethojne.

Me pare patem theksuar se cfare jane te nevojshme te dihen nga degjuesi. Kjo është edhe nje nga detyrat me te cilat është ngarkuar dhe njeriu i thirrjes. Po te ngrihesh te kurosh nje semundje pa e percaktuar ate sikurse është nje veprim i gabuar, ne te njejtën menyre është kurimi i degjuesit pa evidentuar shqetesimin kryesor te tij, ndoshta ky i fundit është dhe veprim me katastrofik. Sdi a është e nevojshme te tregohet se cdo ilac nuk qeteson cdo dhimbje?

Nje pjese prej tyre i njoh, keta flasin vetem rreth rendesise se industrise se rende , investimeve te ndryshme , ekonomise dhe zhvillimit bujqesor duke u fiksuar vetem pas fabrikave dhe shpetimit te njerzimit e shohin vetem ne kete aspekt. Edhe sikur keto mendime te hidheshin ne emer te islamit vecse do te mbeteshin kopjuesit e Marksit dhe Engelsit , sdo te shkonin me tutje. Ne ditet tona kur shihet deshtimi total duke mos i mbetur as edhe nje pasues i vetem i ketyre mendimeve qe skane ruajtur as veten , si mundet qe mendimet se mund te jene kopjim i tyre ti japin jete njerzimit dhe si mundet qe njerzimit qe kane sado pak logjike te ngrene nje pretendim te tille duke i futur pasuesit e tyre ne nje aventure pa koke. Te pranuarit e nje filozofie deshtake me duket si shume e pagoditur. Kurren e kurren sdo tja dilnin mbane te krijoni nje qyteterim permes fabrikave qe keni ngritur dhe qe do te ngrini nese nuk perkujdeseni per brezat ne planin shpirtëror, nese nuk i paisni ata me kuptimin e jetes se pertejme dhe se pergatisni me jomaterien , dhe cdo perpjekje ne kete drejtim sdo te vleje per asgje. Nese keta breza te pagdhendur nuk disiplinohen , keto turma nuk ngopen nga ana shpirtërore as qe mund te ngopen me ndonje teori luksi apo fantastike. Eshte fataliteti me i madh pretendimi se problemeve shpirtërore qe kane brezat mund tju gjindet nje zgjidhje ekonomike.

Sot e gjithë bota islame duke humbur aftesine e komunikimit permes gjuhes se teknikes se kohes ka rene nga vendi nga ku mund te fliste. Eshte

ne gjendjen e te degjuarit por e te degjuarit pa folur. Te pakten te mund te zbatonte gjerat qe degjon ,te mblidhte veten nje dite do tem und te kalonte ne rolin e nje udheheqesi qe flet dhe qe I degjojne fjalenm sa keq qe nuk arriti te behet as nje degjues me merite. Kjo tablo e keqe ne planin e pergjithshem eshte pasqyruar edhe ne planin individual dhe formimin e vecante. Dhe vete ata rane net e njeten gjendje te pafuqishme sa dhe vete degjuesit e tyre. Ne fakt ne kemi shpalljen mrekullore te Kuranit qe meriton ti drejtohet njerzimit dhe te sfidoje te gjithë universin. Ne duart tona kemi dhe synetin(veprimet praktike) te pavdekshme te Derguarit te Allahut(s.a.s) si shpjegimi dhe sqarimi me I bukur I Kuranit. Sa e dhimbshme eshte qe deri me sot nuk aritem te perfitojme sa duhet prej tyre. As qe mundem te zhytemi me koke e zemer ne oqeanin mistik Kuranor. Ndaj dhe Kurani e Syneti smunden te na thone ndonje fjale neve. Per sa kohe qe vazhdojme kete gjendje do te vazhdoje dhe heshtja e tyre dhe Myslimanet as qe do mund te dalin nga kaosi brenda te cilit gjenden.

Bota po ndryshon ,shkenca dhe teknika po perparojne me shpejtesi marramandese. Por thenjet e nje pjese nuk pershtaten me normat e nje bote qe po perparon ,kane ngecur tre shekuj me pare duke qene shume larg per ti folur brezit te sotem. Ne keto kushte ska kush ti vere veshin gjerave qe themi.

g) Te shihet nga prespektiva e kohes.

Udheheqesit shpirteror dhe kujdestaret fetar ti shpjegojne gjerat duke pare nga prespektiva e kohes. Duhet te zoteroje anen shpirterore te degjuesve por ne te njejten kohe te njohe dhe problemet qe si nje shtize e helmuar ngulen ne mendjen e tij duke e pershkuar si nje turrele duke u shprehur brenda ketij botekuptimi meqellim qe mendimet ti pranohen dhe ti zere mendjen dhe zemren e degjuesit. Brezat e sotem po humbasin gjak ndersa ne mundohemi ti bejme peniciline.

Faktet qe permendem nuk jane pretendime utopike por percaktime te verteta te Kuranit dhe synetit. Qe me ajetin e pare Kuranor “Lexo ne emrin e Zotit tend qe te kaa krijuar!”(Atak,96/1) theksohen ceshtje te tilla si krijimin ,ligjet e jeteses dhe formimin. Duke filluar me Epikurin,Domokritin,Sokratin,pas tij me Eflaturin dhe deri ne kohen e Profetit tone pothuajse te gjithë filozofet jane marre me studimin e ceshtjes se

krijimit. Domethene qe deri ate kohe ssecili pak a shume kishte nje informacion rreth krijimit te pare. Ata e dinin se njeriu formohej nga nje pike uji dhe se embrioni kalonte disa faza te ndryshme ne barkun e nenes. Por ne Kurani Fisnik kjo ceshtje merret nga nje prizem me i gjere dhe u drejtohet njerzve:

“Thuaju:Dilni e shetisni ne siperfaqen e tokes dhe shihni sesi ka filluar krijimi!”(Ankebut,29/20) pasi deri ate here asnjehere skishte mundur te shpjegonte fillimin e krijimit me mendimet dhe dijen njerzore dhe me pas sdo te mundnin. Nese nuk mbeshtetesh nga Allahu(xh xh) eshte e mundur shpjegimi i krijimit.

Kurani Fisnik fillonte me shpjegimin e ketyre ceshtjeve komplekse dhe te jashtezakonshme por te pamundura te shpjegohen nga cdo njeri. Ne kete prizem terhoiqet vemendja mbi ajetet qe lidhen me jeten. Jane ato ajete qe si nje liber qe na ekspozohet dhe na paraqitet neve si nje gjerdan i cmuar te vene ne qafen e gjithesis. Ne jemi ne nje pozicion qe ta vleresojme ate liber dhe ate gjerdan dhe smund te nxjerrim jashte tyre kuotimin e ngjarjeve.

Udheheqesi shpirtor qe mundohet te mbaje ne kembe bashkesine e tyre vetem ne lidhjen e ndjesive dhe ndjenjave bien ne kundersizim me ajetet jetesore dhe nuk premtojne te ardhme. Hamendesite nuk te lene te hedhesh hapa te sigurte ,nuk te prijne ne rruge te drejte dhe lene ne mes te rruges te zotin. Nese ata udheheqes pergatisin mendjen dhe zemren e pasuesve te tyre duke i ndihmuar ata te pershtaten me kushtet e kohes qe jetojne ,lidhja mes tyre nuk do te zgjidhet kurre,me kalimin e kohes kjo lidhje sdo te dobeshet dhe ngjarjet e tmerrshme qe ndodhin do ta fuqizojne edhe me shume lidhjen e tyre dhe do tju deshiren dhe vullnetin.

Ketu dua te kaloj ne nje pike tjeter. Ne pergjithesi kjo tablo qe na cudit te gjithëve eshte vertete e tmerrshme. Ketu edhe jashte vendit ka shume raste kur femijet e njerzve fetare dhete drejtuesve fetare qe jane te pafe dhe jo besimtare.

Dhe ne te kundert femije te shume jobesimtareve dhe te pafeve qe kane gjetur rrugen e besimit dhe jane fetar ,madje nje pjese prej tyre per ti shpetuar shtypjes dhe pasionit te anetareve te tjere te familjes largohen per te gjetur nje vend me te pershtatshem per te jetuar besimin e tyre. Duke menduar se personalizimi edhe permendja e individëve sdo te sillte ndonje dobi ne lidhje me ceshtjen do permendja disa histori ne te cilat kam qene vete prezent. Keto mbeten vetem histori dhe ne te ardhmen do te kete prape te ngjashme. Analizimi i kesaj tabloje neve na jep kete rezultat. Familjet

besimtare skane mundur ti tregojne islmamin femijeve ne pershtatje me formimin shpirtor dhe mendor te tyre. Ky femi duke u rritur ne nje atmosfere fetare gjerat e paqarta qe ka patur nevojte ti degjoje si nga pyetur nga te tjetet ,dhe kultura familjare qe ka marre nga familja ate e ka cuar deri diku. Nga mengesite ne shpirtin e mendjen e ketij te riu gjerat e paqarta e ngurrimet e kane bere qe ai te rreshqase dhe te dale nga besimi. Ndodhesha ne nje familje te tille dhe po bisedonim me kryefamiljarin nje bure fetar me nje shpirt te bardhe saqe perballe tij me erdhi turp nga gjendja ime. Pas pak hyri i biri qe ishte student ne shkolle te larte dhe nga biseda me te kuptova menjehere qe ishte ateist. Sa smu shemb mbi koke tavani i shtepise dhe shtanga. Duke kaluar neper mendje ate njeri te persosur thashe me vete:”Sikur ne vend te te qenurit i paster dhe i singerte ,djalin te mos e rrisje ateist.”

Femija qe rritet ne nje familje ateistesh ndjen nevojen qe te pyese per probleme te cilat smund ti zgjidhe vete. Dhe kur dikush jashte i afrohet dhe e ndihmon ne zgjidhjen e problemeve ai e pelqen dhe e pranon islamin,sepse islami i eshte treguar atij sipas kushteve te kohes. Femija i rritur ne nje familje besimtaresh ka nje besim siper faqesor dhe te kushtezuar dhe ndoshta ky lloj besimi ne nje pike si sherben me tej. E mbyll kete ceshtje dhe kthehem ne ceshtjen kryesore.

h) Te arrish nivelin e degjuesit.

Ndonjehere nevojitet te zbresim ne nivelin e degjuesit ndaj dhe udheheqesit shpirtor dhe drejtuesit fetar duhet te flasin duke zbritur ne niveli e tij. Per te qene me e qarte e shtjellojme keshtu: te zbresesh ne niveli e degjuesit esthe nje kulture hyjnore. Profeti yne na fton qe te edukohemi me morali e Allahut. Kurani eshte nje fjale hyjnore qe nga fillimi ne fund ka depertuar ne mendjen njerzore. Si d ote ishte gjendja jone nese Kurani sdo te kishte zbritur sipas nivelit te logjikes ,arsyetimit dhe kapacitetit te njerzimit...!

Neqofte se Allahu do te fliste ne Kuranin Fisnik ne gjuhen qe i fliste Hz Musase ne Teurat(Tur) as sdo te kishim mundesi ta degjonim ate. Dhe sikur te kishte zbritur ne nje gjuhe qe ta kuptonim vetem fenomenet dhe shume te zhvilluar menderisht me shume se 90perqind e njerzve as qe do mund te perfitonin nga Kurani. Por nuk ndodhi keshtu pasi Allahu me madheshtine dhe arsyetueshmerine e tij sipas vullnetit te tij merr parasysh gjendjen e degjuesve dhe flet me ate ne ate menyre. Fjala e tij eshte vetem kurani

ndoshta me perputhje me madhshtine e tij mund te kete shume menyra komunikimi por qe ne nuk mund ti dime. Por ai eshte drejtuar me misterin e tij sipas niveli te te kuptuarit dhe te arsyetuarit te njerzve.

Ne ne Kuran gjejmë botekuptimin dhe nivelin tone ,pasi Kurani flet sipas nivelit te cdo njeriu. Pavarsisht nivelit dhe aftesise perceptuese te nje njeriu secili mund te ndjeje pasqyrimin e gjendjes se tij shpirtore ne Kuran.

Njeriu ndjen sikur ne Kuran dikush i afert i flet duke arritur deri ne gjestet e tija me intime. Eshte mese normale te ndodhe keshtu. Kurani eshte fjala e Allahut(xh xh)qe e kas krijuar njeriun dhe cdo cast ndodhet brenda zemres se tij. Ai eshte Allahu(xh xh)qe e krijoi njeriu nga hici ,i dha atij force dhe shpirt. As shpirti kupton trupin ku ndodhet ne kuptimin e mirefillte te fjales dhe as trupi kupton shpirtin qe e mban ne kembe. Ai qe i ka krijuar dhe i ka bashkuar te dyja ai i njeh me mire. Kurani eshte fjala e tij.

Kjo fjale hyjnore sikurse eshte garantuesja e drejtimit te duhur dhe burimi i shpetimit te njerzve per udheheqesit shpirtor dhe drejtuesit fitare eshte nje orientues i sakte mbi te komunikuarit me njerezit. Po ti drejtoheni atij edhe tekniken e komunikimit me degjuesit do ta mesoni nga ai.

Eshte nje fakt i verete qe Kurani drejtohet sipas niveleve te ndryshme ,pasi eshte fjala e Allahut qe i krijoi njerzit ne menyra te ndryshme. Shume dijetare kane arritur te vene re ndryshimet dhe nivelet e ndryshme te te kuptuarit te tyre dhe mendimeve dhe opinioneneve rreth Kuranit. Edhe gjate epokes se lumtur situata ishte e njejte pasi te gjithë sahabet nuk kishin te njejten nivel te kuptuari dhe te perceptuari te Kuranit dhe megjithë nivelet e ndryshme nuk ishte pengese per te perfituar nga Kurani.

Mendoni qe nje beduin qe ka jetuar ne epoken e te Derguarit te Allahut(s.a.s) degjonte Kuranin dhe permes mendjes dhe shpirtit mund te perfitonte prej tij por ne te njeten kohe dhe poetet qe varnin poezite e tyre ne muret e Qabes perfitonin ne te njeten menyre. Lebid ishte vetem njeri prej tyre. Ai pasi degjoi Kurani per here te pare nuk shkruajti me poezi. Hansa ishte nje grua qe ishte magjepsur pas Kuranit,ajo ishte nder poetet me te fuqishem te asaj kohe. Ata ishin degjuesit e Kuranit dhe ai arrinte te kenaqte zemrat dhe mendjet e tyre. Shume figura te larta dhe te paarrira si ibni Sina,ibni Ryshid,imam Gazali,Fahredin Razi,Ebu Harife,imam Shafi,Ahmed b.Hanbel,imam Malik e shume te tjere qe smund tju numerojme as emrat e degjuan Ate dhe u edukuan me shkollen e madhe Kuranore. Do te thote se Kurani dhe atyre u drejtohej ne te njejten menyre.

Kurani ka marre parasysh nivelin e mendimit te njerzimit ne cdo fushe qe eshte drejtuar sipas botekuptimit te tyre. Kurani ka nje diapazon te tille saqe secili qe e degjon me perzemersi e kujton ate degjuesine tij paresor. Shkenca dhe teknika shenon cdo dite dhe me shume nje progres marramendes. Pothuajse ne cdo fushe po edukohen dijetare dhe me te medhenj. Ata per te zhvilluar aftesite e tyre te pashfaqura e te vendosura ne karakterin e tyre ,duke mjeshteri me ane te ligjeve natyrore te vendosura ne univers prej vete krijuesit gjejne si mbeshtetesi e tyre me te madhe kuranin si fjalen e perjetshme te Krijuesit.

Mijera dijetare te shkencave ndonese ne nivele te ndryshme kane perfituar prej tyre duke gjetur veten nen ombrellen Kuranore. Kimisti mund ta degjoje Kuranin sikur i drejtohet vetem atij. Dhe jo vetem ai por edhe astronomi ,biologu, madje matematicieni dhe gjeometristi. Sipas nje agronomi kurani flet krye fund rreth bijqesise sikurse secili e degjone ne gjuhen qe ai vete perdor. Sipas nje mjeku te afte Kurani eshe qender udherrefyese dhe orientuese edhe me e persosur ,dritedhenese, transparente dhe komunikuese se cdo qender kerkuese qe hap horizonte te reja ne percaktimin dhe kurimin e semundjeve. E njejta gje mund te thuhet edhe per shkencat e tjera. Do te thote se si fshatari qe punon me plug ne dore si dhe dijetari qe zbulon qiejt duke shtypur celesin qe ka ne dore mund te jete degjuesi i Allahut.

Ja Kurani permes dimensioneve aq te thella na jep neve mesim sipas kushteve. Ne anen tjeter Kurani nuk eshte edhe nje enciklopedi qe flet rreth cdo fushe. Qellimi i tij i vetem eshte njeriu duke patur si objektiv ka marre per dore duke e ngritur larte ne qiell dhe qe aty ne perjetesi. Duke realizuar keto gjera ai meson njekohesisht dhe nje metode. Duke gjetur kete pasqyre qe perjetohej ne Kuran udheheqesi shpirtor dhe njeriu i thirrjes duhet te kene gjithmone parasysh nivelin dhe gjendjen e degjuesit dhe te flase sipas kesaj. Duke qene e veshtire kjo pune eshte mjaft e dobishme dhe ne te njeten mase e nevojshme.

Ata qe mundohen ta kthejne ne praktike komunikimin plot filozofi, jo shume te qarte dhe me fjale te medhaja per tu dukur patjeter shume e zgjuar jane ne nje gabim te plote. Sepse ajo qe eshte e rendesishme ne nje shpetim eshte marrja sa me e qarte e mesazhit nga degjuesit. Kjo lidhet permes dergimit te mesazhit sa me te hapur ,te qarte e te thjeshte. Bisedat duhet te behen ne nje menyre sa mete kuptueshme nga njeriu i cdo niveli.

Rinia e sotme eshte e shume huaj ndaj termave dhe emertimeve fetare. Dhe me ta dueht folur ne nje gjuhe te kuptueshme per ta. Mund ta ilustrojme me te kuptuarit e femijeve te vegjel. Sikurse mundohemi te ecim ne ritmin e nje femije te vogel tre vjecar qe e kemi marre perdore ta shetisim, sikurse sillemi si ai dhe qeshim po si ai ashtu dhe ne thirrje eshte kusht marrja parasysh e botekuptimit te degjuesit. Komunikimi duke imituar te vegjelit pervecse do ti beje ata te qeshin nuk dotu shtojte atyre ndonje njohuri.

Brezi yne kur ti flitet rreth islamit nuk do nje komunikim te ngarkuar me filozofine e Bergsonit, paskalit, Eflaturit dhe Descartesit por ka nevojë dhe per tekniken e thirrjes se Hz Muhamedit (s.a.s). I Derguari i Allahut gjithmone eshte drejtuar sipas nivelit te te kuptuarit te njerzimit. Diapazonin e komunikimit e mbante aq te gjere sa sipas situates me femine behej femi, me te riun behej i ri dhe me te moshuarin behej i moshuar. Kjo kulture hyjnore dhe ky sistem eshte sistemi dhe kultura e Profeteve. Mbreti i Profeteve ne nje fjale te percjelle prej tij thote:

”Ne si bashkësi profetesh jemi urdheruar te zbresim gjithmone ne nivelin e njerezve dhe te flasim ne menyren qe ata mund te na kuptojne.” dhe ne nje transmetim tjeter “Flisni ne niveli e mendjes se njerzve” duke na peshperitur neve parimin qe sduhet te lihet pas dore kur ftojme njerzit ne rrugen e besimit.

7. Lidhja besim-thirrje-veprimet

a) Thirrja dhe jeta

“Te tregosh ate qe jeton dhe te perjetosh patjeter ate qe tregon” duhet te jete nje nga parimet kryesore tenjeriut qe ben thirrje, pasi ky i fundit duhet te jete ne rugen e te qenurit nje besimtar i vertete. Besimtari i vertete eshte ai qe ka arritur te jete je i vetem si ne aspektin e jashtem ashtu edhe ne boten e teij te shpirterore. Ne jeten e nje per soni te tille nuk behet fjale per preplasje mes te brendshmes dhe te jashtmes. Te kesh nje jete te dyfishte eshte nje cilesi e e qarte e te qenurit mosbesimtar. Nje kulturee tij smund te gjendet kurre ne nje njeri thirres i vertete dhe sduhette egzistojte, pasi te qenurit besimtar tregon nje horizont te kulturor te shenjte ku ne cdo kohe dhe vend te tregoje vetem ato qe jeton.

Ne menyre te vecante njeriu i thirrjes duhet te dije qe fjalet dhe keshillat qe nuk jetohe vetem sdo te kene ndonje ndikim te madh ne shpirtat e njerzve.

Ne fjalet dhe veprimet jo te singerta Allahu(xh xh) nuk dhuron begati dhe frytdhenie. Ndonjehere shihet ndonje sukses apo ndikim i personave jo te singerte ose gjysem te singerte dhe kjo suate buron nga mospatja e ndonje alternative tjeter dhe eshte e perkohshme. Nje suate e tille ndodh nga mungesa e te singerteve ate moment ose ngaqë keta njerez te singerte nuk jane bere qender terheqese.

Nga kjo pikpamje fati i njerzve jo te singerte cdo dite qe vjen do te fshihet. Nga e djeshmja te e sotmja ky ligj hyjnor ka rezultuar ne kete menyre. Per rrjedhoje suksemi i perkohshem i njerve gjysem dhe jo te singerte nuk duhet ti genjeje njerzit e besimit.

Sukseset e pjesshme te verejtura ne dy shekujt e fundit sine vendet kapitaliste dhe ne ato komuniste sherbejne si nje shembull i mire i asaj qe sapo theksuam. Te dy keto sisteme u shfaqen si nje alternative e njeri tjetrit. Kur u shfaqen keto sisteme te perdhosjes dhe grindjes duke mos patur ndonje formim tjeter me te bukur dhe te singerte ato hodhen shtat dhe u zhvilluan. Ne ditet e sotme ngjarjet po ndiqen nga afer nga nje bashkesi personash te shkathet dhete singerte. Dhe tashme e tutje dhe personat e mbare e te singerte do te mundte gjejne klienta dhe do te mund te shesin mallrat dhe sherbimet e tyre. Edhe sot shihet hapur sesi qe ditën qe kur lindi komunizmi nje sistem i mbaruar dhe i destinuar per te humbur i la menjane duke i flakur tutje nga pazari i te vertetes dhe singeritetit duke i lene vendin alternatives se vetme te qenshme te thirrjes dhe perpjekjeve te singerta te besimtareve mysliman.

Tregimtari i asaj qe jeton ose e shprehur ndyshe te jetuarit e asaj qe tregon arrihet permes gjetjes se vetvetes dhe i larjse se hesapeve qe personi ka me vetveten. Seshte pare kurre te shpetuarit nga te jetuarit ne dy menyra te trupave njerzor qenuk kane arritur nje formim te caktuar dhe qe sjane shtruar. Keta shpirtra sikurse skane vepruar ndonje here sikurse kane qene por sikurse kane qene sjane sjelle ndonjehere. Situata te respektueshmerise,te pjekurise dhe te progresit te shfaqur ne shoqeri duke qene te shtiruara dhe fallco kane bere qe ata te percmohen nga mjedisi. Kur ata mbeten vetem behen mjaft qesharake dhe jo serioza. Kjo tregon ne nje fare mase pamjaftueshmerine dhe paqendrueshmerine se papjekurise se tyre qe per ta zbuar tutje padyshim qe lihet ne nje besim te mire dhe ne nje kthim te shendetshem dhe serioz. Njeriu i thirrjes duhet te tregoje kujdes ne kete aspekt. Ashtu sikurse sjalljen qe shfaq kur eshte ne mes te njerzve dhe kur mbetet vetem duhet te vazhdoje te njejten sjelle duke u perpjekur te jete

sa me larg perpjekjeve jo te singerta qofshin keto te fshehta ose haptazi. Sduhet te bie ne kontradite ne mes te sjelljeve individuale dhe atyre kolektive shoqerore. Natyra e tij duhet te jete e ndricuar po aq sa edhe dita ndersa kjo e fundit te jete e kulluar dhe e shkelqyeshme sa te sfidoje diellin. Perballe gabimeve te vogla te shkaktuara nga pakujdesia te tregoje nje qendrim te singerte. Ai smund te flase rreth faljes ne mesin e nje nate qe se ka zbkuruar me namazin e nates. Te mos pushoje duke qare deri sa te laje me lot mbeturinat e mekatit qe i kane mbetur sy. Nje kafshate e dyshimit apo e papranueshme(haram) duhet ti shkakatoje dhimbje barku per dite me rradhe dhe me nje shpirt perkushtimi te ndjeje veten si ne flaket e ferrit. Mendet dhe opinionet qe nuk gjejne zbatim te individit sado magjepsese dhe e nevojshme per jeten te jete as nje here sdo te arrije nivelin e pranimi te deshruar. Sepse fjalet e shprehura skane gjetur meshirim ne vete shpirtin e personit qe i thote. Ajo qe sgjen meshirim ne shpirtin e individit eshte e pamundur te deshrosh qe te gjeje meshirim ne gjirin e shoqerise.

b) Thirrja dhe kriteret e vleresimit.

Thirrja dhe perparimi i nje shoqerie islame nuk eshte vetem nje detyre por ne te njejten kohe paraqet dhe kriterin dhe shkallen e vleresimit per cdo gje,ne kete menyre individete kesaj shoqerie i pershtasin punen sipas ketyre kriterëve,ditet i ndertoje mbi keto shkalle dhe netet i kalojne me te njeten ndjenje pergjegjesie. Vajtja e here pas hershme e individit ne xhami, realizimi i detyres se peligrinazhit dhe marrja pjese ne ceremonite fetare nuk duhet te jete kriter vleresimi. Duhet te largohemi nga cdo sjellje qe zhduk boten e kuptimit e te besimit dhe thirrjes dhe qe e shnderron kete mision ne nje formalizem dhe ceremoni. Keto veprime mund te jene ngushellim per nje pjese por jane larg gjetjes semeshimit ne shoqeri. Ajo qe i humbet vleren shoqerise duke e dobësuar qendrueshemrine morale,materiale te tij eshte mosrealizimi ne plane dhe vetedije te plote te urdherimit ne te mire dhe ndalimit te gabimeve si shkaku me kryesor ne mes te shume shkaqeve.

Ne ditet tona kjo detyre e shenjte duhet te pranohet si nje obligim personal per cdo individ. Pasi rrethi vicioz i intrigave duke depertuar ne mangesite e shoqerise ne fillim individet e pastaj shoqerine e formuar prej tyre e cojne buze gremines te shkaterrimit total.

Jemi te detyruar te insistojme ne kete aspekt pasi para se gjirhash eshte nje ceshtje besimi dhe deri me sot ata qe kane marre persiper kete ceshtje kane qene njerzit me nje besim te palekundur. Kjo ka qene keshtu

dje eshte sot dhe do te jete nesor. Pasi smund te shpjegojne ndryshe levizjen e thirrjes te nje grupi njerzish me nje besim te palekundur dhe te singerte ne mes te nje bashkësie te madhe e cila gjeti pasqyrim ne gjirin e nje shoqërie ne njekohe te shkurter duke u shoqeruar me nje ceshtje te perkrahur nga qindra e mijera. Padyshim qe karakteristika me e spikatur qe bie ne sy e kesaj levizjeje eshte fakti qe ajo levizje ishte larg ceremonive dhe formalizmave. Asnje levizje qe si shmanget problemeve e shqetesimeve nuk i shpeton renies per te formalizmave dhe ceremonive banale. Te gjitha levizjet qe mbeten nje ndjenje formale nuk kane brengosjen e keqardhjen dhe roberimin dhe si rezultat tek ata ska qendrueshemri ,singeritet dituri dhe perqafim. Njeriu i thirrjes pra cdo veprim,sjellje duhet ta pershtase sipas jetes se progresit,atje ku skone te shkaje ne keto mendime ,te ulet dhe te ngrihet me te po te njejtat mendime. Ne jeten e tij ska vend per pasiguri. Ai dhe nevojat personale i kanalizon ne drejtimin e ketij misioni. Jeton me vetedije se do te pyetet nje dite per cdo marrje dhe dhenje fryme. Kjo eshte rruga e Profeteve,e ndjekesve te tyre dhe e deshmores te kesaj rruge(shehideve). Ata gjithmone folen per ato gjera qe jetonin dhe jetoni po ato gjera qe thoshin. Hipokritet flasin pa i jetuar gjerat dhe su vene veshin gjerave qe tregonin. Duke u futur ne rrethin vicioz te nje rruge pa krye ata cuan ne shkaterrim veten dhe te gjithë ata qe u shkuan pas.

Allahu(xh xh) i drejtohet keshtu Hz Isase(a.s) te cilin e dergoi si nje udheheqes shpirteror per njerzit: “O biri i Merjemes! Ne fillim keshillo veten tende dhe kur ta kuptosh si duhet atehere keshillo te tjeret. Neqoftese nuk vepron keshtu atehere turperohu para meje.

Kjo thirrje nuk i drejtohet Hz Isase vetem si profet,duke qene se ai eshte ne rolin e nje udheheqesi shpirteror dhe drejtuesi fetar Allahu(xh xh) e therret “O Isa” si degjues qe eshte. Atehere qofte profeti apo dikush tjeter kur keshillon dhe udhezoi ne te drejte para se gjithash duhet te jetoje vete keshillat dhe fjalet qe thote duke i vene ne jete me qellim qe te ndikoje te tjeret. Kjo shprehet mjaft hapur nga Kurani Fisnik ne kete menyre:

“Ju po urdheroni njerzit ne gjera te mira dhe veten tuaj po e harroni? Ndersa ju po lexoni librin a nuk po mendoni aspak?”(Bakara,2/24). Libri ju propozoni te keshilloni veten tuaj para dhe pastaj te filloni punen. Atehere dhe pasi lexojme keto ajete a nuk do na vije mendja?

Ky ajet u drejtohet cifuteve drejt pre se drejti permes kercenimit por ne menyre te terthorte paralajmeron myslimanet duke thene:”Kujdes dhe mos

veproni keshtu". Sikurse e thame edhe me pare mos praktikimi i asaj qe thuhet eshte nje mashtrim dhe cilesi e hipokritit. Si popull keni qene deshmitare te paaftesise se ketyre njerzve per te ndikuar dhe te mos vajtjes se popullit pas tyre.

Perfaqesuesit te frontit te mendimit te islamit madje dhe qe flasin rreth tij ne nivele akademike ,madje edhe njerzit qe vazhdimisht japin mendime ne kete fushe duke qene se skane vene ne jete gjerat per te cilat kane folur ,jane larguar pa lene gjurme,pasi veprimet e tyre sishin te mbara dhe fjalet nuk ju burojne nga besimi.

Ne nje kohe popullit i tregonin rrugen e drejte duke pretenduar se perpiqeshin per shpetimin e njerzve ,kur mjaftoi nje fllad i lehte dhe nje tronditje e vogel qe ti rrafshonte me token duke i bere te harronin ato qe po thonin dhe ato qe do te thonin. Madje mohuan te gjitha ato qe thonin duke u bere mbrojtjesit e zjarrete te mendimit te kundert. Si rezultat u shkaterruan dhe humben mes te paqeneve por per fat te keq rrafshuan dhe nje qyteterim me veten e tyre....turp te kene ata!

c) Thirrja dhe vuajtja.

Eshte nje vleresim hyjnor qe thirrja dhe perparimi te jene lidhur ngushte me vuajtjen dhe dhimbjen. Vetem gjerat qe rriten me veshtiresi ruhen me kujdes dhe perkujdesje te vecante. Eshte ceshtje momenti konsumimi i pasurise qe skane per baze mundimin per te arritur dhe seshte derdhur djerse per to. Nese kjo ceshtje eshte tregimi i Allahut(xh xh) ajo zhduket menjehere ,qe con ne zhdukjen e garancise se qenurit njerzor dhe te shkakut themelor te njerzimit. Atehere njeriu duhet te zbatoje kete detyre te shenjte qe do ti jape kuptim egzistences se tij...

Dje nje grup njerzish u zvariten nga burgu ne burg duke i bere burgjet ene e mbane vendit ne shtepi te tyre te perhershme. Nuk ju mbeti mundim pa perjetuar dhe sharja pa ju thene. Madje kishte shume prej tyre qe shkonin ne komisariatet e policise e sktheheshin me e shume te tjere qe e ndjenin te nevojshme te perqafoheshin per here te fundit me te shoqen dhe femijet e tyre,sepse nuk dihej vendi ku do ti conin. Te gjitha keta njerez jepnin nje perpjekje te tille,dhe ne nje kohe te shkurter perpjekjet e tyre te singerta dhe te pastra filluan te jepnin fryte te bukura. Arritja e gjendjes qe kemi sot u realizua nga lutja e njerzve te tille dhe permes ndihmes qe ju erdhi nga meshira e pafundme. Per kete arsye askush ska te drejte te shperdoroje

kete pasuri te vyer. Ketij sherbimi te ngritur ne nje fare niveli permes vuajtjeve dhe mundimeve besimtaret duhet ti dalin ne krah me te njeiten ndjeshmeri. Me larte patem theksuar se kjo eshte nje pune besimi. Cdo individ qe i del ne krah besimit duhet dhe te perpiqet qe ti ruaje jetegjatesine ,po aq sa mbron shtepine dhe femijet e njerzit e shtepise,poe aq sa kujdeset per punen e profesionin te ruaje dhe te perkrahe edhe kete besim. Ne te kundert sdo ti shpetojne fatit qe pesuan nje pjese e cifuteve.

Njeriu i thirrjes dhe perimi duhet tu beje balle veshtiresive dhe tja perserise shpesh vetes domosdoshmerine e perballjes me veshtiresite. Duhet te dije dhe te besojte se nese nuk i qellon te perballlet me veshtiresi e vuajtje si dhe paraardhesit e tij nuk do te arrijne ndonje sukses. Ai duhet te kerkoje te veshtiren dhe nese perballlet me lehtesira te falenderojte Zotin dhe te vazhdoje me shpejtesi rrugen.

Besimtari eshte njeri i singerte dhe qellim mire. Te jetuarit e asaj qe thote dhe te folurit e gjerave qe jeton eshte shprehje singertet. Pasi te kunderten Kurani e merr ne shqyrtim si nje genjeshter dhe hipokrizi. Jeta e per sonit qe ne cdo moment u flet atyre qe e rrethojne rreth fese,besimit dhe Kuranit duhet te jene ne perputhje me parimet dhe kriteret e gjerave qe tregon. Ne jeten e tij sduhet te kete vend mekati dhe ky i fundit duhet te jete nje shqetesim i perhershem. Nese ka bere ndonje mekat gjate gjithes jetes duhet te ndjeje ne qoshet me te thella te shpirtit te tij mundimin pervelues te atij mekati. Asnje mekat sduhet te qendroje per shume kohe si i ftuar ne shpirtin e tij.

Njeriu shpetues dhe udherrefyes sduhet te kete sy nga e papranuara(harami) sduhet te preke me dore dhe te ece ne rrugen e te papranueshmes. Nata e tij te jete me drite sa dhe dita dhe sexhadja duhet te jete e dashuruar me sexhaden e tij. Ne jeten e tij sduhet te degjohet fjala “ se arrita faljen e mengjesit”. Nese se ka arritur faljen per arsye jashte vullnetit te tij duhet te kaloje gjithes ditën duke vuajtur e qene i shqetesuar. Kjo duhet ti ndaloje oreksin dhe te humbase veten aq sa te behet dysh nga dhimbja dhe mundimi.

d) Thirrja dhe mosmarreveshjet.

Ndjenja e vetegjyqesise dhe e llogarise duhet te jete nje parim qe e fshikullon gjithmone njeriun e thirrjes dhe perparimit. Drejtuesi shpirtor duhet te kontrolloje gjithmone veten e tij,te mbaje nen kontroll ndjenjat dhe emocionet dhe duhet te perpiqet qe te vere ne jete gjerat qe propagandon.

Ai duhet te shmanget nga shpjegimi i gjerave dhe te jape keshilla pa i analizuar ato vete. Kjo ndroje sduhet te behet pengese per te thirrur ne fe por te nxise dhe ta perforcoje dhe me shume kete ndjenje. Frika per te mos u ngjare hipokriteve dhe per te mos rene ne kundertshti e afron ate drejt sinqeritetit dhe progresit te vazhdueshem.

I Derguari i Allahut(s.a.s) ne lidhje me ata qe e shqyrtojne progresin si nje dialektizem dhe vetem nje llafazanllek jep kete shprehje te frikshme dhe rrenqethese:

“ Per popullin tim frikesohem me teper per hipokritin qe thote fjale te bukura!” Zemra qe degjon kete thirrje te ndershe dhe plot drite nuk mendohet te mos dridhet. Pasi njeriu ne cdo pozicio qofte here pas here ndjen nevojën tju paraqese dhe tju tregoje disa gjera njerzve te tjere. Ky dhe shume kercenime te tjera do te pengojë humbjen e vlerave te thirrjes dhe progresit.

Megjithate pavarsisht nga shume faktor qe terheqin vemendjen mund te takojme shpesh persona qe bredhin ne fushen e mosmarreveshjes dhe te humbjes se vlerave. Tipa te tille japin mendime pa pushim ne ekranet e televizoreve dhe ne faqet e gazetave por kur behet fjale per veprime dhe sjellje konkrete behen me keq se te pafete. Flasin rreth fese besimit dhe Kuranit holli i tyre eshte i piste dhe pa rene ne sexhade dhe zemrat e tyre jane te pasinqerta dhe hipokrizi. Te mjeret shpirtera! Nuk e dine se nentedhjetë perqind e fese lidhet me vete boten e brendshme te personit. Nese individi si ka parasysh keto ai do mbetet nje llafazan i thate ose nje dialektik symbyllur.

Kurani fisnik kur rradhiti cilesite kryesore te nje njeriu progresist nuk le pas dore dhe te permende dhe cilesite e hipokritit. Po aq sa eshte e rendesishme gjerat qe duhet te beje udheheqesi shpirteror dhe se cfare duhet te zoteroje eshte po aq domethenese se cfare sduhet te beje dhe te rrije larg. Kur Kurani tregon hipokritet per dor nje metode qe te largoje besimtarët nga cilesite e tyre. Ai e zberthen aq shume kete fakt saqe shfaq qarte para syve qellimin, ndjenjat e brendshme dhe boten e tyre shpirterore. Ndonjehere pershkruhet paraqitja e tyre e jashtme dhe ndonjehere per menden vetite dhe karakterin e keq te tyre. Shihni gjuhen qe perdoret ne kete ajet Kuranor:

‘Kur i sheh ata te mahnit paraqitja e tyre ,sdhe kur flasin ju ve veshin. Por ata ngjajne si nje stive trungjesh ne zgaver,e cdo klithme e pandehin se eshte kundra tyre. Ata jane kundertshtaret tuaj ndaj ruajuni prej tyre. Allahu

iu marrte shpirtin si vertiten rrotull duke iu mashtruar.”(Munafikun,63/4). Sikurse shihen edhe me larte ata paraqiten duke u vleresuar ne vija te pergjithshme veten e tyre qe shihet mese qarte. Kurani i kap ata me sjelljet dhe bisedat e tyre ,ne stilin dhe paraqitjen e jashtme sa me mire sgjindet kund. Ata jane te afte te gjejne perkrahes permes fjalimeve te tyre te shkelqyera dhe mbrese lenese,me mimiken,elokuencen e te folurit nga ata qe i rrethojne dhe i vene ti ndjekin pas si tufa bagetish. Ne fakt ata jane vecse njerez te veshur me pelhura te vecanta dhe sjane gje tjeter vecse kundershatare. Kurani i thote te gjitha keto per dijetaret e fjalet te vjeter a te rinj qe spunojne por vetem flasin ne emer te atdheut e te popullit,ne emer te fese e te besimit. Kurani u therret ketyre njerzve me nje ton kercenues: Mos i hapni shteg falsitetit ne emer te se vertetes dhe mos shkaktoni probleme ne frontin tuaj!...

Keto veprime qe jane nje shenje dalluese e hipokriteve duhet ta frikesojne thirresin qe sherben ne emer te se vertetes. Keto probleme ne te cilat njeriu mund te bjere pa e vene re behen fjale per cdo njeri. Per kete arsye ata qe jane ne rrethin e besimit duhet te jene mjaft korrekt dhe te kujdesshem.

e) Thirrja dhe raporti me Allahun.

Udheheqesi shpirtor sa me i singerte te jete aq dhe me ndikuese do te jete fjala dhe sjellja e tij. Nese ska vend singeriteti ,madheshtia dhe mjashteria ne te komunikuar nuk jep ndonje rezultat. Mund te themi nga nje ane nuk kane asnje lidhje me gjetjen e rruges se shpetimit,pasi shpetimi dhe udhezimi ne rruge te drejte eshe para se gjithash ne doren e Allahut. Nese Ai nuk deshiron dhe nuk mundeson dicka te tille askush smund te jete ndermjetes ne rruge te drejte. Ne Kuranin Fisnik thuhet:

“Ti smund ta udhezosh ne rruge te drejte ke deshiron. Eshte Allahu ai qe udhezoi ne rruge te drejte kedo qe ai deshiron.”(Kasas,28/56).

Atehere ceshtja eshte qe te jemi ne nje raport sa me te afert me mbretin e mbreterve”,sepse celesi i te gjithë thesareve te fshehte apo te dukshem eshte ne doren e tij. Gjetja e rruges se drejte eshe thesari me i madh ndaj dhe celesi i ketij thesari do te jete ne rugen e tij. Prandaj dhe udheheqesi shpirtor dhe drejtuesi fetar ndersa u flasin njerzve me gjithë singeritetin dhe aftesine ne anen tjeter duhet te mbeshteten ne Pushtetin e pafund qe ka celesat dhe frerin e cdo gjeje. Ne vendin tone erdhen e iken fenomene te jashtezakonshem qe me gjithë fjalen me nivel dhe fuqine shprehese as

tre kater njerzve smund tju tregoje dicka seriozisht,pasi ata sqene te singerte dhe cdo gje dhe cdo rezultat e lidhnin vetem me qenjen e tyre. Mes tyre kishte edhe prej atyre qe mund te elektrizonin turma te mijera njerezve e tju benin tju shkonin pas por duke qene pjese e kaos-marreveshjeve nuk arrin asnje rezultat konkret. Kishte prej atyre qe flisnin per faljen ndonese sfaleshin fare,flisnin per bukurite e islamit ndonese se jetonin ate. Gjuhen e kishin si te bilbilit por zemren e kishin plot ligesi,inatera dhe merira. Per shkak te tyre Kurani e llogarit kundershite dhe mosmarrveshjen si me te felliquren dhe me te frikshmen nder cilesite me te uleta. Per kete arsye cdo thirres i singerte duhet te vere koken para Allahut(xh xh)pesedhjetë here ne dite duke u mbeshtetur tek Ai nga kundershite e mundshme dhe duhet ti kerkoje edhe me shume singeritet. Shpetimi eshte ne doren e Allahut(xh xh). Sikurse eshte Ai qe i jep fuqi trupit te njeriut eshte po ai qe mund ti dhuroje singeritet zemres. Per rrjedhoje thirresi sduhet et mundohet te pervetesoje asnjeren dhe sduhet te thote:” une e bere ,une e dhashe”.

Besimi eshte nje teresi fjalesh dhe veprash dhe ne mes te kriterëve te caktuara nga Allahu per nje besimtar eshte forma me ideale. Ruajtja e ketij ekuilibri eshte nje faktor i rendesishem per te patur ndikim.” Luftetari(myxhahiti) edhe po sveproi mire eshte. Pasi atij i mjaftojne dhe tregimi i se drejtes dhe te bukures...” e te tjera mendime ja ne vecse numerira djallazore dhe skane lidhje fare me shpirtin Muhamedjan.

Ne ditet e sotme u shfaqen shume konservatore dhe moderatore dhe mendimet e tyre. Madje ata kane aq force dhe pushtet sa dhe te bardhen e tregojne te zeze. Majtas e djathtas propagandojne vetem islamin por shohin se pas tyre nuk kane asnje grusht besimtaresh te vertete, sepse ata sjane te singerte. Flasin e propagandojne shume madje dhe perpiqen por nuk kane misheluar brenda tyre besimin dhe islamin ne shkallen qe flasin. Njerzit qe nga jeta dhe bota qe jetojne nuk motivohen nga gjerat reale te perendimit por por nga falsitete dhe kotesira i bejne dhe me te huaj e ne vend qe ti shpetojne e udhezojne ne te drejte. Madje dhe vete behen te huaj me shoqerite qe jetojne. Shkaku i gjithë ketyre gabimeve eshte mosnjohja sa duhet e islamit dhe duke mos i vene ne jete ato qe lexojne dhe mendojne rreth tij ,dhe permes veprimeve jo te qendrueshme behen nje opozite e fshehte e ceshtjes madhore per te cilen luftojne ose e tradhetojne ate.

Shihni se si Kurani Fisnik ben te flase Hz. Shuqip(a.s):

“Nuk dua tju kundershtoj juve ne gjerat qe ju ndalova”.(hud,11/88)

Kuptimi i kesaj eshte:”Nuk mendoj teperfitoj vete nga ajo qe ju ndalova nga e keqja. Duke iu thene juve se interesi ne para(Faizi) eshte i ndaluar ashtu edhe rryshfeti ,nuk mendoj se keto gjera do ti bej vete.” Ndersa Hz Shuaip(a.s)tregon bashkesine ku jeton thote keto si nje garanci e se vertetes se cdo profeti. A mund te tregohet ndonje profet ndryshe nga ajo qe keshillon popullin e tij? Ose nje njeri qe ben te kunderten a quhet Profet?

Cdo njeri qe ka marre persiper nje detyre te tille nuk duhet te heqe dore nga keto parime. Hz Shuaip(a.s)duke u perpjekur ne bashkesine e tij edhe neve na tregon dicka duke permendur parimet esenciale ne emer te misionit qe kemi marre persiper. Dhe Kurani i ve ne dukje edhe nje here keto permes shpalljes se tij te mrekullueshme dhe mjaft te qarte.

I Derguari i Allahut(s.a.s) eshte nje shpirt i jashtezakonshem qe jetonte edhe me shume sesa ajo qe thoshte. Ne perkushtimin ndaj Zotit mbi te skishte njeri. Atij i eshte dhene dhe te qenurit profet dhe devotshmeri. Kjo ishte nje vleresim i jashtezakonshem i pakrahasueshem me cdo gje tjeter. Gjithsesi ai ndersa fluturonte ne boten e persosmerise ai ishte lartesua prej devotshmerise prej robi. Kjo do te thote se devotshmeria e tij kishte kaluar te qenurit profet duke e ngritur mbi lartesine e lartesive. Po a nuk urdherohet kjo sjellje e tij keshtu ne Kuranin Fisnik?

“Adhuroje Zotin tend duke vazhduar qenien rob te tij derisa te vije (vdekja)”(Hixhr,16/99). Ai gjihte jeten ndoqi urdherat e Kuranitdhe per asnje cast nuk u ndal ne adhurim. Per kete cdo gje qe ai thoshte zinte vend ne zemren e njerzve. Fliste per gjerat qe i perjetonte ne formen me te rende te tyre. Ja nje shembull qe na per cillet nga nena jone Aishja(r.a):”Nje dite i Derguari i Allahut me tha: “O Aishe ,a me lejon qe kete nate ta kaloj me Zotin tim?” Dhe une ja ktheva:”O i Derguar i Allahut! Mua me pelqen te jem me ty ,por ajo qe te pelqen ty do te me pelqente edhe me shume.” Pas kesaj u ngrit mori abdes dhe filloi te falej. Ate nate derdhi lot dhe u fal deri ne mengjes.

Ai ishte padyshim profet ,por jo vetem profet por edhe udheheqes shpirteror dhe orator. Ana me e thelle e tij ishte devotshmeria e paaneshme ne adhurim. Ne momentet me te veshtira e te dhimbshme edhe kur ishte i semure ne fund te jetes se tij deshironte te vazhdonte adhirimin ne te njejten menyre sikurse i kishte bere deri ate dite. Gjate gjithe jetes kishte kaluar shume caste te veshtira dhe kishte nje sere problemesh duke filluar me grate e tyre dhe deri tek femijet. Madje dhe problemet e popullit te tij te kesaj bote dhe asaj tjetres ishin mbi shpatullat e tij. Nga te gjitha keto patjeter qe

do te binte nga forca fizike. Dikush tjeter ne vendin e tij sdo te perballonte as edhe nje dite ato qe kishte hequr Ai. Megjithë keto Ai nuk hiqte dore as nga namazi i nates. Keto namaze ishin aq te gjata sa ndonjehere nje rakat zgjaste me ore. Kur forcat i kishin shterruar pe tu ngritur ne kembe i kryente ato nga ulur por nuk hiqte dore prej tyre. Cfare perkushtimi,cfare serioziteti dhe cfare sinqeriteti ishte ky? Deri ne castin e vdekjes ,diten e ringjalljes dhe deri ne perjetesi do te zgjaste ky seriozitet dhe kjo besnikeri. Nje ane e rendesishme e thirrjes eshte kjo afersi ndaj Allahut(xh xh).

Nese sdo te ishte kjo afersi njeriu do te jetonte ne ajer dhe ne nje boshllek. Ne nje terren te rreshqitshem te tille ,njeriu qe shkel ne boshllek mbetet vetem dhe vetem me kenaqesite e tija.

Ishte Profeti yne(s.a.s) ai qe bashkoi mjaft bukur irshadin dhe afersinendaj Allahut(xh xh). Aq sa ishte i persosur ne realizimin e udhezimit te njerzve ne rruge te drejte po dhe aq i persosur dhe thelle ishte ne adhurimin e Allahut. Kur qendronte per te drejtuar faljen ata qe ishin pas tij kujtonte se sdo te mbaronte kurre. E tille ishte lutja dhe falja,duart qe hapeshin per tu lutur dukej sikur nuk do te uleshin kurre.

Nje here ibni Mesud(r.a) kishte qelluar ne nje nga faljet e namazit te nates. Per te perfituuar nga miresia e namazit qe falej nga i Derguari i Allahut(s.a.s) kaloi prane tij per tu falur. Vazgdimin e tregimit le ta degjojme nga vete ai:

“Fillova faljen e nje namazi qe ishte vetem dy rekate. Por i Derguari i Allahut(s.a.s) vazhdonte te lexonte pjese nga Kurani. Pasi mbaroi kaptinen(suren)Bakara thashe se do te binte ruku por ai vazhdoi Ali imranin. Pasi mbaroi ate thashe se do te binte ruku por ai lexoi Nisane dhe e mbaroi edhe suren Maide. Ne rekatin e pare lexoi keto kater sure. Madje ne nje moment ne mendje me erdhi dicka e keqe...” Ata qe ishin prane e pyeten:”Cte erdhi ne mendje?”

Dhe ai iu pergjigj:” per nje moment me erdhi te dal nga namazi pasi ishte i paperballueshem.”

Sikurse shihet i Derguari i Allahut(s.a.s) para se tju fliste njerzve rreth adhurimit te Zotit e jetonte ate vete ne shkallen me te larte. Ai ishte aq larte ne kete aspekt saqe edhe sahabet si Ibni Mesudi(r.a) qe qendronin ne rreshtat e parenuk mund te duronin dy rekate namaz qe ai falte.

Perseri Ai ne periudhen e kohes kur po jetonte castet e fundit si nje diell madheshtor kishte vendosur koken ne gjunjte e Hz Aishes(r.a) dhe syte i kishte ngulur ne hapsirat hyjnore. Here pas here humbiste veten dhe i

hidhnin nje kove uje per ta sjelle ne vete dhe hapte syte. Sapo hapte syte gjeja e pare qe pyeste ishte “Bashkesia a e fali namazin?” Ai jetonte duke e mbajtur ne goje namazin dhe duke e permendur ate dha shpirt. Edhe bashkesia e tij permendte namazin ,mendonte dhe jetonte vetem ne ndjenjen e tij.

Ja pra nje njeri i kompletuar ne cdo aspekt,nje udheheqes fetar(imam) i persosur dhe nje kryetar shteti dhe nje familjar i drejte dhe me durim!...

Jeta e thjeshte e te Derguarit te Allahut(s.a.s) qenja se bashku me shoket e tij ne cdo ceshtje ne emrin e gjetjes se rruges se drejte jane nga kriteret e rendesishme qe sduhen mbajtur larg syve. Nese do te behej nje xhami ai do te mbante qerpice me te tjeret ,do te thyente gure me vare nese do te hapej nje hendek duke iu dhene nje dore shokeve te tij. Thoshte qe “te jesh nje njeri mes njerzve “dhe e jetonte ate praktikisht.

Nese i ftonte njerzit qe te mos jepeshin shume pas kesaj bote ,ishte ai qe perpiqej te ishte ne krye te te tjereve. Ndonjehere te shtepine e tij kalonin muaj qe nuk ndizej zjarr per te gatuar gjelle te nxehte dhe nuk gjendej ndonje krevat ku te shtriheshe per te pushuar.

Edhe ndaj te papranueshmes(haramit) ishte Ai me korrekt se cdo njeri. Kur Hz Hasani(r.a) kishte marre nje hurme nga ato qe i ishin dhene per bamiresi(sadakat) ishte shqetesuar dhe kishte vrapuar per tja hequr nga goja.

Ne ate kohe Hz Hasani(r.a) ishte vecse nje femije pese-gjashte vjecar. Por gjerat e dhena per bamiresi(sadakat) ishin te papranueshme(haram) per te Derguarin e Allahut(s.a.s)dhe te gjithë te afermit e tij.

Edhe nje nate tjeter nuk kishte fjetur deri ne mengjes duke renkuar. Ne mengjes Hz Aishe(r.a)e pyeti:”O i Derguar i Allahut! Cte shqetesonte qe nuk fjete mire mbreme?” Kesaj pyetjeje i Derguari i Allahut(s.a.s) i pergjigjet: “Gjeta ne dheme nje hurme dhe e henga. Pastaj mendova se mund te ishte ndonje nga hurmat e dhena per bamiresi. Kjo ishte ajo qe me shqetesonte.” Ne nje kohe kur hurmat kishin shume rendesi te ishin te tijat ,pasi ato qe jepeshin per bamiresi i vendoste ne nje vend tjeter. Ky eshte nje shembull shume i mire mbi vecorite qe duhet te kete njeriu qe fton ne rruge te drejte ,si dhe tregon ndjeshmerine e Profetit ne kete aspekt.

f) Thirrja dhe lutja

Përvec gjërave të lartepërmendura Profeti ynë kishte edhe një aspekt lutjeje që smund të kalonte pa u prekur. Ai i thoshte shoqeve të tij dhe gjithë popullit të tij që të beheshin një i vetëm me lutjen duke iu tërhequr vëmendjen me ajetin:

“Nese sjane lutjet tuaja cvlere ju mbetet.”(Furkan,25/77). Ku flinte ,kur ngrihej,kur hante dhe pinte,kur vishte rrobat ,kur hynte dhe dilte nga Ë/C-ja ,kur merrte abdes dhe thoshte aq shume lutje saqe në bote është e pamundur të tregohet person tjetër të bërë njësh me lutjen vec Atij. Dhe ska tjetër njeri që në cdo hap që hedh të kujtoje Allahun(xh xh) ,ti drejtohet dhe në cdo gjë të gjeje pelqimin e Tij.

Eshtë kjo jetë që ben të marrësh mesim që ka tërhequr vëmendjen e njeriut të cdo niveli gjatë katërmbëdhjetë shekujsh në botën islame duke u ndjekur me interesim dhe impenjim. Ky impenjim në sipërfaqen e tokës ska qenë për asnjë tjetër. E gjithë jeta e Tij duke filluar nga të ngrenet dhe të pirit ,nga të veshurit dhe të ecurit,stili në mënyrën e të folurit,veprimet politike dhe sociale e deri në veprimet portokollare mes shteteve ,është filmuar duke u regjistruar në kujtesën e mbare njerzimit dhe në kuptimin social dhe kjo jetë e jashtëzakonshme është bërë sigurimi i ekzistencës së bashkësive të basimtareve.

Cdo pjesë e brezit mbrojtës në jetën shoqërore të të Derguarit të Allahut(s.a.s) është lidhur ngushtë me Allahun Fuqiplote ,duke mos patur asnjë mangësi apo pjesë të keputur. Sepse cdo veprim i tij që nga Adhurimi i Zotit ,të ngrenit dhe të pirit ,të ulurit dhe të ngriturit kalonte në një raport të ngushtë me Allahun. Duke qenë kështu cdo sjellje e thenie e tij gjente mishërim mes shoqeve të tij. Ndjeshmeria e vërtetë në të ceshtjen e të jetuarit të fese të sahabet burontë në të vërtetë nga ndjeshmeria e treguar nga i Derguari i Allahut(s.a.s). Ata kishin ndjekur udhëheqësin shpirtëror dhe drejtuesin fetar të tyre.

Me shpalljen e ajetit”O besimtar! Drejtoju siç e meriton dhe kijeni frikë atë “,të gjithë sahabet nderprehen të ngrenet dhe të pirit. Si mund të ishte e mundur patja frikë nga Allahu në masën e madhështisë së tij? Dhe në vazhdimin e ajetit thuhet: “Ju vdisni vetëm si Mysliman” duke theksuar se nëse nuk kihet frikë Allahu do të jetë e vështirë vdekja si Mysliman.

Në këtë pikë ata nuk dinin në asnjë vend ,vetëm për të falur vinin në xhami dhe pastaj mbylleshin në shtëpi duke adhuruar Zotin dhe kaluar cdo ditë në një gjendje të tillë. Pas një dhjetë ditësh të gjithë ishin dobësuar ,kishin mbaruar sa dukej sikur do vdisnin dhe i Derguari i Allahut(s.a.s) e

kishte vene re kete por nuk dinin shkakun e dyshimit te tyre te papritur. Por edhe ata smund ta shprehnin shqetesimin e tyre sepse kishin frike se mos kishin kundërshtuar ursherin. Me vone zbret edhe nje ajet tjeter qe thote:

“Kijeni frike Allahun aq sa mundeni(Tegabun,64/16). Pas kesaj sahabet moren fryme lehtesisht dhe u qetesuan. Ja pra se sa te lidhur ngushte me Allahun dhe sa te ndjeshem ishin ndaj ajeteve te tij. Ne fakt kjo gjendje vazhdoi edhe per nja dy-tre shekuj me pas.

Duhet te kihet e qarte se menyra e te kuptuarit dhe te jetuarit te islamit si pasuria me e madhe ne jete e jetuar deri ne imtesite me te vogla ,nese nuk shqyrtohet me ndjeshmerine e treguar nga sahabet,ben qe misioni i thirrjes te mos realizohet si duhet.

Ashtu dhe si cdo pergjegjesi tjeter dhe misioni i thirrjes duhet te shqyrtohet si nje teme me vete,por ne ndryshim nga te tjerat thirrja paraqet nje ndjeshmeri. Ajo duhet te jete brenda dhe se bashku me jeten,te jetohet dhe te tregohet dhe te mos ngrihet mbi hipoteza dhe hamendesi. Ne anen tjeter shume figura te shquara qe hedhin drite permes fjaleve te tyre per mese katermbedhete shekuj ne ceshtje te tilla te veshtira gjithmone keshtu kane vepruar. Dhe Zoti per shkak te singeritetit dhe perpjekjeve te tyre te cmuara ju ka mundesuar atyre te jene te suksesshem. Per rrjedhoje nese edhe ne duam tja dalim mbane duhet te shkojme pas gjurmeve te tyre. Hz Omer(r.a) pasi goditet me thike kaloi ne gjendje kome ,qendronte i shtrire duke mos ngrene e pire dicka. Sahabi qe po i sherbente e pyet:”O Omer! A do te hash dicka?” Dhe Hz Omer(r.a)me sy ben shenje mohuese “jo”. Domethene nuk i kishte mbetur fuqi as per te hapur gojen. Ndersa kur i njeiti sahab afron koken te veshi dhe i peshperit : “O Omer! Eshte koha e faljes” ai del nga koma dhe thote “namazi im”. Ai njeri i madh qe ishte goditur me thike gjate namazit dha shpirt duke renkuar namaz. Nje shembull tjeter qe lidhet me kete teme vjen nga nena e besimtareve Hz Aishja(r.a). Nje dite po qante. Kur i Derguari i Allahut(s.a.s) e pyet perse po qante i pergjigjet:”Me erdhi ne mendje ferri ,ndaj po qaj”. Perse? Sepse ajo cdo nate e kishte pare dhe njohur te Derguarin e Allahut(s.a.s)dhe ai e kishte pergatitur dhe edukuar ne kete menyre.

Ceshtja nuk eshte te keshilluarit e vetem te namazit. Ndjeshmerine e treguar ndaj namazit ata e tregonin ndaj fese dhe besimit. Ndaj per te realizuar nje thirrje sa me te dobishme jeta fetare duhet te perjetohet me te njejten ndjeshmeri. Perqendrimi dhe impenjimi dhe impenjimi me i madh ne thirrje nuk duhet te coje ne dobesi veprimet e tjera qe lidhen me besimin por

perkundrazi duhet te kontrolloje kenagesite dhe deshirat tona duke realizuar dhe me me deshire ato gjera qe u themi degjuesve tane. Sjelljet dhe situatat e ndryshme , veprimet qe nuk vertetojne fjale ,cojne ne nje vetemashttrim dhe demtim te pozites se njeriut. Po te shohim edhe Hz Muhamedin(s.a.s) megjithese mes shume problemesh dhe preokupimesh nuk shfaqte as nenvleresimin me te vogel. Megjithese i preokupuar me probleme te ndryshme duke filluar e nje shteti gjigant ne nje kohe te shkurter 23 vjecare ,nga perkujdesja dhe interesimi me te gjithe individet e familjes se tij nuk shfaqte as ndalesen me te vogel dhe pakesimin ne veprimet qe lidheshin me fene.

Perkundrajt sukseseve dhe triumfeve Allahu(xh xh) kerkonte qe te ishte dhe me teper falenderues dhe te lutej me teper,dhe Ai gjithmone vepronte me urdherat e Zotit te tij.

Hz Ebu Bekir(r.a) ndonese luftonte ashpersisht me problemet e ndryshme duke qene tejet i tensionuar por nuk neglizhonte kurre namazin e nates dhe nuk linte mangut ne mes loteve leximin e Kuranit.

Hz Omer(r.a) kishte gjynjehuar perandorine Bizantine dhe te Sasanit por nuk mbeti mbrapa asnjeher dhe ne gjunjezim dhe deshirat dhe epshet e tija.

Hz Omer(r.a) ndersa nga njera ane luftonte me per carjen nga ana tjeter mbante agjirim shtese dhe lexonte Kuran pa pushim. Madje dhe frymen e fundit e kishte dhene ne nje gjendje te tille duke rene shehid(deshmore). Ate dite po agjeronte. Gjaku qe rridhte nga temthat binte si nje vule e perjetshme mbi librin e shenjte. Edhe ajeti mbi te cilin rane pikat e gjakut ishte mjaft kuptimplote,madje dukej sikur i thoshte:"Allahu te mjafton ty!".

Hz Ali(r.a) ishte i ashtequajturi "Hajdari Kerrar" i fushave te betejes qe do te thoshte luani qe lufon pa rreshtur. Por edhe netet e tija kalonin mbi sexhde. Kur thirrej ezani ai zbehej ,zverdhej dhe dridhej si i semure. Te gjithë keta njerez e kryenin detyren e shpetimit pa mangesine me te vogel.

Personi qe merr persiper thirrjen ne fe dhe udhezimin ne rruge te drejte pavarsisht nga mosha dhe nga profesioni qe kane ,per te realizuar ato qe thone duhet te jene serioze dhe te singerte. Ky njeri mund te jete nje sheh ne teqe ,nje imam ose muezin ne xhami, nje mesues ne shkolle apo nje pedagog por mund te jete nje punetor fabrike apo nxenes shkolle. Cdo njeri sipas ndergjegjjes funksionale ,shoqerore dhe njohurive duhet ta cojne ne vend kete pergjegjesi dhe ta kryejne kete detyre pa mandesi.

Aq sa e rendesishme eshte ceshtja e kryerjes se thirrjes dhe shpetimit te njerzimit eshte dhe qenja e udheheqesit shpirteror dhe drejtuesit fetar i singerte dhe i paster. Shenja me dalluese e singertetit te tyre eshte te ndierit ne thellesite e shpirtit e gjerave qe thote dhe te jetuarit ne menyren me te vertete. Thirrja qe nuk shoqerohet me veprime konkrete pavarsisht sesa e suksesshme mund te jete ky sukses mbetet i paqendrueshem dhe ndikimi mund te mos egzistojte ose te jete koheshkurter.

Gjithashtu kjo pune ka nje ane tjeter qe lidhet me jeten e pertejme dhe ajo ajo lidhet me denimin e Allahut. I Derguari i Allahut(s.a.s)na paraqet nje tabllo qe lidhet me kete gjendje keshtu:” Naten e mirazhit takova nje bashkesi,buzet e te cileve pashe qe ju prene me gershere prej zjarri. Pyeta ata se kush ishin. Mu pergjigjen: “Kur jetonim ne toke urdheronim ne te mire por se benim ,ndalonim te keqen per te tjeret por jo per veten”. Tablloja shihet qarte thua se po udhezojme ne te drejte por harron veten dhe nuk kryen vete ato qe thua dhe perfundon ne nje gjendje te tille. Sot ska nevojte per medioker por per njerez qe jetojne ato qe thone dhe ato qe dine. Vetem njerez te tille te zgjidhnin ngaterresat ne horizontin e shpetimit. Te ngarkuarit vetem me libra dhe llafazanet qe flasin dite e nate nuk mund te japin asgje per shpetimin e popullit. Kur perandoria Osmane po shembej biblotekat e saja kishte me qindra e mijera volume librash, por megjithate gjithte ato volume librash smunden ta ndalonin shembjen e atij shteti. Nuk ka ndonje ndryshim mes librave ne ato bibloteka dhe dijes se grumbulluar ne kujtesen e njeriut. E rendesishme eshte venia ne praktike e gjerave qe vete njeriu din.

Ne nje hadith theksohet ky aspekt. Profeti yne(s.a.s) thote: “ Ajo qe me frikeson per popullin tim eshte kundersizimi i dijetareve dhe lajkat e hipokriteve.” Nese dijetari tregon dy ftyresi dhe hipokriti me dijalektiken dhe lajkat mashtrojne ata qe kane perreth ateheret ka ardhur fundi i udheheqesit shpirteror dhe drejtuesit fetar duhet te tregojne shume kujdes ne kete pike. Por fatkeqesisht kjo ka qene thembra e Akilit qe na ka shpetuar shume here nga syte qofte si individ qofte si institucion. Eshte e rendesishme qe ta kujtojme kete kur te mendojme sjelljen e Allahut(xh xh) ndaj nesh.

8. Singertetit dhe pastertia.

Njeriu i thirrjes duhet te ruaje gjendjen patjeter. Me kete nenkuptohet qe ai ne cdo nivel a pozite qe mund te ngjitet duhet te ruaje dhe te mbaje po

ate modesti dhe thjeshtesine si ditën e parë të shërbimit. Pasi modestia është në esencën dhe në bazën e islamit. Në sistemet e tjera individët lidhin marrëdhëniet me njëri-tjetrin në një raport ku gjithshka ka në qendër një “Une”. Për rrjedhojë vendin e modestisë e ze smira, krenaria, egoizmi ndërsa vendin e thjeshtësisë e ze foddulleku dhe të mos paret e tjetër kujt vërtet.

Në natyrën e njeriut ka shumë dobësi që lidhen rreth “Un-it”.

Nëse këto dobësi nuk edukohen siç duhet për të lënë vendin vlerave të larta morale njeriu do të demtohej shumë nga ana e moralit. Për këtë arsye doja të ta thoja në mënyrë të prerë që njeriu që ushqen egoizmin dhe krenarinë mund të bëhet çdo gjë, të arrijë çdo post pozitiv por burrë s'mund të bëhet, thirret në fe dhe udhëheqës shpirtëror. Pasi ai dhe thirrja janë shumë larg njëri-tjetrit.

Njeriu i thirrjes në çdo botë dhe çdo terren, në çdo lloj kushtesh mund të ruajë gjendjen, pa u ndryshuar, pa udehur nga suksesi, pa iu zbehur shikimi dhe mbaron çdo punë si ditën e parë që e ka marrë. Jeta e tij filluar me haster mbaron po mbi haster. Edhe po të ndryshojë botën, dhe të realizojë një revolucion mbare shoqëror, edhe po kjo shtrëngon yjet e qiellit. Poshtë kembeve si një rrugë me gurë dhe sjelljet dhe qëndrimin e tij s'do të shihet ndryshimi as edhe me i vogël.

Sot për këto lloj udhëheqësish shpirtëror dhe drejtuesish fetar kemi nevojë, të afte të tërheqin pas tyre turmë të tëra, të degjojnë zerin dhe të mbledhë rreth vërtet gjithë rrahjet e zemrës. Cilesia me dalluesë e një besimtari të sinqertë dhe të pastër është modestia dhe thjeshtësia. Jeta e tij është mjaft e thjeshtë dhe syri i zemrës së tij është i mbushur me thjeshtë. Ambjenti rreth shtëpisë së tij është i mbushur me këto lloj panorame. Këto cilesi të bukura ai e ka marrë nga Kurani dhe i Derguari i Allahut (s.a.s) këtë mënyrë jetese të pashoqe, pasi dhe Profeti ynë (s.a.s) është sjellur dhe ka jetuar gjithmone në këtë mënyrë. Ai ishte po aq modest sa ditën e parë kur filloi thirrjen në Mekë edhe atë ditë që në ushtrinë e për gatitur në Medinë ai u fut triumfaror në Mekë nga e cila e kishin përzene gjashtë vite me parë. Koka që i prekte krifën e kalit ishte shembulli më spikant i thellimit të tij në thjeshtësi. Kishte etje dhe kerkoi një gotë ujë. Prandaj Zemzem kishte shumë gota që përdoreshim nga të gjithë pa përjashtim. Një prej sahabëve vrapon në një shtëpi aty prandaj dhe mundohet të sjellë një gotë të pastër. Më tejhere i Derguari i Allahut (s.a.s) e ndalon dhe kerkon të jepet ujë në një nga gotat që përdoreshin nga të gjithë. Ai asnjëhere skishte kerkuar të ishte i privilegjuar nga të tjerët dhe shton: “Une jam një njeri si gjithë të tjerët dhe

duhet te pi nga gota qe perdorin dhe te tjeret". Ai kishte kaluar jeten ne nje shtrojete pergatitur nga fijet e hurmave,dhe udhezimi per ne boten e pertejme e beri qe nga ajo shtroje ,e hoqen ate dhe e varrosen poshte saj. Per ne ai vend ku qendron kjo shtroje eshte me e shtrenjte se parajsa. Ne jeten e tij nuk kishte ndonje devijim dhe sipas meje rruga e thirrjes duhet te jete e tille.

Kur Hz Omeri(r.a) erdhi ne pushtet(u be halif) drejtonte nje vend gjashte shtare here me te madh se sipefaqja e Turqise se sotme. Ai pasi hyri ne islam nuk e ndryshoi ritmin e jetes dhe ashtu sikurse ishte me i varferi i Medines halif(sundimtar) edhe ditën qe vdiq ishte me i varferi. Sikurse thuhet rrobat e tija kishin me shume se tridhjetë arna. Ata qe e kerkonin e gjenin te mbeshtetur mbi ne gure varri dhe ashtu mendonte. Kjo ishte menyra e jetese se ketij sundimtari te madhe qe u vinte dhe u hiqte kurorat mbreterve. Kjo ishte ana e tij me mbrese lenese qe mund ta quajme edhe ndikimin e forces se gjuhes se sjelljes.

Hatemul Esam nje nga mesuesit e shkences se hadithit kishte degjuar se Muhamed b.Mukalit nje nga kokat e shkences se hadithit dhe shpjegimit si dhe ai ishte pa qejf. Nga nje propozim i nje miku vendos qe ti beje nje vizite. Se bashku me mikun e tij shkojne ne shtepine e Muhamedit qe nuk ishte shtepi por nje pallat i vogel mbreterish. Hatemi pati nje ngurim te hynte apo jo brenda. Nga insistimi i mikut te tij hyri brenda por u pendua pasi shtepia brenda ishte dhe me e bukur se sa nga jashte. Muhamed b.Mukatil ishte shtrire mbi nje krevat perrallor dhe nje sherbetor po e freskonte duke tundur nje dege palme. Ajo qe po shihte e tmerroi Hatemin. Muhamed b.Mukatil nuk ishte nje njeri normal por nje dijetar me fame ,netet e se cilit duhet te ishin zbukuruar me namazin e nates dhe sexhdeja e tij ishte e lagur nga lotet. Por nga dobesia qe kishte per nje jete luksoze kishte nevojë për tu udhezuar dhe për tju terhequr vemendja. Hatemul Esam ishte i nje niveli qe mund ta bente nje gje te tille dhe mund ti tregonte atij dicka. Per ta nisur filloi me fjalen: "Hadithet qe na transmetoni neve me cfare garancie ju vjen?" Muhamed b.Mukatil duke e kujtuar nje pyetje normale me metoden e hadithit i pergjigjet: "Te gjitha ato qe transmetoj jane te besuara. Une i transmetoj nga filani nje personi shume te besuar." Dhe shtoi: "shehu(drejtuesi shpirteror) im eshte filani". Hatemul Esam vazhdoi ta pyeste:

- Po shehu i tij kush eshte? Ai nga kush transmeton?
- Ai nga i njohuri filan.

- Po ai nga kush?
- Ai nga Hz Aliu.
- Po ai nga kush?
- Ai nga Zoteria yne(s.a.s).
- Po Zoteria yne(s.a.s) nga kush?
- Padyshim qe nga Xhebraili.
- Po ai?
- Dhe ai padyshim qe nga Zoti yne.

Ne kete pike Hetemul Esam vendosi piken aty ku duhej: 'Domethene hadithet ju vijne juve me kaq garanci. A mund te mo thoni nese ka ndonje transmetim mes gjithe haditheve ne lidhje me luksin e te jetuarit ne nje dyshek aq te ngrohte dhe me sherbyes?' Ndersa ai fliste Muhamed b.Mukatil i ndryshonte ngjyra e fytyres. Ata qe ishin prane i thane: "Pusho se do ta vdesesh njeriun e ngrate". Por ai me nje ton te rrepte jua ktheu: "Ne fakt ju po e vrisni duke vepruar keshtu!"

Te heshtesh do te thote tju duash te keqen dhe ti vrasesh ata qe dolen rruges ne emer te thirrjes dhe shpetimit te njerzve por qe me kalimin e kohes nderruan drejtimin e jetes se tyre. Hetemul Esam ate moment beri punen me te cmuar qe duhej bere.

Nje dite Hatem, shkon per vizite te imam Tenafisi nje nga dijetaret me te medhenj te kohes. Duke patur lidhje te afert me drejtuesit e shtetit bente nje jete qe mund te quhej luksose. Hametul Esam i thote: "Zoteri une erdha prane jush te marr abdes dhe tju shohi. Po te kem ndonje gabim me qortoni." I sjellin nje ene me uje dhe nje legen dhe Hatemul Esam fillon te marre abdes por fytyren e lan kater here. Duhet ta lash tre here e kater eshte shperdorim i kote..."

Hatem ate fjale po priste, nderpret marrjen e abdesit dhe ja kthen: "Une lava nje here me shume fytyren domethene nje grusht uje me teper dhe eshte shperdorim? Po ty te jetuarit ne nje shtepi te tille ,ne nje luks e me qylyma te tille nuk eshte shperdorim? Mos ndoshta islami shperdorimin na e ka ndaluar vetem ne abdes?" Tenafisi ishte nje dijetar me emer por edhe nje njeri me viryte ,por lidhjet e ngushta qe kishte me drejtuesit shteteror e kishin nxitur per nje jetese te tille. Duke qene se kjo menyre jetese nuk pershtatej me njeriun e thirrjes ,Hatemul Esam e kritikonte ate duke menduar ta drejtonte ne rruge te drejte.

Ne ditet e sotme ata qe jetojne ne nje jete te tille nga nje keqkuptim shume i gabuar po rreshqasin ne kete mjesis vdekjeprures. Edhe pse nuk e

kuptojne shihet se ata njerez qe se kane gjetur veten e tyre ,pjeset qe ju mungojne ne karakterin e tyre mundohen ti plotesojne permes nje jete luksoze. Kjo buron nga karakteri i tyre i ulet. Njeriu qe eshte njesuar me personalitetin e tij ,nuk jepet pas gjerave te tilla te kota. Gjithashtu njeriu i thirrjes eshte njeriu qe njesuar me personalitetin e tij. Nga ky kendveshtrim nuk mund te mendohet qe ai te mos synoje nje jete luksose te tille. Thjeshtesia eshte nje tregues i madheshtise se dikujt. Njeriu meson te jete njeri me kuptimin e mirefillte te fjales ateher kur ai meson te jete nje njeri i thjeshte. Ai qe jepet pas shkaqeve subjektive ,poziten dhe pasurine qe e bejne ate dikushi kjo con ne mbarimin dhe falimentimin e tij total. Por vlerat e njeriut duhet te burojne nga qenja e tij e brendshme dhe e jashtme me qellim qe shkakot subjektive te mos e demtojne ate dhe ai te mbetet ai qe eshte. Njeriu qe ka gjetur vetveten as qe dobesohet nga arsyet subjektive ,madje as edhe vdekja si ndarje nga njerzitet as qe e cenon fare ate. Shpirti i mijerave i behet atij si mbulese e perjetshme edhe nese ne kete bote ska patur shtepi fare. Mundet qe te kaloje edhe nje jete ne nje shtroje prej kashte. Ai eshte nje vizitor ketu dhe pertej dhe nese nuk do te mund te gjendet nje gur vari per tja vendosur mbi varr...

Shkurtimisht mund te themi se udheheqesi shpirtoror dhe drejtuesi fetar duhet te kalojne nje jete te thjeshte dhe te paster. Si rezultat cfaredo pike qe mund te arrije dhe cfaredo niveli ne jeten shoqerore ata mund te tregojne kujdes per te mos prishur thjeshtesine.

9. Raporti me te pasurit dhe drejtuesit shteteror.

Njeriu i thirrjes dhe udheheqesit ne te drejte me drejtuesit shoqeror si shtresa me intelektuale pervecse nje thirrje dhe nje udhezim ne te drejte nuk duhet te jete shume i futur me ta. I Derguari i Allahut(s.a.s) permes nje hadithi shprehet se me te keqinjte e udheheqesve shpirtoror dhe dijetareve jane ata qe shkojne pas zyrtareve dhe nga zyrtaret me te mire jane tata qe nuk ndahen nga dera e dijetareve. Personat qe udhezojne ne te drejte nuk duhet te kene asnje detyrim ndaj askujt. Ata qe ngopin barkun neper

tavolinat e pasura dhe ata qe servilosën pas dyerve të drejtuesve shteror nuk mund të kenë ndikim as të ata as tek të tjerët. Sepse njeriu duhet të jetë vetëm rob i së mirës. Nëse të pasurit dhe zyrtarët u vijne për vizite me kusht që të mos keqperdoret kjo është një sjellje që duhet kujtuar menderim, sepse udhëheqesi shpirtëror mund të kapë ata për dorë dhe të bëjë të ndjejnë frymen e klimes së përtëjme. Për një shpirt të mbytur mes jetës sociale, tregtare dhe administrative kjo do të thotë një frymëmarrje jetedhënëse.

Kur Omer b Abdulaziz ishte halife (sundimtar i vendit) pranë tij gjendej gjithmone një grup dijetarësh. Ndosëse Omeri bente një jetë edhe më të thjeshtë se e tyre ai nuk harronte të konsultohej me ta. Rexh b Hajve ishte një prej tyre dhe kishte dhe të tjerë që vinin pranë tyre të degjonin. Vete ai thoshte: "Une një orë e kaloja pranë Ubejdullah b. Abdullahut e quaj sa gjithë jeta ime". Degjonte më vëmendje thenjet jetësore të të medjenjve dhe sa mundej përfitonte nga këto biseda të rendesishme. Gjithsesi Omer b. Abdulaziz ishte një dijetar po aq sa njerzit me tecilet bisedonte, dhe kjo e bente të ishte i vecantë. Ai megjithatë qëndroi në pushtet dy vite e pak ai realizoi gjëra sa gjysem shekulli.

Ka prej atyre që kanë shkuar pranë zyrtarëve për tju treguar dicka dhe jua kanë thënë por në vend që të udhëzojnë në të drejtë janë bërë dhe vetë me keq duke humbur çdo vlerë. Në përgjithësi nuk është rruga e të Derguarit të Allahut (s.a.s) të rrish me njerzit e elites shoqërore dhe të takohesh me ta vetëm se të marr malli për bisedat e tyre. Ndoshta dhe në momente jetike dhe kjo duhet bërë, por pa leshuar për dhe duke e ruajtur distancën. Shihni gjatë ditëve në Meke, të parët e kurejsheve ishin paraqitur të i Derguari i Allahut (s.a.s) duke kërkuar që një ditë tua rezervonte atyre. Atë ditë në këtë takim s'do të ishte askush nga Ammari, Bilali, Suhejbi (r.anhum) dhe Profeti (s.a.s) do të bisedonte vetëm me ta. Menjëherë zbret ajeti duke mbyllur çdo shteg për këtë problem ku thuhej:

"Duke kërkuar pelqimin e Zotit tend nga mëngjesi në darkë dhe duro që të jesh me ata që i përgjeronen Atij. Duke kërkuar bukuritë e jetës së kësaj bote mos i ndaj sytë nga ata njerëz. Mos shko pas atyre të cilëve i bëmë të harrojnë të na kujtojnë Neve saqë shkuam me tëj duke u dhënë pas kenaqesive të tyre!" (Kehf, 18/28).

Pastaj shpirti i tij i ndritur ishte shumë larg këtij mendimi. Durimi do të thotë të vazhdojë sic je. Në këtë mënyrë Zoti i thoshte që situata në të cilën ndodhej Profeti yne ishte e pranuar dhe i njoftohej që të vazhdonte detyrën.

Por as qe behej fjale qe i Derguari i Allahut(s.a.s) te pranonte propozimin e idhujtareve te Mekes.

Shkurtimisht ,Zoteria yne Muhamedi(s.a.s) ishte nje udheheqes shpirteror dhe Kurani eshte libri qe na meson neve tekniken dhe metoden me te persosur permes personit te Tij. Nje nga parimet qe praktikohet nga Kurani eshte mbajtja e nje fare distance me klasen e pasur ,nenpunesit dhe ate intelektuale ne nje bashkesi ,ruajtja e nje raporti komunikimi dhe vazhdimi i thirrjes dhe udhezimit ne te drejte pa cenuar gjendjen shpirterore. Neqofte se njerzit tane dote gjejne udheheqes te tille shpirteror ,kane gjetur gjene me te rendesishme. Ne te kundert nese mbetet pas udheheqesve shpirteror te pagdhendur do i duhet te prese edhe shume.

10. Te qenurit insistues.

Insistimi eshte ndermjetes per arritjen e pelqimit hyjnor. Eshte gjithashtu shenja dalluese e sinqeritetit te njeriut te thirrjes dhe dhe sekreti qe ato qe tregon kane gjetu meshirim ne shpirtin e tij. Insistimi eshte shenja dalluese e shqyrtimit me seroizitet sipas madheshtise se ceshtjes qe tregohet.Kuptimi i kesaj eshte ky: Zoti i jep rendesi permendjes nga njerzit te “la ilahe illallah Muhamed e dur-resulullah”(ka vetem nje Zot dhe Muhamedi eshte i derguari i Tij) dhe kerkon qe kjo fjale te zere vend ne zemrat e tyre.Dhe njeriu i thirrjes i kushton jeten kesaj ceshtjeje mjaft te rendesishme para Zotit duke u perpjekur qe te vendose ne zemer fjalet e tevhidit dhe sillet ne pershtatje me madheshtine e asaj gjeje qe dhe Zoti e sheh ate si te rendesishme. Ja pra insistimi ka nje domethenie te tille.Vecanarisht vleresimi dhe pranimi i asaj qe caktohet dhe theksohet si e rendesishme nga Zoti eshte shenje e nje besimi me gjith zemer. Duke theksuar kete fakt ne Kuran thuhet:“Kjo eshte keshtu! E kush madheron dispozitat e Allahut ,ajo eshte shenje e devotshmerise se zemrave.”(Haxh,22/32)I Derguari i Allahut(s.a.s) i nxiste sahabet gjithmone duke ju thene se thenia e fjales tevhidit qe vleresohet shume nga Zoti “Deshmoni me gjith zemer se ka vetem nje Zot dhe patjeter do hyni ne parajse” i larteson ata. Psh Zoteria yne(s.a.s) i kishte dhene Halid bin Validit(r.a) titullin “shpata e Allahut”.Me ane te kesaj I Derguari i

Allahut(s.a.s)uronte qe ne fillim fitoret qe do te arrinte Hz Halid(r.a) ne fushen e betejes. Po ky Halid ,nje dite vret dike ne fushen e betejes qe tha:"Zoti eshte nje" per nje arsye cfaredo. Profeti u merzit aq shume nga ky veprim i Halidit saqe hapi duart dhe ju lut Zotit:"O Zot! Te kerkoj ndjese nga ky veprim i Halidit."Sme harrohet ,nje dite dikush qe pandehte se po luftonte ne rrugen e Allahut me tha: "A e din? Nese nje dite islami triumfon ,ne fillim duhen prere kokat e ketyre njerzve pertace qe mbushin xhamite." Perballe ketyre fjaleve qe ishin vetem shprehje e injorances dhe jo e ndonje asperate. I mjeri mendonte se fjalet qe thoshte ishin ne emer te islamit.Per rrjedhoje udheheqesi shpirteror dhe drejtuesi fetar duhet te insistojne ne ato gjerra qe kerkon Allahu ,pasi kjo tregon sesa e singerte dhe e paster eshte shprehja e tij. Ai qe si kushton gjithë jeten kesaj ceshtjeje smund te jete udheheqes shpirteror,dhe smund te quhen ata qe sbejne dicka te tille. Udheheqesi shpirteror duhet ta tregoje njeqind here dicka ,nese se kuptojne duhet ta tregoje njeqind e nje dhe te filloje ta tregoje nga fillimi. Duhet te prese te piquen kushtet ,te gjeje castin kur degjuesi mund te pranoje ,pa u merzitur ,pa u lenduar dhe nese do i duhet nje jete ,ashtu si dhe profetet. Jeta e profeteve e gjithë qe nje insistim ,pasi ata e shpjegonon te verteten me kembengulje. Dhe i Derguari i Allahut(s.a.s) per 23 vjetet pasi filloi detyren profetike thirri ne ruge te drejte me te njetin perkushtim ,pa pushuar qofte dhe nje moment. Kush e din sesa here i ka vajtur Ebu Xhehilit dhe i ka folur ne emer te islamit. Drejtuesve te Mekes u kishte shtruar gostira te panumerta dhe gjate te ngrenit ne cdo rast qe i jepej u fliste atyre per fene dhe besimin. Edhe sahabet ne te njeten gjendje veprimi dhe kembengulje ishte bere cilesi e pandare e tyre. Dhe te tjeret qe i ndoqen ata ecen neper te njetat gjurme. Ky insistim eshte nje rezultat normal i njeriut qe ben detyren e tij ne emer te thirrjes. Njeriu i thirrjes duhet ta kete te qarte eshte vetem tju tregoje njerzve dhe te mos ofendoje as Zotin dhe as cenoje popullin. Shpetimi i njerzve nuk eshte nje pune qe ai mund tja dale mbane dhe as perfshihet ne detyren e tij. Degjuesi e gjen rrugen e vertete ose jo,ai qe ben thirrjen do ta marre shperblimin e tij. Nga ana tjeter mendimi dhe sjellja e tij jane si nje kod i fshehte qe gjerat per te cilat flet te pranohen. Rezultati duhet pritur nga Allahu(xh xh) dhe kjo tregon se njeriu ka arritur nivelin e duhur te besimit duke qene ky singeritet burim kryesor dhe esenca e te gjitha adhurimeve.

11. Te qenurit me virtyte dhe mosperplasja me karakterin e njeriut.

Njeriu i thirrjes ne menyre te padiskutueshme sduhet te kete perplasje me karakterin e njeriut dhe ne thirrjen qe ben duhet te jete me virtyte e parime. Karakteri i njeriut percaktohet qe ne lindjen dhe formimin e tij. Propozimet qe duhet tju ofrohen njerzve duhet te jene formuluar duke marre parasysh keto ligje parimore. Domethene ne thirrje duhet te merren parasysh disa tipare qe lidhen ne natyren njerzore dhe cdo fjale qe thuhet duhet e thuhet brenda ketyre parimeve dhe normave. Ne te kundert fjalet qe thuhet sado te goditura dhe marramendese te jene mund te mos pranohen nga degjuesi ,i cili keto fjale mund te mos i kuptoje ose i duken si fntazi dhe driteshkurtera(Utopike).

Ja vlen te ndalemi dhe pak ne kete aspekt. Psh te nje njeri ekziston ndjenja e dashurise dhe dashamiresise. Eshte gabim te hiqesh sikur kjo ndjenje nuk ekziston dhe nuk duhet thene njerzve “mos duani”. Dhe nese u thuhet sdo kishte dobi dhe nje propozim i tille sdo ishte i drejte ne baze te parimeve. Gjithsesi udheheqesi shpirteror dhe drejtuesi fetar ndjenjen e dashurise qe ekziston te degjuesi i tij permes keshillave qe i ben duhet ta kanalizojte ne te mire dhe kundrejte nje dashurie te perkohshme dhe te pavlere ti mesoje atij te doje nje te dashur te perjetshem dhe madheshtor. Nese kjo ndjenj edashurie konsumohet kundrejte gjerave te kota behte nje problem per ate,kur drejtohet Allahu(xh xh) behet nje ndermjetsim qe i jep njeriut krahe ne ate drejtim. Domethene jo “mos doni” por do ishte e drejte te thuhej “ta doni te dashurin e per jeteshem ose cdo gje te tij mbi gjithshka”. Per rrjedhoje te dashurit e krijesave te tjera sdo kishte ndonje problem. Permes gjuhes se Junuzit thuhet:”Te duash krijesen per shkak te krijesit.”

Cdo individ ka ndjenjen e inatit dhe kryenecesise ,cilesi kjo qe ndonjehere i fut ne kontradikta njerzit duke i shnderruar ne nje moster. Ne kohen e sotme pas perplasjeve dhe kontradiktave shihet nje ndikim i hapur i inatit dhe merive personale. Ne vendet ku sundon kjo ndjenje ka dhune dhe perplasje nders aaty ku kjo ndjenje nuk ekziston ka nje ekuilibër dhe veprime te matura. Kjo ndjenje qe ne pamje te pare ka shumeane negative. Njeriut i eshte dhene per nje qellim te caktuar. Inati eshte shume i

rendesishem pe te kembengulur ne te drejte ,dhe ne mungese te kesaj ndjenje do te ktheheshim ose terhiqeshim perballe cdo veshtiresie sado e vogel qe te ishte. Pra nese kjo ndjenje do te vihej ne pune ne te mire do tearriheshin rezultate tebukura. Atehere dote ishte me e dobishme tu thuhej njerzve”Perforeni inatin ne perhapjen e te drejtes dhe vertetes”dhe jo” braktiseni ate.”

ne cdo njeri ekziston ndjenja e perjetesise ,por nga ana e materies ai smund te jete i tille. Ai ka nje fillim dhe nje fund. Jeta qe fillon me ngjizjen e spermes dhe te vezeve ndonese qe ne fillimet e saja jep ndjesine e vdekjes ajo nuk mjafton te flake tutje ndjenjen e prjetesise. Kjo ndjenje i eshte dhene atij per nje qellim te larte dhe padyshim eshte fitimi i jetes se perjeteshme. Atehere njeriu duhet ta perdore kete ndjenje per te fituar jeten e perjetshme per te mund te jetuar ne parajse dhe per te soditur madheshtine dhe bukurine hyjnore perjetesisht. Njeriu duhet ta vere ne pune kete ndjenje pasi ne te kundert kjo ndjenje do te kthehej nje kamxhik i dhimbshem qe te kujton qe te kujton mungesen e zgjidhjeve dhe kotesine. Per nje njeri qe vuan ne nje dileme te tille as qe behet fjale te jete i ekuilibruar ,te veproje ne kete menyre dhe te gjeje qetesine.

Te njeriu ekziston edhe ndjenja e njeriut per post dhe pozite. Eshte nje nga dobesite e pakufizuara teshume njerzve eshte arritja ne majen e qellimit te vene para dhe ngjitjes pa fund ne hierarkine e drejtimit. Atehere udheheqesi shpirteror duhet te zbuloje dhe kete ndjenje te njeriut e duhet ti tregoje horizontin qe duhet te arrihet permes kesaj ndjenje. Kjo ndjenje i eshte dhene njeriut “per ta nxitur ate te ngjitet ne shkallet e parajses “. Njeriu ne bote mund te arrije mund te arrije permes kesaj ndjenjeje ne shkallen me te larte te sjelljeve te virtytshme,por gjetja e ndjenjave permes saj ,ndjenja ne pah e forces setyre ,dhe perdorimi ne dobi te personave qe i marrin parasysh ne emer te se drejtes lidhen me virtytin dhe botekuptimin e udheheqesitshpirteror.

Fati i kesaj rruge eshte i veshtire dhe i mundimshem ,ndaj dhe njerzit qe i futen kesaj rruge duhet ta kene kete parasysh qe ne fillim,ashtu sikurse ajo eshte pranuar nga profetet dhe pasuesit e tyre. Sherbetoret e ketij misioni hyjnor duhet te ndjekin patjeter rrugen e ketyre pararendesve te shquar dhe padyshim qe do teperballen me po te njetat veshtiresi dhe mundime. Nese kjo eshte rruga e drejte cdo largim prej saj con ne largimin prej objektivit dhe qellimit kryesor. Ata qe i largohen qelimit kryesor seshte e drejte te quhen udheheqes shpirteror dhe drejtues fetar.

Hz Nuh(a.s) ka vuajtur per shekuj me rradhe. Hz Ibrahim per kete shkak u internua dhemadje u hodh ne zjarr. Hz Musa(a.s) izraelitet nuk i lane gje pa bere. Hz Jahja(a.s) u nda ne dysh ndersa Hz Mesih si qeshi fytyra kurre. Sepse ky mision eshte i veshtire dhe i rende duke qene se behet sfida e vullnetit. Ata qe smund te duan nje fat te tille ,qe smund te perballen medeshire me mendimet dhe veshtiresite as qe mund te ndjekin gjurmet e profeteve ne kete kalvar vuajtjesh. Ne nje moment vullneti i tyre abret ,u dobesohen gjunjet dhe fillojne e i merren kembet.

Haris b.Haris(r.a) tregon:"Po shkoja me babane ne shtepine e Allahut(Qabe). Atehere isha vecse nje femi. Kur po afroheshim atje pashe nje grumbull te madh qe kishin marre ne mes,i ishin leshuar dhe po e godisnin pa pushim dike. Pyeta babane se ke po godisnin. Nje "te besuar" mu pergjigj. Ate dite nuk munda te kuptoja kuptimin e kesaj fjale. Pak me vone pashe qe ai njeri qe po goditej ishte i Derguari i Allahut(s.a.s) qe vazhdimisht thoshe:"O njerez,thoni se ka vetem nje Zot dhe shpetoni".

Kjo ngjarje qe ishte ngulitur ne kujtesen femijerore te Haris b.Haris(r.a) duke lene gjurme ne shpirtin e tij dhe shume ngjarjete ngjashme ne Periudhen e Mekes ishte bere nje pjese e pandashme e jetes se te Derguarit te Allahut(s.a.s) dhe gjithë myslimaneve. Dhe cdo dite e tyre kalonte ne te njeten menyre. Nje here tjeter e kishin sulmuar serish te Derguarin e Allahut(s.a.s) duke e mbuluar ne gjak. Ne moment vrapon e bija Fatimeja(r.a)e cila filloi te qante kur i fshinte gjakun nga fytyra. Megjithate i Derguari i Allahut(s.a.s) mundohej ta qetesonte duke thene:"Mos qaj bija ime,Allahu ska per ta braktisur babane tend."

Nje dite tjeter i Derguari i Allahut(s.a.s) po falej prane Qabes. Ibni Ebi Muajt qe ishte me iekqi ne fisin e tij doli nga pas ,ju lidh pas qafe dhe filloi ta shterngonte. Hz Ebu Bekir(r.a) merr vesh kete dhe vrapon per atje dhe futet mes te Derguarit te Allahut(s.a.s) dhe tyre duke ju thene:"Ju doni ta vrisni kete njeri vetem pse thote Zoti im eshte Allahu".

Hz Ebu Bekir(r.a) kush e di sa here eshte rrahur rrugeve te Mekes aq sa ka humbur ndjenjat nga druri dhe marre perkrahesh nga njerez qe e njihnin dhe eshte derguar ne shtepi zvarre. Fjala e pare qe thoshe sa hapte syte ishte : "Si eshte gjendja e te Derguarit te Allahut(s.a.s)?"

Amonari dergjej ne nje qoshe ,i jati jasiri ne nje tjeter dhe zonja e shtepise Sumeje(r.a) ne nje qoshe tjeter,duke shkruar historine rruges se fatit te tyre ne shtylla mermeri. Bilali(r.a) ndersa renkonte poshte gureve duke thene "Zoti eshte nje,Zoti eeshte nje" dukej sikur tregonte devotshmerine qe

nje dite do te ishte thirresi i pare i Erzanit. Dhe Tallna b.Ubeydullah(r.a)ndersa terhiqej zvarre rrugeve duke patur te lidhur me zinxhir duart dhe kembet nga e ema dhe Zbejr b.Avvom(r.a)ndersa i vihej flaka i lidhur ne shtroja prej kashte sikur pasqyronin ngjyrat e kesaj rruge.

Nje tablo tjeter...Abdullah b.Huzafetys Sehmi(r.a) kishte rene rober i romakeve. E torturuan per dite me rradhe dhe e detyronin tepranonte fene kristiane. Kur sja dolen mbane vvendosen ta ekzekutinin me vdekje,dhe ndersa e conin ne vendin e ekzekutimit ai filloi te qante. Kur e pyeten se pers qante ai qe pergjigjur:"Do deshoroja te kisha jete sa fijet e flokut ne koken time. Cdo dite do te doja ta filloja ne rrugen e se vertetes. Po qaj se me vjen keq qe se kam nje mundesi te tille. Transmetimi i pare tregon ne kete menyre epopene e tij heroike. Nje transmetim tjeter i paraqet ne kete menyre castet e fundit tejetes se tij.

Abdullah b.Huzafe(r.a) me hapa te sigurt dhe me buzeqeshje ne fytyre po ecte drejt vendit te ekzekutimit kur nje prift qe po e ndiqte i afrohet dhe kerkon disa minuta nga ushtaret qe po e shoqeronin. I drejtohet Abdullah b .Huzafese:"Biri im pas pak do te ekzekutohesh. Kerkova disa minuta per ty. Nese per kete bote do te mundem tetregoj per fene e vertete kristiane edhe nese humbet kete bote fiton tjetren. Ndoshta veprimi yt i pelqen mbretit dhetta fal jeten."Abdullah b.Huzafe me nje ze serioz dhe te forte i kthen kete prgjigje:" i nderuar Prift! Nuk e di sesi te te falenderoj dhe ne qofte se do te ma lejonte besimi do te te puthja dhe duart sepse ti me shpetove nga nje hall i madh. Me vinte zor qe te vdisja pa mundur ti tregoja dikujt dicka. Ti tashme po ma jep nje rast te tille. Nese brenda ketyre minutave me lejon te te flas rreth fese se vertete islame dhe nese vdes se kam problem. Ndoshta kjo te ndihmon qe te shpetosh jeten e perjetshme!..."

Prifti dhe te gjithë ata qe ishin aty shtangen nga habia. Asnje prej tyre smundta imagjinonte nje devotshmeri te tille ne besim. Deshira dhe perkushtimi i njeriut te thirrjes duhet te jete si nje diell i pashuar duke patursi qelli mte vertete te jetes ndricimin e ambjentit qe e rrethon. Rruga qe te con drejt suksesit kalon permes vuajtjes dhe mundimit. Kur mbaron nje vuajtje fillon tjetra. Ja nje shembull:

Ndersa ne Medine rezervat shpirterore ishin plot me placka lufte ,i Derguari i Allahut(s.a.s)jetonte ne mungese te gjerave me te domosdoshme. Ndoshta kalonin jave dhe ai nuk vinte kafshate ne goje. Ebu Hurerje(r.a) tregon: "Nje dite hyra ne folene e lumturise te te Derguart te Allahut(s.a.s). Pashe qe po falte namaz nga pozicioni ulur. Pas namazit pyeta: "O i Derguar

i Allahut mos je i semure?” Mu pergjigj:”Jo o Ebu Hurerje,nuk jam semure por jam pa ngrene e skam fuqi.” Fillova te qaja por ai me qetesoi duke me thene:”Mos qaj Ebu Hurerje! Ne ditet e fundit te botes ,tmerri i denimit nuk do te bjere mbi ata qe vuajne nga uria!”

ja pra islami me gjithë madheshtine e tij u ngrit mbi themele jetesore te tilla. Nese edhe nje here do te triumfoje ne zemra do te lartesohej mbi shpatullat e atyre qe perfaqesojne dhe jetojne te njejtin shpirt. Ne te kundert kjo seshte nje pune qe mund te behet nga zoterinjte e lapsit ,kreret e arisokracise dhe ata qe se dine se ceshte vuajtja.

Kete te vertete silide e gjejme ne keshillen qe Hz Lokman(a.s) i ben te birit si nje keshille per te gjithë te rinjte qe jane perfaqesues te kesaj ceshtjeje madhore. Kurani e percakton kete keshille si nje kriter mjaft te rendesishem.

“O bir! Fale namazin sikurse duhet. Urdhero ne te drejte dhe ndalo te gabuaren. Kij durim ndaj fatkeqesive. Ne fakt keto jane gjera te veshtira per tu realizuar.(Lokman,31/17). Permes thenjes se ajetit theksohet se per ate qe fal namazin,urdheron te drejten dhe ndalon te gabuaren e pret nje jete e veshtire dhe e mundshme. Keto jane si dy anet e verteta te nje medalje. Ai qe i ben te dyja do te thote qe eshte drejt rruges qe te con te Zoti. E verteta qe permendet ketu ka tre ane dhete qenurit njeri i mire lidhet me perfaqesimin e te trejave. Sipas mendimit tim kjo eshte rruga e te medhenjeve. Ata qe perfaqesojne kete mision te profeteve duhet te jene bashkeudhetare te se njejtës rruge. Ata qe veprojne ndryshe vecse i jane futur nje aventure. Duhet ti kerkojne ndihme Zotit per te mos u perfshire nga aventurat qe sdihet se kur ,ku dhe per ke perfundojne.

Le te kujtojme qe mos renia ne kontradikte me ligjet e jetes ,te ecurit ne rrugen e thirrjes dhe predikimit te se drejtes duke u mbeshtetur mbi modestine dhe thjeshtesine dhe njohja e personave me te cilet kemi nje raport jane aspekte mjaft te rendesishme. Ne kete aspekt shembulli me i bukur neve na vjen nga i Derguari i Allahut(s.a.s). Nga shume aspekte qe jane si prove e profetizimit te tij njera lidhet ngushte me temen tone ku ai cdo njeri e perdorte ne ate drejtim ku ai kishte me shume prirje. Kjo deshmon aftesine e tij per te njohur njerzit. Kujdo qe ai i ka dhene detyre asnjehere seshte bere hap mbrapa. Kjo aftesi eshte edhe nje deshmi tjeter qe vertetoin ate si te derguar. Psh Hasan b.Sabitin(r.a) ai e perdorte kundra mosbesimtareve ne duelin e fjales. Hasan cdo fjale qe e hidhte si nje shogjete e helmuar godiste aty ku duhej duke e kapur mat personi perballe.

Nese kete orator te fjales do ta perdorte ne fushen e betejes si nje komandant mund te pesonte deme ne duelin e shpates ne lufte.

Ata qe perdori per ti futur njerzit ne rruge te drejte ishin sahabet e ngjashem me Musab b.Umejrin,Musab Xhebel dhe Hz Aliun(r.a) dhe ata kudo ku shkuan arriten fitore marramendese. Nese te njeten detyre do tja besonte halidit ,ai sdo te mund ta perfaqesonte si duhej kete detyre ,sepse ai kishte lindur per te kallur daten trimave ne fushen e betejes. I Derguari i Allahut(s.a.s) e kishte derguar ate vetem ne vende te tille.

Perdorimi i individeve sipas aftesive te tyre eshte nje nga vecorite me te rendesishme te udheheqesit shpirteror. Kjo lidhet ngushte me njohjen e natyres njerzore. Ata qe nuk veprojne sipas dobesive dhe aneve pozitive te njerzve vene ne diskutim arritjen e suksesit te deshiruar. Nese cdo njeri nuk perdoret aty ku duhet keqpedorimi i tyre as qe do ndalet. Udheheqesi shpirteror eshte njeriu qe e realizon kete me se miri. Duke vepruar ne perputhje me natyren njerzore ai dhe mund te realizoje detyrat me te veshtira por dhe arrin ne suksese nje force dhe fuqi te madhe.

PORTRETI SHPIRTEROR I NJERIUT TE THIRRJES

Kapitulli i trete

Ne kete kapitull ndryshe nga ato qe u thane ne kapitullin e dyte ne emer te pershkrimt te portretit shpirteror te njeriut te thirrjes do te permenden disa aspekte duke i shoqeruar me shmbuj per te ndricuar dhe nje here nga nje aspekt tjeter rrugen e ushtareve te shpetimit. Ky kapitull qe do te jepet nen disa tituj kryesore duke qene i lidhur ,portretin shpirteror te udheheqesit shpirteror mund te mendohet si abstrakt(enfusi).

1. Dashuria

Njeriu i thirrjes duhet te jete hero i dashurise para se gjithash. Ai nuk duhet te ndjeke nje rruge te gabuar per te bere te tjeret ta pranojne te

verteten duke perdorur forcen. Qe besimi ndaj Allahut(xh xh) te zere vend ne zemer nje rruge te tille seshte kurre e mundur. Ne rrugen per ti afruar te tjeret ne besim dashuria shkrin zemrat dhe shpirterat duke e pergatitur degjuesin ta pranoje Allahun dhe te Derguarin e Allahut me gjithë zemer.

Njeriu i thirrjes e ben degjuesin te besojë duke e bindur ate ,e me dijen dhe virtytet e tija e magjeps ate pas vetes. Ai qe e sheh dhe njihet me njeriun e thirrjes duke pare cilesite e tij e ka me te lehte ta pranoje dhe as qe mohohet ndikimi qe te pranoje ate qe ai thote. Personat qe frikesohen nga ata qe mundohet ti japin gjerat nen friken e force frikesohen dhe nga te vertetat qe ata thone. Sado te ngrohta dhe jetesore te jene te vertetat qe propagandohen ftohtesia e personave qe flasin ndikon ne menyre negative te degjuesit. Nje veprim i tille me teper se nje ane pozitive eshte shume negativ. Askush ska te drejte ti frikesojë dhe ti largojë nga islami njerzit ,nga gabimet e tija personale.

Dashuria,ashtu edhe si cdo ndjenje e mire ka arritur kulmin me te Derguarin e Allahut(s.a.s). ai e mbeshteti misionin e tij mbi ndjenja te rendesishme si dashuria dhe thirrjen ne fe e realizoi ne nje atmosfere te ngrohte dashurie. Pastaj ai qe thote “une jam per ju si babai per femijen e tij”mendohet ndryshe.

E si mund te jete ndryshe kur ai sapo lindi dote thoshte”Populli im”.

Kjo eshte thirrja”Biri im” e nje babai shume te dhimbshem qe rrit femijet e tij me dashuri dhe perkushtim. Jakupi kishte vetem nje Jusuf ndersa per Ate cdo individ i popullit te tij ishte nje Jusuf...Ai i hapi krahët per secilin nga individet e popullit te tij me dashurine e prindit per femijen e tij dhe ata e deshen ate me teper se prinderit e tyre dhe se vete qenia e tyre. Atehere veprimi qe sjell respekt dhe dashuri duhet te jete cilesi ,vecantesia dhe tipari i pandare i njeriut te thirrjes. Aty ku nuk ekziston dashuria as qe behet fjale per respekt dhe dashamiresi. Me ane te perdorimit te forces mund te realizojme bindjen e njerzve ndaj disa gjerave ,por as qe behet fjale qe permes perdorimit te forces te realizohet pranimi i te vertetave qe ju propagandojne te tjereve. Dashuria ska dere te mbyllur qe nuk hap. Dhe askujt qe nuk shkrihet nga ngrohtesia e dashurise nuk mund te shkrihen me asgje tjeter. Nese njerzit deshironi i lidhni me njeriu tjetrin me nje dashuri te ngrohte per kete qellim dhe ju duhet tju afroheni me dashuri. Pa falur gabimet dhe mangesite e njerzve dhe pa jua treguar te drejten permes dashurise nuk do te mund te zgjidhni asnje ceshtje personale apo sociale.

Profeti yne(s.a.s)mundohet te na paraqise me nje krahasim dhe nje shembelltyre gjendjen e tij kundrejt gabimeve te njerzve.

“Gjendja ime me juve ngjan me gjendjen e njeriut qe ndez nje zjarr dhe mundohet te largoje fluturat dhe insektet e tjera te mos bien ne te ...Edhe une ju kam kapur per dore per tju mbrojtur nga zjarri por ju me shpetoni prej dore.”

Kjo thenie ete Derguarit te Allahut(s.a.s) hap horizonte te medhaja ne emer te thirrjes ne besim dhe nese shkohet ne kete rruge do te kete perkrahje te besimit grupime te medhaja,ne te kundert pikpamjet,medimet dhe te shkuarit ndryshe do te demtoje,dobesoje ceshtjen me per ne keq u kujton disa njerez do te kene nje fund te keq.

Nese do te arrinit te vinit veshin ne dashuri zemres se njeriut te sotem do te degjoni nje rrahje zemre plot dhimbje dhe shqetesim. Askush smund te jete i lumtur teksa lundron mes mekatesh dhe rokulliset ne mes te mjerimit. Me perjashtim te atyre qe kane humbur ndergjegjen dhe kane marre fund si bote e brendshme shpirterore askush sqendron me deshire ne kete mizerabel. Ata kane rene pasi iu jane marre kembet nje here por nuk gjejne rrugen e daljes. Dora juaj e dashamiresise do tju tregojte atyre rrugen e daljes qe kerkon.

Edhe pse personit qe mund ti afroheni me dashuri mund te mos i pranoje per momentin gjerat e matura dhe me dashuri ,si ju dhe ceshtjeve per te cilat i flisni do tju shohe me dashamiresi dhe ngrohtesi. Atehere kur sta merr mendja sheh mijera shembuj kur njerez nga te cilet jane hapur shpresat kthehen ne rrugen e drejte. Duke qene ju shkaku qe ata te gjejne te verteten per gjate gjithë jetes ata do tju jene mirenjohes dhe nga punet e tyre te mira nje pjese do tu shkruhet juve.

Le te mundohemi ta shtjellojme temen edhe permes nje shembulli,le ta supozojme se ka rene nje zjarr dhe njeriu qe ju se pelqeni po digjet me femijet e gjithshka ka. Ose anije eshte fundosur dhe njerez qe ju nuk i njihni jane shperndare neper dete duke pritur tju zgjatet nje dore e ti shpetoje. Perballe kesaj tabloje ju do te veproni menjehere per te shpetuar ate njeri qe po digjet me familjen e tij dhe ata njerez qe po i shihni e po mbyten ne det duke rrezikuar edhe jeten tuaj. Edhe sikur dikush te mendohej tju pengonte ju as qe do ti degjoni fjalet e tija pasi zeri i ndergjegjes eshte me i forte se cdo ze tjeter. Gjithsesi me shembujt qe permendem ju mund te shpetoni vetem jeten e tyre 50-60vjecare. Atehere cili duhet te jete qendrimi juaj kundrejt njerzve kur behet fjale per jeten e perjetshme te tyre? E gjithë

ceshtja eshte te kuptuarit e ketij fakti. Per cdo njeri me shpirt eshte nje detyrim moral qe te mos zemerohet dhe mbaje meri ndaj atyre njerzve dhe te mos i qortoje per veprimet e tyre.

Urdheruesit shpirteror dhe drejtuesit fetar te diteve te sotme duhet ta shohin ceshtjen ne kete aspekt ne nje kohe kur ana morale dhe materiale ,te kesaj bote dhe asaj tjetres te mbare njerzimit po merr fund nen fatkeqesite qe po ju bien. Rrahja zemerimi dhe dhuna si pershtaten udheheqesit shpirteror. Genjeshtat dhe interesat politike duhet tejene shume larg tij. Udheheqesi shpirteror ekziston si besnik i dashurise ,dhemshurise dhe dashamiresise,dhe kjo eshte ajo qe presin shpirtat nevojtare per te shpetuar. Ne kete aspekt i Derguari i Allahut(s.a.s) eshte udherrefyesi dhe udheheqesi yne. Vetem per ti bere nje here njerezit te thone”Zoti eshte nje”ju desh te perballonte dhe te duronte shume gjera.ai gjithmone mendohej per shpetimin dhe madje deshironte dhe hurjen ne parajse te armiqve te tij madje dhe te atyre qe e godisnin me gure,te atyre qe e gjakosnin per vdekje,te atyre qe donin ta mbysnin dhe i hidhnin pislleqe teksa falej dhe te atyre qe hidhnin gjemba rruges nga do te kalonte. Vete ai as qe kishte ndonje perfitim nga kjo pune. Ne Taif Ai ishte goditurmegure duke u gjakosur keqe dhe ishte fshehur ne nje vreshte. Prane tij ishte edhe Zejd(r.a). Engjejt i shkuan ne ndihme dhe i thane se mund te ngrinin dhe malin dhe ta leshonin mbi ate fis arrogant. Por Ai meshirim i gjalle dhemshurie hapi duar njerzore dhe tha:

“Shpresoj qe Allahu nga pasardhesit e tyre(deri dite e fundit)do te dergoje dike qe te adhuroje vetem Allahun dhe te mos i afroje dicka tjeter ne adhurim(te mos beje shirk)” duke kerkuar qe atyre te mos u ndodhte asgje nga veprimet ndaj tij.

Edhe ne fushen e luftes kur i ishe thyer dhembti dhe nje cope e perkrenares i ishte ngulur ne fytyre dhe gati sa nuk shembej perdhe nga gjaku qe ie rridhte nga fytyra,menjehre ai ngriti duart dhe permes lutjeve u mundua te ndalonte ndeshkimin hyjnor. Permes thenies:

“Zoti im udhezoi fisin tim ne rruge te drejte ,sepse ata se dine(per mua)” ai ndaloi fatkeqesine e pashmangshme qe do te binte mbi kokat e mosbesimtareve ku dhe shihet qarte dhembshuria dhe dashuria qe e karakterizonte ate.

Meqe ra fjala do te doja te permendja nje aspekt te trajtuar ne menyra te ndryshme sipas rastit duke qene se lidhet ngushte me temen ne fjale. I riu kur e ka gjetur rrugen ne drejte kur e gjen veten ne mes te drites vazhdon

te jete dite nate ne mesin e njerzve te ndricuar nga drita e besimit. Por ne nje momente gjate debatit degjon gjykimet e krahut tjeter me nje ngarkese emocionale shprehet deri ne "do tju heqesh koken te gjithëve" Nje i ri tjeter me i matur dhe i arsyeshem zbohet nga keto fjale dheme nje ton te ngarkuar emocionalisht ja kthen:

"More shok mos thuaj ashtu. Nese keto gjera qe thua ti do te ishin zbatuar dite me pare une sdo te isha ne mesin tuaj por do te isha nje i mjere qe do te meritonte zjarrin e ferrit. Por ja qe une jam ne mesin tuaj dhe ata njerez qe nuk mendojne si ne kane nevoje per nje sjellje te ngrohte. Per ndryshe do te shkaterrojme shpetimin e tyre ne boten tjeter. Nga kjo as ne dhe as ata nuk kemi ndonje perfitim."

Keto fjale qe u mundova ti paraqes ne menyre e permbledhur jane te thena ne emer te te gjithë rinise qe dergjet nen ethet e mosbesimit dhe kane nevoje per dashurine dhe perkujdesjen tuaj. Permes forces asgje smund te arrihet. Ne duhet te veprojmë jo sipas ndjenjes por me arsye dhe logjike. Thelbesore eshte qe personat e quajtur "kundërshtarë te binden dhe te drejtohen drejt botes shpirtërore. Per nje udheheqes shpirtëror pa renie ne pozite te veshtire kjo duhet te jete metoda qe duhet te ndiqet.

Nje brez po shkaterrohet dhe mbi rruge qe te cojne drejte besimit jane vendosur barrikadat e nevojave dhe epsheve. Ana e tij fizike ka kaluar ne prioritet dhe atij ne emer te fese ,besimit dhe Kuranit sarritem ti mesojme asgje. Tashme ky brez endet si i marre ne kete rreth vicioz. Ky eshte rezultati normal dhe i pritshem. Seshte ky brez i mjere dhe kjo rini e ngrate ndaj te cileve duhet te zemerohemi e merzitemi. Mallkimin e besimtareve e meritojne ata qe i rrokullisen ata ne kete aventure ,pasi cdo gabim eshte i tyre. Nuk them se rinia eshte krejtesisht e pafajshme por perplasja ne fytyre me zemerim e fajesise se saj ska asnje ndikim per ta shpetuar ate. Shpresojme qe sa me shpejt i gjithë ky brez te shpetoje nga ky qorrsoak. Ky eshte qellimi dhe ideali i ekzistences tone. Pertej kesaj nuk kemi asnje mendim apo pretendim.

2. Shpirti i sakrifices

Kjo eshte nje ceshtje qe duhet shqyrtuar me vete por do te doja tju terhiqja vemendjen ne dy pika qe lidhen me te . Shpirti i sakrifices eshte nje nga tiparet me te rendesishme te udheheqesit shpirtëror.ai qe se merr

parasysh sakrifikimin as qe mund te behen njerez te perkushtuar ndaj nje misioni,e per ta as qe behet fjale te jene te suksesshem. Ku duhet do te sakrifikoje pasurine,shpirtin e madje edhe femijet e familjen,postin,famen e poziten e shume gjera te tjera te rendesishme per te ,cdo gje qe mund te jete ideale per te. Ata qe braktisin dhe sakrifikojne cdo gje per nje moment padyshim qe do te triumfojne dhe misioni qe kane marre persiper do te arrije majat.

I Derguari i Allahut(s.a.s) gjate hedhjes se bazave te misionit te tij ne Meke duke filluar nga njerezit me te afert dhederi te njerzit qe ju perkushtuan me mish e me shpirt ketij misioni u injektoi ,u tregoi dhe perjetoi me shembullin personal kete shpirt sakrifice. Psh Hz Hatixhe(r.a) pa i perjetuar(...) per tja ngarkuar Hz Muhamedit(s.a.s) mbretit te kesaj bote dhe tjetres harxhoi te gjithë pasurine e saj per kete ceshtje te shenjte. Te gjithë shpenzimet per darkat dhe gostite qe u shtroheshin idhujtareve te Mekes per tju treguar islamin hiqeshin nga ajo. Kjo grua e nderuar qe para fillimit te shpalljes se islamit ishte nga me te pasurit e Mekes ,kur vdiq si kishte mbetur mundesi te perballonte as leket per qefen.

Eshte tregues tjeter i shpirtit te sakrifies te njeriut te misionit qe pervec se te shpenzoje te gjithë anen ekonomike per ceshjten e tij por edhe te emigroje ne qofte se eshte e nevojshme duke braktisur vendin ku eshte lindur dhe rritur vetem qe te jetoje me mire besimin,mendimet e tija,lirine dhe te shpalose lirshem anet e tija njerzore. Te gjithë emigruan me ne krye Hz Ebu Bekir,Omerin,Osmanin,Aliun(r.a) qofshin te pasur apo te varfer,te rinja apo pleq ,burra apo gra,duke lene vendlindjen dhe gjithshka kishin mizoreve dhe despoteve te Mekes per te marre me vete aq pak sa mund tju duhet rruges. Muhaxhired sakrifikonin keshtu per te jetuar dhe shprehur lirshem misionin misionin qe besonin dhe i kishin dedikuar jeten,Ensarete Medines qe ju hapen krahet dhe i mirepritin perzemersisht duke ndare me ta gjithshka tregonin nje dimension tjeter te sakrifies. Ensaret ndonese ndonese te varfer dhe qe e siguronin jetesen duke u marre me bujqesi priten perzemersisht dhe bujarisht vellezerit ne besim te Mekes.

Ushtaret e devotshem te thirrjes dhe udhezimit ne rruge te drejte duhet te tregojne te njetin nivel dhe botekuptim sakrifice te perfaqesuar nga bashkesia e sahabeve qe ne cdo fushe ishin ne majat me te larta. Ne te kundert ata sdo te arrijne te jene te suksesshem aq sa duhet.

3. Lutja

Lutja per njeriun e thirrjes eshte nje aspekt qe sduhet te mbetet pas cilesive te tjera. Ai pret vetem nga Zoti qe fjalet etija te kene ndikim. Ai eshte zoterusi i gjithshkaje dhe zemrat ne duart e tija jane si rruazat e tespive qe i rrotullon dhe i leviz si te duash. “Nese skeni lutjen, cju mbetet pas?” (Furkan, 25/77). Dhe eshte shpallja hyjnore qe ndikon ne shpirtin e tij.

Ka shume njerez te pandikueshem as nga magjite e fjalet e mrekullueshme qe permes lutjeve te singerta e me zemer te hapur kane gjetu rrugen e vertete. Lutja eshte arma me e fuqishme e besimtarit si dhe vendstrehimi i pare dhe i fundit per njeriun e thirrjes. Ai ne fillim ben lutje e pastaj thote cka per te thene ,por kjo sdo te thote te heqe dore nga te logjikuarit dhe te arsyetuarit. Perkundrazi duhet te kuptoje qe te zoteroje me mire vendin e tyre. Ja dy shembuj qe tregojne me se miri forcen e lutjes.

I Derguari i Allahut(s.a.s) per shpetimin dhe udhezimin ne rruge te drejte te njerzve kishte perdorur cdo rruge te ligjshme, por asnje moment pa hequr dore nga lutja. Psh Ai ishte lutur gjithmone per Hz Omerin(r.a). Kjo mund te quhet begatia e lutjes te te Derguarit te Allahut(s.a.s).

Perseri nje dite tjeter Ebu Hurejre(r.a) vjen tek i Derguarit te Allahut(s.a.s) dhe i kerkon te beje nje lutje per nenen e tij. Sepse deri atehere islami nuk kishte mundur te gjente rruge dhe te hunte ne zemren e saj. Sipas kerkeses se Ebu Hurejres, Derguarit te Allahut(s.a.s) hapi duart dhe u lut: “Zoti im, udhezoje ne rruge te drejte nenen e Ebu Hurejres”. Ebu Hurejre i gezuar del nga xhamia dhe vrapon per ne shtepi kur sa afrohet tek dera degjon zerin e se emes: “Ndalo aty ku je dhe mos hy brenda!” Ndersa Ebu Hurejra po priste jashte degjon zhurme uji dhe mendon se e ema po lahej. Pas pak gruaja e moshuar hap deren dhe shqipton fjalet e shehadetit. Ebu Hurejre spo gabohej, e ema po shqiptonte fjalet magjike duke u futur ne rradhet e myslimaneve. Ndonese ishte munduar shume qe kjo grua te gjente rrugen e drejte, mjaftoi vetem nje lutje e te Derguarit te Allahut(s.a.s).

4. Arsyeya dhe Realiteti

Njeriu i thirrjes ne te njeten kohe duhet te jete njeri i arsyes dhe realitetit. Edhe kur vlereson situatat e ndryshme edhe kur mundohet ti shpjegoje dicka degjuesit duhet ti tregojte gjerat siaps nivelit te personit perballe dhe ta binde ate. Njeriu i thirrjes nuk paragjykohet nga bashkesia ne nivelin e arsyes dhe gjerat qe tregohen pranohen ne po ate nivel. Kur themi keto mos mendoni se e nxisni te jete nje njeri i arsyes por se bashku

dhe me faktoret e larte permendur njeriu duhet te jete patjeter i logjikshem dhe i arsyeshem. Ja nje shembull i goditur nga i Derguarit te Allahut(s.a.s):

Xhylejbib(r.a) ishte nje njeri qe kishte dobesi pas femrave. Kjo gjendje i shqetesonte sahabet e tjere por ja qe atij smund ti thonin asgje, dhe nje dite kete ja tregojne te Derguarit te Allahut(s.a.s). Profeti e therret ate dhe mes tyre zhvillohet kjo bisede. / Derguari i Allahut(s.a.s) pyet dhe Xhylejbib pergjigjet.

-Xhylejbib! Degjova se ngacmon femrat. Pa me thoni a do donit qe te njeten gje tja benin nenes tende?

-Jo sdo doja o i Derguari i Allahut!

-Mos harro se ajo qe ti ngacmon eshte nena e dikujt. Po nese do ja benin motres tende do te te pelqente?

-Jo sdo me pelqente o i Derguari i Allahut.

-Mos harro se ajo qe ti ngacmon eshte motra e dikujt. Dhe Profeti e pyet per shume te afert, nese do ti pelqente ti ngacmonin hallen, tezen e te afermet e tjera te tij por ai ju pergjigj "jo" te gjithave. Atehere i Derguarit te Allahut(s.a.s) duke perseritur edhe njehere fjalet shtoi:

-Ajo qe ti ngacmon eshte halla, tezja... e dikujt.

Xhylejbib(r.a) e kishte kuptuar logjiken dhe ishte bindur. Pas kesaj Profeti ngriti duart dhe beri nje lutje per te. Sahabet betohen se Xhylejbib pas kesaj u be nder djemte me te ndershem te tere Medines. Pas kesaj ai mori pjese ne nje beteje ku ra deshmor(shehit). Ne fushen e betejes secili po kerkonte te afermit e tij dhe u vu rese edhe i Derguari i Allahut(s.a.s) po kerkonte dike. "A keni ndonje humbje?" Pyeti ata qe kishte prane. Dhe ata ju pergjigjen "Jo o i Derguar i Allahut!" Nuk mundi ti mbante lotet dhe duke qare tha: "Por une kam nje!" dhe me dore tregon Xhylejbibin, i cili ishte shtrire mes shtate te tjereve. Profeti iu drejtua atyre "Vrau shtate veta ne fillim, pastaj dhe ate e vrane". Pas kesaj jep nje sihariq per te qe mjafton per te gjithë brezat deri ne ditën e fundit(kjametit) Xhylejbibi eshte nga te mite dhe une jam nje prej te tijeve."

Lutja dhe arsyeja i kishin dhene krahe Xhylejbibit saqe me dy krahët ai me dy krahët ishte bere pjestar i botes se pertejme.

5. Toleranca

Njeriu i thirrjes eshte tolerant. Toleranca eshte nje gjeresi vizioni dhe sdo te thote te leshosh pe ne ceshtjen tende. Nese do mundeshim ta shtjellonim me tej permes nje shembulli. Fjalet qe i Derguari Allahut(s.a.s) ju tha ne clirimin e Mekes atyre qe i kishin perzene nga Meka duke mos lene gje te keqe pa bere ndaj myslimaneve eshte nje nga shembujt me te spikatur te tolerances. Profeti pyet ata se cfare prisnin ate dite prej tij. Dhe ata ju pergjigjen:”Ti je vete toleranca,presim vetem falje.” dhe ata u shperblyen me falje. “Shkoni,sot ska merira...”(Jusuf,12/92) eshte nje thenie qe Kurani e transmeton si nje fjale qe Jusufi jua thote vellezerve te tij. Gjithsesi i Derguari i Allahut(s.a.s)kete tolerance e tregonte edhe ndaj atyre me te cilet skishte lidhje gjaku. Toleranca e Tij eshte edhe me teper sesa ajo e Jusufit.

6. Ndjeshmeria

Njeriu i thirrjes eshte i shqetesuar,devijimi i rruges prej njerzve ,cenimi i urdherave te Allahut dhe ngritjet koke ndaj tij e preknin ate ne thellesite e shpirtit. Devijimet e perthyejne ate,dhe kur e kupton se smund te beje asgje pasi i ka duart e lidhura lendohet dhe merzitet sa me ska. Permes shprehjes se Kuranit drejtuar profetit”Per shkak se ata nuk besojne po e mundon shume veten”(Shuara,26/31) tregohet mese qarte gjendja shpirtore qe perjetonte i Derguari i Allahut(s.a.s)nga shqetesimet ne emer te thirrjes. Kjo gjendje shpirtore e shkaktuar nga shqetesimet dhe brengat duhet te jete ne cdo njeri qe kryen misionin e thirrjes.

Devijimi eshte largim nga feja. Nga kjo murted quhet njeriu qe mohon cdo gje te shenjte qe ka besuar me pare,dhe ne nje ane tjeter ky person ka tradhetuar myslimanet. Ai qe tradheton nje here si zihet bese pasi mund ta beje serish,ndaj dhe sipas nje pjese devijuesi(murtedi) nuk ka te drejte te jetoje me. Sipas dijetareve te legjislatures islame pavarsisht se per cfare arsyeje ka devijuar para se gjithash ajo ceshtje duhet ti tregohet edhe nje here deri ne hollesite me te vogla. Duhet te ndiqet nga afer per nje fare kohe dhe te sqarohet per gjerat qe ka te paqarta. Nese te gjitha ato perpjekje nuk sjellin me dobi dhe ai behet nje gangrene ne strukturen e besimit duhet trajtuar ne nje menyre tjeter. Asnje besimtar nuk duhet te qendroje indiferent perballe devijimit ose keqinterpretimit te dikujt tjeter,pasi kjo bie ne kundërshtim me botekuptimin per ti keshilluar njerzit ne te drejte te fese islame. Cdo besimtar qe degjon nje ngjarje te papelqyeshme sipas nivelit te botekuptimit te tij duhet te shqetesohet dhe te brengoset. Brengosja e njeriut

te thirrjes duhet te jete me e thelle se e cdo njeriu tjeter,sepse shpetimi i gjithë njerzve eshte qellimi kryesor i jetes se tij.

Ja reagimi i te Derguarit te Allahut(s.a.s)perballe nje ngjarjeje qe i kishte ndodhur Halib b.Velidit(r.a). Hz Halid ne nje ceshtje devijimi rreth fese nxitohet ne vleresimin e rrethanave dhe kryen nje ekzekutim. Kur i Derguari i Allahut(s.a.s) degjin kete merzitet dhe i drejtohet Zotit permes nje lutjeje:

“Zoti im te kerkoj ndjese nga ky veprim i halidit”. Kjo ndjeshmeri e te Derguarit te Allahut(s.a.s)gjente meshirim edhe te ata qe ishin rreth tij. Psh kur po ktheheshin nga beteja e Jemames Hz Omer(r.a) shqetesohet dhe pyet”Cfare i bete atij?” Kur personi i pergjigjet “E vrame Hz Omer(r.a) sikurse i Derguari i Allahut(s.a.s) i merzitur ja kthen atij.”A nuk duhej qe ta burgosnit diku dhe te prisnit per nje fare kohe?” Pastaj hap duart dhe i drejtohet Allahut me nje lutje :”Zoti im,betohem se kur keta kane bere kete veprim une nuk isha prane tyre dhe betohem se smu be qejfi kur e degjova.

7. Pasuria shpirtërore

Njeriu i thirrjes nete njejten kohe duhet te kete nje pasuri shpirtërore,fjalet e udheheqesit shpirtëror gjenden ne masen e pasurise shpirtërore qe ai zoteron. Sa me afer ti afrohet Zotit aq me teper Ai e afron me veten sase ai person behet syri i tij,qe sheh ne cd ovend,veshi qe degjon,dora qe mban dhe burimi kryesor i cdo levizjeje te tij. Pra cdo veprim i atij udheheqesi shpirtëror ndodh ne perputhje me fjalet e Allahut,dhe sa me teper ai te veproje ne baze te tyre qe ai din Zoti i meson ato qe ai si din duke e afruar edhe me shume me te drejten. Nje person i tille mund ti zgjidhe me lehtesi dhe problemet me te veshtira dhe te nderlikuara. Duke patur nje sjellje te tille ne vazhdueshmeri ai gjen vendin etij ne shoqeri duke u bere edhe nje perfaqesues i nje rruge te drejte. Nje njeri i ketij niveli vazhdimisht merr frymezime te shenjta dhe hyjnore. Duke vazhduar udhezimin ne rruge te drejte nen ndikimin magnetik kte frymezimit te tij behet nje vendpushim hyjnor drejt se cilit do te vrapojne kmijera e madje qindra mijera persona. Kjo terheqje e jashtezakonshme e tij buron nga pasuria shpirtërore qe ato zoterojne. Nje udheheqes shpirtëror qe arrin kete nivel zoteron nje force te jashtezakonshme duke arritur forcen magjepsese te njerzve te mire qe do te thote se besimi i tij ka arritur piken me te larte./ Derguari i Allahut(s.a.s) ne nje hadith shprehet:”Njeriu i mire ne teresi eshte vete besimi”. Ky njeri i mire paisi mendjen me forcen e argumentit ,logjiken me forcen e arsytimit,ndricon mendimet dhe opinionet me frymezim ,forcon nefsin e tij

me adhurim dhe lutje dhe zemren e kontrollon dhe mban nen mbikqyrje duke u bere nje person i denje ne rrugen e drejte. Personi qe arrin nje vetedije te tille jo vetem qe ska frike prej ndonje per soni tjeter por as qe var shpresen e spret gje nga te tjeret ,pasi gjithshka ai e pret vetem nga Allahu,sepse eshte i vetedijshem dhe i ndergjegjshem se e keqja dhe e mira vine vetem prej Tij.

Njeriu qe arrin kete shkalle te larte besimi eshte pa brenga e pa ndroje. Ai e pret vdekjen duke qeshur, madje edhe kur eshte ne kete bote ai jeton tjetren. Esthe i vetedijshem se duke hypur ne mjetin e vdekjes do te shohe vendet te cilat i mungojne ndaj dhe eshte gjithmone i lumtur. Ne permbajtjen e nje hadithi keta njerez tregohen keshtu:”Ne mesin e popullit tim ka prej atyre qe jane te lumtur(shprehje e mirenjohjes se te mirave nga Allahu)mes njerezve ,por qe naten e kalojne ne lutje e adhurim te thelle.(Kjo si shprehje e frikes se madheshtise ndaj Allahut). Trupi i tyre ecen neper toke,ndersa shpirti endet neper qiell.”

Per cdo udheheqes shpirtoror duhet te jete nje qellim jetesor qe te arrije nivelin e njerzve te tille ku ne botekuptimin e tyre te jeteoje kjo bote dhe ajo tjetra. Ky eshte tipi i udheheqesit shpirtoror qe ne presim. Eshte ky udheheqes shpirtoror qe sjep pas kesaj bote as edhe nje grime dhe po te mos jete detyra e udhezimit te njerezve ne rruge te drejte as qe qendron te jetoje as edhe nje cast ne kete bote te kote. Ky eshte udheheqesi shpirtoror me aroren e Isait(Jezuesit)dhe kulturen dhe moralin e Muhamedit. Ne fakt cdo udheheqes shpirtoror duhet te jete i tille.

Tregon Tahirul Mevlevi qe komenton Mesnevine.”Ne burg isha se bashku me Atif Efendiun prej Iskilipi. Profesori njihte mire kulturen e kohes dhe ishte njeriu i penes. Per seancen e fundit gjyqesore po pergatiste aktmbrojtjen. Diten tjetere do te dilte para trupit gjykues dhe dihej se ce priste. Pas faljes se mengjesit e bere cope cope aktmbrojtjen dhe e hodhi ne koshin e plehrave.”Cfare ndodhi,perse e grise?”e pyeta . Me dha kete pergjigje:”Sonte ne enderr pashe Zoterine e Universit. Une isha ulur e po shkruaja aktmbrojtjen. Mu drejtua duke me thene:”Atif,ceshte ky ngurim? Apo sdo te vish nga ne?” E une i thashe:”E si nuk dua o i Derguar i Allahut.” Tashme e kuptova se kishte ardhur koha te shkoja te Ai,e cme duhej aktmbrojtja.”

Ne seancen gjyqesore te asaj dite jepet denimi kapital me vdekje per Atif Efendiun,por ai ishte shume i qete dhe vendimin per vdekje e priste duke qeshur. Denimi qe i jepnin garantonte takimin me te Derguarin e

Allahut(s.a.s). E si te mos gezonte njeriu qe garantonte nje fat te tille? Perse te mos jete i qete njeriu qe ecen rruges qe e din te drejte ku cdo largesi sheh pelqimin e Allahut,ai qe cdo hap beson qe i afrohet me shume te Allahut dhe te Derguarit te Tij. Nje hero i tille mund te vritet por nuk mposhtet kurre. Njeriu i thirrjes qe te arrije rezultatin qe ai deshiron duhet te ruaje gjithmone kete pasuri dhe kete drejtesi shpirtore. Personi qe i kushtohet Allahut dhe vetem punon qe te siguroje pelqimin e Tij,nese sja arrin sot padyshim qe ne nje te neserme do tja arrije deshirat dhe aspiratat e tija. Por cfare humbet ai qe ka gjetur Ate?... ne te kundert ai qe se ka gjetur Ate dhe sikur gjithë bota te ishin e tija cvelre do te kishte? Gjithsesi a nuk eshte shpirti i drejte dhe zemra e paster qe na cojne te Zoti yne? Pastaj pse duhet tju kushtojme shume rendesi gjithë atyre gjerave e puneve qe ne fund te fundit skane asnje pike vlere? Lutja dhe deshira jone ndaj Zotit eshte qe deri sa te shkojme te Ai te na ruaje me nje zemer te paster dhe shpirt te drejte. Ai eshte Zoti yne meshira e te cilit eshte gjithshka. Ndaj dhe shpresojme vetem deshiren dhe kerkojme pelqimin e Tij.

8. Mali dhe Deshira.

Njeriu i thirrjes duhet ta realizoje thirrjen per mes nje deshire dhe dashurie jetedhenese madje thirrja te jete nje tundim i parezistueshem. Kjo vecori eshte kriteri me i domosdoshem qe duehte te ndjeke njeriu i thirrjes. Shihet qe eshte shume e veshtire te ndiqet ky kriter madje arrihet shume vone.

Neqofte se Profeti yne(s.a.s)sdo te kishte zgjuar kete ndjenje ne bashkesine e tij,domethene nese sdo ti bente ata te apasionuarit per te treguar te drejten dhe te verteten ,per shume arsye kjo bashkesi sdo te mund te realizonte si duhet ate mision historik. Halid b.Velid(r.a) kur do te gjendej perballe komandantin bizantin para se gjithash do te ftonte ate qe te pranonte islamin. Nje perpjekje per ti futur ne te drejte para se ti flisnin shpatat me cfare mund te shpjegohet tjeter vecse me faktin qe deshira per ti futur njerzit ne besim kalonte gjithshka tjeter? Ndikimi i kesaj deshire dhe dashurie ishte kaq i madh sa do ti detyronte disa sahabe qe te udhetonin ne kater anet e botes. Ja nje prej tyre:

Hubejb(r.a) ishte kapur dhe derguar ne Meke. Pasi e lane ne burgje per shumeditë me rradhë e nisen per ta ekzekutuar per mes zhurmes se pakuptimte te asaj dite. Ishte i merzitur dhe i brengosur pasi kishte arritur te kryente detyren te cilen i Derguari i Allahut(s.a.s) jua kishte ngarkuar atyre. Tani me duar e goje te lidhur po cohej drejt ekzekutimit me vdekje. Hidhte pa pushim syte perreth dhe kerkonte dike qe ti fliste rreth besimit. Por mes atyre qe kishte perballe nuk kishte njeri te tille. Ne fakt mes atyre gjendeshin dhe sahabet e se ardhmes,por qe akoma nuk u ishte hapur syri i zemres gjer ate dite. Hubejbi fali dy vakte namaz dhe shtoi:”Po te mos druhesha se do te thonit se u frikesua nga vdekja dhe zgjati faljen e namzit do ta zgjasja namazin e fundit.” Pastaj doli ne fronin ku do kryhej ekzekutimi. Po afrohej casti i ekzekutimit dhe skuadra e ekzekutimit me shtiza qe kishin filluar levizjen tregonte kete. Hubejb hidhte syte perreth por nuk kerkonte ndokend qe ta shpetonte nga vdekja,kurrsesi por kalonte neper mend nese ne momentin e fundit mund te shpetonte jeten e ndokujt. O Zot i madh sa e veshtire qenka te vdesesh para tyre pa mundur te besh dicka per ti futur ata ne rruge te drejte! Ne ate cast lindi casti i shumepritur. Nje nga paria e idhujtareve te Mekes i beri nje pyetje qe ne pamje te jashtme ishte pa rendesi. Por ai do te jepte nje pergjigje aq te goditur saqe necastin e fundit do te arrinte te bente dicka per ti udhezuar njerzit ne rruge te drejte. Nje mendim i hedhur aty kush e di ne te ardhmen ne sa persona do te arrinte te ndizte zjarrin e besimit. Pyetja ishte e tille:

“ O Hubejb ,ne kete cast a nuk do deshiroje te denohej Muhamedi qe te shpetoje ti?”

Sigurisht qe nje pyetje e tille nuk i behej nje myslimani e me pak nje njeriu si Hubejb. Po ai mundohejte shfrytezonte rastin qe i jepej nga kjo pyetje. Ishtëe mjaft i gezuar dhe do te mundohej te thoshte dicka mes nje ndjenje gezimi e hidherimi, dhe e dinte gjithashtu se kjo pergjigje do te ishte e shkurter si dhe namazi qe fali. Ne nje pergjigje nje fjale duhej te perfshinte gjithë jeten. Duhej te pergjigjej ne ate menyre qe historia te heshtete per ta degjuar dhe koha ta mbante te varur vath ne vesh. Ai duhej te fliste mjaft goditshem duke e vleresuar si duehej kete rast. “Jo per Zotin. Jo me te denohej qe te shpetoja une por sdo doja ti futej nje gjemb ne kembe ne Medine qe te shpetoja une!” Do te ishte pergjigja e atij njeriu besnik. U lartesofohsh o shpirt i shenjte!

Permes ketyre fjaleve Hubejbi kaloi dhe shqetesimin qe lidhej me mos realizimin e thirrjes ne rruge te drejte. Tani ai ndihej i lehte sa nje pupel.

Permes kesaj detyre te fundit ai do ti dergonte pershendetjet e ndarjes te Derguarit te Allahut(s.a.s) duke acur drejt parajses. As qe e kaloi neper mend qe pershendetja e tij do te kalonte nga Meka ne Medine. Sepse pershendetja i dergohej personit qe ishte Profeti famelarte i Allahut.

Fjalet e fundit ne vendin e ekzekutimit ishin:”Paqja e Zotit qofte me ty o i Derguar i Allahut.” I Derguari i Allahut(s.a.s) ne Medine i rrethuar nga sahabet e tjere do ngrihej ne kembe dhe do ja kthente:”Paqja e Zotit qofte edhe me ty o Hubejb.”

Njeriu i thirrjes permes deshires dhe mallit te thirrjes duhej te kape horizontin e Hz Hubejbit qe ti thote ndal rrjedhes se gabuar te historise dhe te fitoje te drejten e trashegimitarit mbi toke duke futur rrjedhen e kohes ne trajektoren e saj te duhur.

9. Pastertia e zemres dhe drejtesia e shpirtit.

Njeriu i thirrjes gjate misionit te tij duhet te karakterizohet nga nje pasterti e brendshme dhe drejtesi shpirtore. Duhet te mbarte nje zemer ne pershtatje me pastertine dhe kthjelltesine e ketij misioni. Ne te kundert po aq sa trazohet shpirti ,nderpret raportin qe ka me Zotin dhe humbet forcen e ndikimit. Mund te shpjegojme keshtu kete,pervec pelqimit hyjnor njeriu i thirrjes ne misionin e tij as qe duhet te pretendoje per dicka tjeter. Per sa kohe ai vepron keshtu do te ndjeje prane ndihmen dhe pranine e te Derguarit te Allahut(s.a.s) dhe gjithë njerzve te medhenj te tjere. Per kete askush te mos kete dyshimin dhe medyshjen me te vogel. Per te arritur nje prodhimtari per nje njemije nga farerat qe hidhen duhet te mbeshtetemi ne forcen hyjnore. Trokitja ne dyert e tjera shton me teper shqetesimet dhe problemet.

Ne fakt besimi yne i kushtezon gjerat ne kete menyre. Ne qenjen e tij Zoti duke mos patu partner dhe ne veprime ai ska te tille. Ndaj dhe te drejten dhe te gabuaren ai i ka krijuar vete.

Ai ke do don e larteson dhe ke don e fundos sikurse dhe triumfuesi dhe humbesi varen nga dora e tij.

Vertete qe eshte e veshtire te kesh nje menyre jetese te drejte por edhe shperblimi per kapercimin e kesaj pengese te pakalueshme eshte mjaft i cmuar. Ebu hanifi ai iman(udheheqes fetar)i madh qe refuzoi postin me te

larte te gjykatesit vetem qe te ruante pastertine e zemres dhe drejtesine e shpirtit. Ai renkonte nen goditjejt e kerbacit por e refuzoi propozimin qe e shihte si kushtin e shpirtit. Dhe iman Shafia beri ceshte e mundur per te mos u perballur me nje propozim te tille. Ai kishte pranuar te jetonte i thjeshte mes njerzve duke refuzuar cdo post apo pozite me gjithe presionin e vazhdueshem. Per kete arsye detyrohej te kalonte nje jete me probleme. Kur vinte sa ketej andej mundohej qe te mos e shihte njeri dhe te jetonte pa e ditur kush se ku rrinte duke u ruajtur qe te mos kishte fatin e imanit te madh.

Perpjekja qe iman Ahmed b.Hanbel dha per hire te Kuranit asnjehere smund te fshihet nga kujtesa e historise. Ai ishte shprehur qe “Kurani seshte krijese” dhe per gjithe jeten kishte jetuar me kete fjale. Po te perdorte fjale me politike ai do ta kalonte kollaj kete problem por ai as qe mundohej fare.

Ai na tregon nje kujtim te tijin keshtu:

“Ditet e para ngaqe smund te duroja goditjet e kerbucit bertisja. Nje here ne burg sollen nje grabites i cili me tha nje dite:”O iman! Ty te kane sjelle ketu per dicka qe ti e din se eshte e drejte dhe bertet kur te godasin. Ndersa mua me kane sjelle per nje faj qe seshte i drejte ,dhe ndonese me godasin sa dhe ty as qe e kam nxjerre zerin e gojes.” pas asaj dite sa here fillonin te me godisnin me vinte ne mendje fjala e atij grabitesit dhe shterngoja dhembet dhe kur dhimbjet arrinin kulmin as qe nxirrja zerin e gojes fare. Ky iman i nderuar kush e di se sa dite e sa muaj ka kaluar ne mes te dhimbjeve e te mundimit por edhe ne momentet me te veshtira kur e linin forcat dhe fuqite ai mundohej te ruante forcen e logjikes ,dhe te mos toleronte as edhe nje fjale te vetme nga fjalet nga fjalet e thena ne fillim ,duke shfaqur nje heroizem te jashtezakonshem. Ne ate kohe iman Shafiu jetonte i fshehur. Nje nate ne enderr sheh Profetin i cili i thote atij:”Coji te fala Ahmed Hanbelit. Thuaji te duroje edhe pak se se shpejti d ote vije tek une.”

Iman Shafiu menjehere dergon ne burg nje nga njerzit e tij pasi ai e kishte te veshtire te shkonte. Me lajmetarin i con dhe nje kemishe dhe i thote:Le ta veshe imani kete kemishe qe lekura e tij ta preke ate.” Lajmetari shkon te Ahmed b.Hanbel dhe i dergon te falat e te Derguarit te Allahut(s.a.s) dhe ai pothuajse i harroi lutjet dhe i dolen lote nga gezimi. Iman Shafiu qe e mori prapa kemishen qe i kishte derguar Ahmedit fshiu me te fytyren dhe tha:”Fytyta qe u fshi me kemishen qe ka prekur trupin e iman Ahmed b.Hanbel ,shpresoj(inshallah) te mos preke zjarrin e ferit.”

Perfundimi

Duke i paraqitur te perbledhura ne ceshtje ato qe treguam deri ketu ne lidhje me

metoden e thirrjes ne islam dua ta perfundoj kete liber:

1. Thirrja dhe udhezimi ne rruge te drejte eshte detyra me e shenjte. Pasi dhe Allahu(xh xh) roberit e tij me te zgjedhur Profetet i ka derguar me kete detyre.

2. Thirrja ne situata normale eshte nje domosdoshmeri e natyrshme por ne ditet e sotme kur shume ceshtje po lihen pas dore ajo behet me e domosdoshme se cdo gje tjeter. Lenia pas dore e saj eshte e papranueshme.

3. Personi qe vdes duke e lene pas dore kete detyre mbart shqetesimin qe mund te kete vdekur ne kundershtrim(nifak). Sepse ky person ka braktisur detyren me te rendesishme dhe me te dobishme se cdo obligim personal.

4. Bashkesia ne gjirin e se ciles praktikohet kjo detyre eshte e siguruar nga fatkeqesite dhe katastrofat tokesore dhe qiellore. Nese brenda saj ka qofte edhe 3-5 njerz qe mund te bejne kete detyre te shenjte Zoti e merr nen mbrojtjen e tij ate bashkesi. Ne te kundert rezultatet jane negative. Zoti ka mundesi ta shkaterroje ate bashkesi ne te cilen kjo detyre e larte nuk kryhet. Shkaterrimi total i bashkesive dhe shoqerive ne histori jane nje shembull i qarte i kesaj.

5. Kjo detyre duhet shqyrtuar ne planin personal ,te pergjithem e shteteror. Myslimani eshte baza kryesore e rregullit boteror. Sikurse smund te kete rregull aty ku seshte ai ashtu edhe aty ku behet fjale per pranine e tij smund te kete arrarshi dhe terror. Kjo lidhet me faktin se sa myslimani mund te realizoje si duhet detyren e thirrjes.

6. Eshte tregues i besimit urdherimi i gjerave te mira dhe ndalimi i gjerave te keqija. Kjo detyre nuk mund te mendohet e ndare

nga besimi. Ne thenjen Kuranore(Tevbe,9/71) duke permendur se besimtari eshte mik ndaj te tjereve thekson kushtin se ku mbeshtetet kjo miqesi dhe i kujton se kjo lidhet ngushte me kete detyre te shenjte mes te shejtave. Ndersa idhujtaret dhe mosbesimtarete thuhet(Tevbe,9/67) se jane i njeiti lloj por sjane miq te njeri-tjetrit, pasi pengojne te miren duke stimuluar dhe nxitur te keqen.

7. Feja islame eshte nen mbrojtjen e Allahut(xh xh) dhe Ai do ta ruaje vete fene e tij. Kjo mbrojtje lidhet me daljen ne mbrojtje dhe perkrahje te fese nga njerzit qofshin keta burra apo gra. Perkrahja e fese ne menyren me te qarte eshte realizimi i detyrave te thirrjes te individeve mysliman.

8. Thirrja ,vepra(punet) dhe thirrja jane tre fytyrat e ndryshme te nje vertete. Seshte e mundur ti ndash nga njera-tjetra. Ne thirrje dija eshte kushti kryesor ndersa veprat jane jeta e thirrjes.

9. Njeriu i thirrjes duhet te njohet mire epoken e qe jeton dhe te vertetat e islamit. Ai qe se njeh kohen do te thote qe jeton ne nje bote iluzionesh. Dhe eshte perpjekje mjerane per ti terhequr njerzit dhe per tu folur per iluzione e gjera te paqena.

10. Njeriu i thirrjes duhet ta pershtase zemren e tij sipas Kuranit. Ai qe sarrin te beje nje akordim te tille eshte e veshtire dhe madje e pamundur te flase per te vertetat dhe ne emer te islamit.

11. Njeriu i thirrjes gjate thirrjes duhet te tregojte kujdes me qellim qe rruga e ndjekur te jete e pranueshme dhe ligjore. Pasi objektivi i pranueshem arrihet vetem permes nje rruge te pranueshme. Kjo ishte edhe rruga e ndjekur nga i Derguari i Allahut(s.a.s) dhe nga sahabet e nderuar. Ne skemi nevojte per aktiviste qe per te arritur qellimin perdorin cdo rruge si te pranueshme por na nevojiten njerez thirrjese me shpirtin e sahabeve qe i shqyrtojne gjerat ne hollesine me te vogel dhe i vene ne praktike. Keta te fundit jane ata qe do ta mbajne ne kembe kete fe duke e cuar ne kater anet e botes.

12. Njeriu i thirrjes duhet ta jetoje patjeter ate qe flet. Ne te kundert behte fjale per nje tregues hipokrizie,ndaj dhe besimtari duhet ti shmanget nje situate te tille. Ne fjalet e njeriut qe se perjeton ate qe e flet ska dobi dhe ndikim. Ata digjen si flaka e kashtes dhe shuhet shpejte. As qe behet fjale qe te kete energji per ngrohje.

13. Njeriu i thirrjes duhet te ruaje gjithmone modestine dhe thjeshtesine. Ky eshte nje veprim i njerezve fisnik. Besimi eshte vete

fisnikeria. Atehere njeriu i thirrjes duhet te veproje me fisnikeri si cdo besimtar. Ky ishte morali i te Derguarit te Allahut(s.a.s).Njeriu i thirrjes duhet ta beje pjese te karakterir kete moral.

14. Njeriu i thirrjes pervecse per ceshtje detyre nuk duhet te jete shume i afrueshem me drejtuesit shteteror dhe klasen intelektuale. Korrektesia ne kete aspekt eshte nje kusht i rendesishem per ruajtjen e nderit dhe gjendjes se tij.

15. Njeriu i thirrjes duhet te jete kembengules ne thirrje. Kembengulja eshte shprehje e respektit dhe e vleresimit kundrejte ceshtjes se tij. Dhe ai eshte i detyruar te pranoje dhe te ndjeke ato ceshtje qe Zoti i konsideron te rendesishme. Ne te kundert do jete ai qe do pergenjeshtroje vetveten.

16. Njeriu i thirrjes sduhet te perplaset me ligjet e krijimit(natyrore). Ai duhet te jete racional gjithmone ne thirrje dhe udhezim ne rruge te drejte. Seshte e drejte te anashkalohen disa deshira dhe dobesi prezente te njeriut. E rendesishme eshte qe keto deshira dhe dobesi te kanalizohen me te miren dhe te bukuren.

17. Vuajtja dhe mundimi jane fati i pandryshueshem i rruges se thirrjes. Njeriu i thirrjes qe ne fillim duhet ta pranoje fatin e tij.

18. Njeriu i thirrjes duhet te jete hero i dashurise. Nuk duhet te mendohet nje rruge per ta pranuar te drejten duke perdorur forcen fizike.

19. Nje vecori e rendesishme e njeriut te thirrjes eshte shpirti i sakrifice. Njeriu i thirrjes duhet te kete karakterin e nje dishepulli apo apostulli. Ata qe sjane te lindur te tille qe ne fillim as qe mund te vdesin si njeri i thirrjes me nivel. Nje pune e tille para se gjithash kerkon sakrifice.

20. Njeriu i thirrjes duhet te jete i njesuar me lutjen. Lutja eshte bota e afersise dhe e sinqeritetit.

21. Ne te njejten kohe ai eshte njeriu i ligjikes dhe realitetit. Ne shkallen e arsyetueshmerise ka sukses dhe pranohet nga shoqeria ne te cilen jeton.

22. Njeriu i thirrjes eshte shume i ndjeshem ne lidhje me ceshtje qe lidhen me besimin e njerezve. Ceshtja e mosbesimit dhe e devijimit qe sheh ia copeton zemren duke e bere te behet dysh perballe ketyre gjerave.

23. Njeriu i thirrjes e realizon punen e thirrjes me deshire dhe mall. As qe mund te mendohet te arrije sukses pa u bere i dashuri i pasionuar per kete pune.

24. Thellesia dhe pasuria shpirtore jane tipar i pandare i njeriut te thirrjes. Kjo thellesi shpirtore ben qe ai te arrije nivelin me te larte ,duke u paisur me vlerat me te larta morale.

25. Njeriu i thirrjes duke shpallur misionin e thirrjes duhet te karakterizohet nje pasterti e zemres dhe drejtesi shpirtore. Qe te shohe pas tij ne menyre te hapur Allahun dhe te Degjuarin e tij eshte e domosdoshme te jetoje nje jete po aq te paster sa dhe misioni i tij. Nje jete e tille arrihet vetem permes pastertise shpirtore.